


BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-32

1462

Arshin Xhezo

**BISEDE
SHOQERORE**



24-52

Xh62

ARSHIN XHEZO

BISEDË SHOQËRORE



~~74262~~

3346

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

LARTËSI TË NDËRGJEGJES SHQIPTARE

Nuk po më hiqet nga mendja një letër që na erdhi një ditë në redaksi. Sapo u ulëm në tavolinë: — Dëgjoni! — tha një nga shokët tanë dhe lexoi:

«U vra aksidentalisht në minierë zjarrmëtari Çerçiz. U hidhëruan shumë shokët. Pastaj e çuan në shtëpi. I ati ishte te porta. Shtangu për një çast. U drodh. Po e mblodhi veten: «Çerçiz, ti je? — tha. — Pastaj u drejtua nga njerëzit që ishin grumbulluar: — Përherë Çizja i babait më vinte vetë në shtëpi. Sot po ma bien shokët. Po vijnë shumë njerëz sot tek unë. Me siguri djali do ta ketë nderuar Partinë... — I thirri pastaj djalit tjetër: — Hajde me babanë të shkojmë të punojmë në këmbë të Çizes. Nuk ia lëmë Partisë vendin e punës bosh».

Atë e bir para dhe nëntë kooperativistë të tjerë pas, shkuan e zëvendësuan zjarrmëtarin në minierë...».

...Ne heshtëm për një çast. Shikonim njëri-tjetrin në sy dhe dëgjonim. Fjalët e plakut me zemër të madhe na prekën. Por shpejt e mblodhëm veten. Dhe letra na u duk e zakonshme. Po pse të na dukej e zakonshme? Pikërisht nga kjo gjë nuk po më hiqet nga sytë ajo copë letër e vogël. E zakonshme?! Thoni, ku ndodh kështu, në cilin vend? Asgjëkundi!

Tek ne kjo është fare e zakonshme. Është bërë i zakonshëm heroizmi. Na është bërë si ajri. Po e thitim pa e kuptuar. Heroizmi masiv! Vepra kolosale e Partisë. Partia na ka bërë të tillë: të vritemi e të mos e ndiejmë vdekjen, të lodhemi e të mos e ndiejmë lodhjen. Se kemi një ideal të madh —, socializmin. Jemi betuar ta ndërtojmë socializmin. Dhe do ta ndërtojmë me thonj e me dhëmbë, me jetën tonë. I tregojmë vështirësitë tona. Po ama nuk i tregojmë për t'i qarë hallin botës, që të na thotë: «Epo mos u mërzitni, se kështu e ka jeta». Jo! Ne i tregojmë vështirësitë tona për t'i thënë botës se dimë t'i mundim, dimë të fitojmë mbi to. Edhe kështu siç jemi të rrethuar. E dëgjuat atë plakun? Atij s'iu dhimbs djali për Partinë. Kështu jemi të gjithë. Kokën lëmë për Partinë, për shokun Enver. Se na kanë fisnikëruar shpirtin.

Për socializmin, për të mirën e tjetrit, të shokut, të fqinjës, njerëzit tanë po shkruajnë faqe të mrekullueshme heroizmi. Na janë bërë si të shtëpisë emra të tillë heronjsh të popullit si Fran Ivanaj e të punës socialiste si Pilo Lera e Riza Burja, si Ismet Sali Bruçaj e brigada që mban emrin e tij në hidrocentralin e Fierzës. Ra tërmet në Dibër, në Librazhd, në Fier, po u ngritën njerëzit nga gjithë Shqipëria dhe vajtën e i zhdukën pasojat. Pa asnjë shpërblim. Sepse çatitë e rrëzuara quheshin «çatitë e të gjithëve». Ne tani ndërtojmë kudo shtëpi me kontribut vullnetar. Ç'gëzim i madh, kur ti hyn në shtëpinë e re dhe u thua shokëve që vijnë të të urojnë: «Urdhëroni brenda!» Dhe ata të urojnë: «I gëzofsh shtëpitë e reja!». Na tregonin një ditë për një aktivist të Lagjes 4. Ishte me shërbim jashtë rrethit. Po ngaqë s'e linte merakun e pallatit që po

ndërtonin si lagje, bëri një lajmthirrje: «Alo!» «Ç'ke» i thanë. «Po dola njëherë, — u përgjigj. — Nuk e di, erdhi llaçi për katin e dytë apo jo?» Duket i thjeshtë ky fakt. Po ç'e shtyu atë njeri të telefononte? Ai vetë ka shtëpi!... Kështu na ka mësuar Partia. Të na dhimbset shoku. Kemi akoma nevoja për ndërtime, prandaj dhe i jemi përveshur të gjithë. Po dëgjoni ç'thoshte shtypi amerikan para disa kohe: «Rio-de-Zhaneiro: Maria Tomas Pedro është 27-vjeçare. Është e papunë. Ka 7 fëmijë dhe burrin e saj Helio, 32 vjeç. Jeton në një barakë prej teneqeje, që fryn nga të katër anët. Fëmijët iu sëmurën nga të ftohtit. Një ditë Maria u çmend, papritur rrëmbeu fëmijët një nga një dhe i hodhi në pellgun me ujë pas barakës. Pastaj hyri me vrap në barakë dhe u përpoq të vrasë veten».

«Mbi 1 milion fëmijë të pastrehë jetojnë në pjesën jugore të kontinentit latino-amerikan, — shkruan revista «Njuzuk». — I gjen duke dremitur në grumbuj plehrash, në varreza dhe nëpër kanale, për t'iu fshehur patrullave të policisë dhe qenve».

«Po televizioni i tyre? — mund të thotë dikush — Në të duken pallate të bukura, shtëpi komode...» Ashtu është, po dihet që regjizorët, kameramanët dhe padronët e tyre nuk janë «aestetikë», që të xhirojnë në vende të fëlliqura... Pastaj dihet nga kushdo parulla elementare e tregtarit: «Reklama është shpirti i tregtisë»... Dhe ata janë tregtarë të regjur...

Bile kjo është pak. Shpirti tregtar i njeriut të gatuar nga borgjezia arrin shpeshherë në krim.

«Evelin Vagleri — shkruante shtypi amerikan — ishte një grua e re nga Bostoni. Ajo kalonte rrugës një ditë duke mbajtur në dorë një bidon me benzinë. Papritur, gjashtë vetë të panjohur iu ho-

dhën përsipër dhe u sollën me të si shtazë. Pastaj i hodhën benzinën në trup dhe i vunë zjarrin. Ndërkohë ata u larguan duke qeshur e duke parë lëkurën e saj, që digjej e copëtohej dalngadalë...»

Është ngjarje shumë e dhimbshme. Bile makabre. Po sistemi borgjez gjithmonë kriminelë ka pje-llë. Bishave të tilla kurrë nuk u është dhimbsur, as njeriu, as lëkura e njeriut. Ata zbavitën me lëkurën e njeriut.

Edhe nazistët kështu kanë bërë 30 e ca vjet më parë me lëkurën e njeriut. Ndoshta keni dëgjuar për librin «Main Kampf» (Lufta ime) të Hitlerit. Një ekzemplar i tij, që u gjet në Buhensvald, e kishte kopertinën të mbështjellë pikërisht me lëkurë njeriu...

Por ne na ngjethin tregime të tilla. Për ne njeriu është kapitali më i çmuar dhe bëjmë gjithçka për të. Duke lexuar historinë e gruas fatkeqe të Bostonit përfytyroja lëkurën e saj që binte, dhe m'u kujtua një shkrim i botuar në gazetën tonë para pak vitesh. Dhe shkova e shfletova: «... Le të tregojmë — thoshte autori — për një ngjarje të thjeshtë që ndodhi dje dhe që dëshmon për bukurinë e shpirtit të njeriut tonë dhe për ndjenjën e solidaritetit për shokun... Në spitalin Nr. 2, mëngjesin e djeshëm erdhën 40 traktoristë e mekanikë të SMT-së së Tiranës. Erdhën e takuan mjekët dhe u thanë se donin të jepnin pjesë të lëkurës së trupit të vet për të shëruar shokun e tyre të djegur... Një-ri nga ata, i cili s'ka as dhjetë ditë që është marr-tuar, shkoi në spital bashkë me gruan e vet: «Merr-ni pjesë nga lëkura jonë, — thanë ata, — ne jemi të rinj...».

Bukuria e shpirtit të njeriut tonë! Është bërë një bukuri e tillë, kaq e zakonshme nga Partia, saqë po të fillojmë të tregojmë momente të veçanta të saj, secili mund të thotë: «Po kështu ndodh edhe tek ne, po të tillë njerëz njoh unë sa të duash». Po pikërisht kjo është e madhërishmja, bukuria jonë shpirtërore, se ajo është masive.

Ishim një ditë në një mbledhje të organizatës së frontit të një blloku. Banorët ngriheshin të gjithë njëri pas tjetrit, të rinj e pleq, dhe kritikonin një burrë që nuk kishte mundur ta edukonte mirë djalin e vet, i cili bridhte udhëve natën vonë ose grindej me shokët.

— Pupu! — i tha një plakë. — Po të isha në vendin tënd që të kanë thirrur tri herë në këshill e të kanë hequr vërejtje, unë nuk do të kisha më sy e faqe t'u dilja njerëzve, po do të thosha «Hapu gropë, të futem!...».

Kështu tha nëna plakë. Tri herë po ta kishin thirrur në këshillin e lagjes do të quhej e turpëruar për jetë. Mirëpo shtypi amerikan nuk turpërohej fare, bile e jepte me mburrje lajmin për 60-vjeçarin P. Dimitri, i cili u arrestua për të 115 herë. Edhe vetë i arrestuari ndihej krenar... Pse të turpërohej plaku? Mos ishte i vetmi!

Ky është morali i tyre. Frikë, pasiguri kudo. «Në San-Francisko — njoftonte një ditë shtypi amerikan — u gjetën të vdekur nga të pangrënët dy motra të moshuara. Pse? Ato kishin kaq ditë që nuk guxonin të delnin nga shtëpia të blinin diçka për të ngrënë. U ruheshin çdo çast vagabondëve dhe vrasësve, që përgjonin pas çdo porte...»

Ne edhe na trondit ky fakt, por edhe na duket si për të qeshur. Sepse për ne është gati i pabesue-

shëm. Ne asnjëherë nuk i kemi pasur problem vrasjet e grabitjet. Tek ne edhe kur ndodh rrallë ndonjë akt i lehtë vagabondazhi, mbliidhet e alarmohet gjithë lagjja, kolektivi i ndërmarrjes ose shkolla. Ku vallë ndodh kështu në botën borgjeze? Të ngrihen shokët, fqinjët, njerëz fare të panjohur e të të kritikojnë djalin pse nuk sillet mirë me prindët e vet ose me shoqërinë!? Forca e opinionit tonë shoqëror është e madhe, e shëndoshë. Nuk dimë si do ta ndiente veten një i huaj po të ndodhej në një mbledhje të tillë të bllokut ose të lagjes. «Ç'ju duhet këtyre njerëzve të merren me të tjerët!», do të thoshte. Do të habitej, po të dëgjonte se një djalë e përbuz lagjja, bile e dënon, pse s'di të sillet me nënën e vet, ose pse e ka të padisiplinuar fëmijën e vet.

Sthurja, degjenerimi moral e shpirtëror, ka mbërthyer gjithë botën borgjeze e revizioniste. Gazeta polake «Chllopska droga» botonte një letër të një vajze 14-vjeçare. «Të rinjtë e qytetit — thoshte vajza — janë shumë të shturur. Vajzat tmerrësisht të shturura. Të rinjtë tallen me pleqtë dhe njerëzit fatkeqë. Vajzat bredhin me të gjithë djemtë, njohur e panjohur. Ç'mund të presësh nga një vajzë e tillë, kur edhe nëna e saj bën të njëjtën gjë? Ju lutem shokëve të redaksisë të më përgjigjen pse ndodhin këto...»

Ndërgjegjja shqiptare. Në lartësi të papara e ngriti atë Partia. Elementet e komunizmit, idealet dhe puna komuniste po hyjnë gjithmonë e më thellë në gjakun tonë, në gjakun e të gjithëve. Askush nuk i detyroi, veç ndërgjegjes së tyre komuniste, 100 pleqtë pensionistë nga Puka të ngrihen e të punojnë një muaj të tërë në ndërtimin e hekuru-

dhës së rinisë Librazhd-Prenjas. Puna e papaguar, puna komuniste po bëhet diçka e zakonshme në jetën tonë. Sheh tani qindra e mijëra njerëz, pleq e të rinj, që ngrihen pas punës mbasditeve e të dielave, nga qyteti e nga fshati, hapin kanale e ngrenë ndërtesa. Dhe të kujtohen «të shtunat komuniste». Në çdo lagje, në çdo qendër pune, në çdo qytet, në çdo fshat të shkosh sheh njerëz që punojnë pasditeve, çdo ditë, të dielave, jo 4 orë e 6, po shumë më tepër, për socializmin në Shqipëri. Kemi derdhur e derdhim gjak e djersë për socializmin. Dhe prandaj i duam shumë dhe i mbrojmë shumë këto që kemi bërë. I mbrojmë fort, duke qenë të rrethuar nga të katër anët. Dhe do t'i shtojmë fitoret, me mund, me luftë e me punë të palodhur. Se ndërgjegjen politike e kemi të ngritur. Dhe mbajmë në njërën dorë kazmën, në dorën tjetër pushkën.

Na bëri shumë përshtypje tregimi për nja dy kooperativiste. Çeta e tyre luftarake është me rezultate të shkëlqyera në stërvitje. Po e dini ç'ndodhi një ditë me ato të dyja? Një mbasdite, pas punës, lanë punët e tyre, shtëpinë e fëmijët dhe shkuan në depon e armatimit:

— Ku është komandanti? — thanë.

— Pse, ç'e doni komandantin? — u tha një fshatar. — Sot s'ka stërvitje.

— E dimë, e dimë, — thanë ato, — po ja, erdhëm nga meraku i armëve tona. Thamë t'i vajsim edhe një herë, se s'i dihet, edhe ndryshken, sa të vijë dita e stërvitjes...

Këtë merak kemi të gjithë ne shqiptarët për armët. Edhe këtë merak, si për punën, Partia na e ka edukuar. Barutin thatë e mbajmë gjithmonë. Ne e dimë, moralisht armiqtë tanë janë të mundur,

që përpara se të na sulmojnë. Po pikërisht pse kanë pësuar këtë disfatë ata janë të rrezikshëm. Kamuflohen. Thurin komplete. Diplomacinë e fshehtë e kanë ngritur në sistem.

Superfuqitë po mundohen t'u vënë shteteve të botës prapa shpine nga një çelës si kukullave, që ato të luajnë valle sipas avazit të kurdisë së tyre. Duan të fusin hundët dhe duart kudo. Po ne kjo politikë e tyre na kujton një proverb të popullit tonë që thotë: «Përmori miu në det dhe tha: «Jam pjesëtar».

Prandaj dhe jemi vënë kundër tyre me krahët tanë, me armët tona, e sidomos me ndërjegjen tonë revolucionare, që përshkohet tejprtej, brumoset e kalitet vazhdimisht nga idetë e marksizëm-leninizmit, nga mësimet e Partisë sonë e të shokut Enver Hoxha.

PASURI E MADHE SHPIRTËRORE

Epopeja e Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte madhështore, sepse i dha lirinë atdheut tonë. Njëkohësisht ajo u bë një shkollë e madhe e edukimit të partizanëve e të popullit me normat e larta të moralit komunist. Që nga krijimi i saj dhe gjatë gjithë luftës, Partia jonë i edukoi në mënyrë të organizuar masat punonjëse me dashurinë e pakufishme për atdheun, urrejtjen për armiqtë, disiplinën proletare, i ushqeu ata sistematikisht me moralin e pastër proletar. Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare shkëlqeu figura e pastër e komunistit dhe e partizanit, shembulli i tyre i madh, që arrinte gjer në vetëmohim. Qëndrimi parimor, guximi, trimëria, vetëmohimi, ndjenja e dashurisë për shokun, solidariteti, sinqeriteti, ndershmëria, ndjenja e fortë klasore shpërthyen me gjithë madhësinë e tyre. Kjo është një pasuri e madhe dhe e pazëvendësueshme që na sollën luftëtarët dhe komunistët e viteve të luftës, të udhëhequr nga Partia dhe shoku Enver.

Dëgjojmë sot tregimet e veteranëve për komunistët e partizanët, për shokët e tyre, dhe entuziazmi na pushton gjithë qenien. Biem në mendime e

themi me vete: «Cila ishte ajo forcë, vallë, që i dha këtë lulëzim karakterit të tyre? Ata në një moshë kaq të re, ishin aq të burrëruar!». Ç'nuk i punuan trupit të Manush Alimanit fashistët! Por ai qëndronte krenar e me ballë të pastër para tyre. Asnjë fjalë nuk nxori nga goja. Vetëm te një njeri me një besim të thellë te Partia mund të lulëzonte me kaq dinjitet kjo besnikëri shembullore, që ishte një nga shfaqjet më të mrekullueshme të karakterit të komunistit. Ose, keni dëgjuar për Loni Dhamon? Për disa orë me radhë e torturuan tradhtarët, por ai heshti, nuk i tregoi bazat. E rrahën pa mëshirë para syve të t'et, me kërbac e shufra hekuri. Ia shkulën thonjtë me pinca, e dogjën me bajonetë të skuqur, ia çanë lëkurën dhe ia mbushën me kripë. Së fundi, ia thyen të dy krahët dhe një këmbë. Por kur, më në fund, donin ta pushkatonin, ai thirri: «Qëndroni!» Tradhtarët, që kujtuan se ai u pendua, qëndruan. Komunisti, me mundim të madh, u çua në këmbë.

— Tani qëlloni! — tha. — Komunistët vdesin në këmbë!

Të tillë ishin ata. Partia te të gjithë kishte futur moralin e pastër proletar. Dhe kjo nuk ishte një edukatë akademike. Auditori i luftëtarëve ishte tërë Shqipëria, që priste të çlirohej nga pushkët e tyre. Ata edukoheshin duke luftuar e duke u udhëhequr nga shembulli i komunistëve. Sepse Partia e kishte bërë të qartë: në ballë të luftës e të rrezikut ishte vendi dhe nderi i komunistit.

Populli ynë gjatë gjithë shekujve ka qenë trim e guximtar. Këto veti të karakterit të shqiptarit Partia jo vetëm i ruajti, por edhe i ngriti më lart. Në vendet revizioniste si në Bashkimin Sovjetik e

gjetkë i kanë harruar traditat revolucionare. Ata i trembin njerëzit me gogolin e luftës, frymëzojnë pacifizmin, poshtërojnë e shfytyrojnë luftëtarët e dikurshëm të lirisë. Por duke ngritur në qiell kultin e «heroit», është e qartë për të gjithë, ata duan të ruajnë e të përjetësojnë në tokë sundimin e tyre prej sovranësh që u kanë hipur në zverk klasës e masës.

Për ne janë të shtrenjtë, të dashur, gjithmonë të paepur e të përjetshëm ata që bënë luftën. Trimëria, guximi mori një shkëlqim të ri gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Vojo Kushi u bë legjendar kur iu hodh tankut mu në mes të Tiranës. Perlat Rexhepi, Branko Kadia e Jordan Misja shkruan epope me gjakun e tyre në Shkodër. Sa trima ranë në sulm me thirrjen: «Për popullin, për Partinë, para partizanë!» Vetëm një frymëzim i fuqishëm mund të sjellë akte të tilla heroizmi. Dëshirat e vogla, meskiniteti, ishin të huaja për këto karaktere të fuqishme. Interesi i madh i atdheut i bënte të harronin çdo gjë personale. «Nuk mund të ketë lumturi personale pa lumturi të përgjithshme... ta kemi si ligj, përpara për interesin e përgjithshëm, pastaj për atë personal». Këto fjalë ua thoshte bashkëfshatarëve të vet Heroi i Popullit Lefter Talo, që kur ishte djalë 24 vjeç.

Të mbërthen një entuziazëm i fuqishëm kur dëgjon të tilla tregime për partizanët e komunistët, kur shfleton ditaret e tyre të luftës, lexon hartimet e tyre të shkollës, ose dokumente të luftës. Bile të duket edhe e habitshme ndonjëherë. Kaq të rinj dhe me një formim kaq të madh; kaq të rinj dhe me një botë kaq të pasur shpirtërore; kaq të rinj dhe kaq të pjekur! Pikërisht këto virtyte të mrekul-

llueshme që edukuan në popull Partia dhe shoku Enver, ishin arma më e fuqishme në luftën kundër pushtuesve e tradhtarëve. Këto cilësi të mrekullueshme farkëtonin unitetin në radhët e partizanëve, farkëtonin unitetin midis Partisë, partizanëve e popullit. Populli çdo gjë e shihte, populli çdo gjë e gjykonte. Ata luftonin për të, prandaj ai i mbushte çetat partizane me bijtë e tij, ai i ushqente dhe i mbathte. Populli i donte komunistët e trimat e tjerë të maleve pikërisht pse shihte tek ata ajkën e vendit, njerëzit e ndershëm e vetëmohues për të. Partizanët e ruanin si sytë e ballit gjënë e popullit, prandaj ai përgjerohej për ta. Nga ana tjetër, shihte edhe se si milicët, xhandarët e tradhtarët e Ballit Kombëtar e xhvatnin dhe e plaçkisnin, prandaj këta i urrente e u jepte plumbin. Populli i shihte partizanët që ndanin katër vetë një krodhë bukë, që ecnin të zbathur e të pangrënë netëve të dimrit, që linin kokën për shokun, dhe prandaj e ndante me ta edhe kafshatën e gojës.

Kjo edukatë sistematike dhe e organizuar e Partisë solli lulëzimin e karakterit të luftëtarëve të lirisë, solli unitetin e madh. Prandaj edhe goditjet armiqte i bënin në këtë objektiv. Parullat e tyre demagogjike kundër moralit partizan synonin pikërisht prishjen e unitetit të partizanëve me Partinë, të popullit me Partinë. Por Partia jonë i diskreditoi armiqte përfundimisht. Ishin faktet që flisnin, ishte vepra e tyre, ishte jeta.

Këtë thesar të madh Partia e ngriti gjithnjë e më lart nga viti në vit, duke formuar e kalitur në betejat e reja njeriun e ri të socializmit. Me fjalën e Partisë në zemër populli ynë heroik i vuri shpatullat rindërtimit të atdheut të shkatërruar nga

lufta. Dhe këto janë shfaqje të reja të trimërisë që edukoi e edukon tek njerëzit tanë Partia. Ajo na ka bërë e po na bën të ndërgjegjshëm, se trimëria nuk tregohet vetëm në luftë, por edhe në punë për ndërtimin e socializmit e për të futur në gjak normat e moralit proletar. U derdh fushave e maleve për të ndërtuar urat, rrugët e hekurudhat e para, për të tharë kënetat e për të ngritur uzina e kombinatë, për të ndërtuar hidrocentrale e për t'i kthyer kodrat e malet në vende pjellore si edhe fushat. Ai punoi, luftoi dhe lufton si një repart i hekurt në rrethim duke triumfuar mbi vështirësitë, sabotimet e armiqve dhe bllokadën e egër të tyre. Dhe nxori nga gjiri i tij heronj të rinj, trima të rinj të panumërt e të lavdishëm të epokës së socializmit. Ka dhe nga ata që ranë. Por ata ranë për të mos vdekur kurrë. Ranë djem, që shkuan të ngrihin hekurudhën; ranë trimëresha, që luftonin për dritën, ranë Ademi, Muhameti, Myrtezai, Isufi duke mbrojtur me jetën e tyre pasurinë e popullit; ranë Shkurta, Qazimi e Froku në punë për begatinë e atdheut; ra Agroni me armën në sup duke vigjiluar në kufi. Por një ra, qindra mijëra u ngritën si detashmente të reja revolucionare pa mbarim. Më të fortë se tërmeti u treguan ata që vërshuan fshatrat të rrethëve të Dibrës, Librazhdit, Fierit, Tepeleznës, Sarandës e Skraparit dhe mbi rrënojat që shkaktuan fatkeqësitë e natyrës ndërtuan mijëra shtëpi më të bukura se ç'ishin. Aksioni masiv u fut kudo si metodë pune dhe edukimi revolucionar. Në çdo skaj të vendit qindra mijëra njerëz punojnë me ndërgjegje të lartë e pa bujë për realizimin dhe tejkalimin e planeve, për rritjen e rendimentit e të cilësisë; për kursimin e forcimin e pronës së

përbashkët, për rritjen e begatisë dhe çelikosjen e mbrojtjes së atdheut. Një zinxhir ky i pandërprerë heroizmesh e trimërishe, që buron në dejtë e trupit e të mendjes së masave dhe që është bërë një nga virtytet më të larta të shoqërisë sonë.

Pikërisht pse kemi ndjekur mësimet e Partisë e të shokut Enver dhe kemi ecur në traditat tona më të mira e më të lavdishme, pse i kemi shfrytëzuar ato dhe i kemi pasuruar më tej, ne kemi arritur edhe tërë këto suksese në edukimin e njeriut tonë të ri etj. Prandaj edhe na bie detyrë që edukimin tonë me shembullin e lartë të moralit partizan, të heronjve të pasqirimit e të ndërtimit socialist dhe të njerëzve të pararojës, ta kemi kurdoherë edhe në të ardhmen vazhdimisht në rend të ditës dhe ta bëjmë sa më të organizuar. Shumë veteranë të luftës e ish-partizanë, pjesëmarrës të aksioneve të para dhe njerëz të shquar të punës të ditëve tona i kemi midis nesh. Të rinjtë dhe më të rriturit zhvillojnë me ta biseda të organizuara e spontane. Kjo është një gjë shumë e mirë dhe do të vazhdojë të bëhet. T'i shtojmë gjithnjë e më shumë e le të mos i kufizojmë këto biseda vetëm në raste jubileare e në përvjetorët e rënies të heronjve e të dëshmorëve. Sa mirë bëjnë disa organizata të rinisë ose organizata të tjera masash, të cilat, kur diskutojnë një problem të veçantë shoqëror që i preokupon, thërresin midis tyre edhe veteranin e luftës, që i frymëzon me shembullin e pastër të trimave që luftonin «me qefin nën sqetull» për lirinë e të ardhmen e atdheut. Duke dëgjuar për marshimin e lodhshëm të partizanit të maleve të Mokrës e Shpatit, Labërisë e Skraparit, Krujës e Korabit, për heronjtë e rrugës Kukës-Peshkopi, të

Maliqit, Shkopetit etj, e ka vështirë një i ri ose e re të thotë: «Nuk shkoj të punoj në atë fshat, sepse është larg...»

Në Kuç të Kurveleshit ka një muzeum shumë të mirë. Por më tepër të entuziazmojnë pasioni dhe dashuria me të cilat u flet të rinjve veterani i luftës, Heroi i Popullit Abdyl Hakiu ose nëna heroike Shaho Luçi, e cila e ka kthyer në muzeum shtëpinë e saj.

Gjithë historia dhe jeta jonë e sotme janë një muzeum i gjallë, një libër i madh, një fushë e pa-fund trimërishtë e heroizmash. Partia kërkon që këtë ta konsiderojmë si thesarin më të shtrenjtë për të rrënjosur te secili normat e moralit komunist. Para tyre, para këtij morali, para mësimëve jetëdhënësë të Partisë e të shokut Enver, bëhet copë e thërrime çdo mbeturinë e së kaluarës dhe presion i ideologjisë së kalbur borgjezo-revizioniste dhe do të shkëlqejnë edhe më fort figura dhe vepra e njeriut tonë të ri revolucionar, të cilat do të kalojnë brez pas brezi dhe do të ndrisin në shekuj!



3340

NË GJIRIN E NGROHTË TË SHOQËRISË

Xha Qaniu çdo ditë : «e vret» nga një çikë gjumin tani në vapë. Se helbete, plak është, pensionist, po edhe të nxehtë ka marrë përpjetë shumë. Kurse atë ditë që unë isha në shtëpinë e tij, xha Qaniu s'e bëri zakonin, po hëngri drekë, piu një filxhan kafe dhe u mblodh mbi minder me kokën mbi gjunjë e s'liste. 5 minuta kështu, 10, 20... Ne shikonim njëri-tjetrin në sy.

— Sikur të shtriheshe një çikë, — i thashë.
— Vapë...

Ai ngriti pak kokën.

— Jo, — tha, — jo. Kemi atë mbledhjen e bllokut tashti në pesë.

— Po je shpejt shumë, — thashë. — Një orë gjumë mund ta bësh...

Unë nuk e mbarova dot fjalën. Ai gati u hodh nga minderi dhe fytyrën e kishte shumë të mër-zitur.

— Ç'gjumëzi! — tha. — Të lënë ata rehat? Si derra djemtë dhe s'venë në punë. I kemi thirrur kaq herë në mbledhjet e bllokut, po nuk u nxihët faqja... Na turpëruan bllokun të paudhët! Po dale pa do t'i shohim sot...

...Sa vajti ora e mbledhjes ne vazhduam mu-

habetin me xha Qaniun. Atij i kishte mbetur **maraz** sidomos sjellja e prindërve të njërit. Shumë u morën me atë fëmijë banorët e bllokut ku banon dhe xha Qaniu, gjersa e futën në udhë të mbarë. Mirëpo u polli belaja me prindërit e tij, që u mbanin kokën mënjanë shokëve të Frontit (Pse m'i bini djalit kot më qafë?... — thoshnin), në vend që t'i falënderonin. Po ç'ndodhi? Qëlloi më vonë që nja dy shokë të djalit iu dhanë gjyqit. Atëherë «fap» prindërit e tij zunë të ndërrojnë qëndrim. Përshëndesin tani, bile edhe me buzë në gaz. Shiko ku do të kishte dalë djali i tyre, po të mos kishin ndërhyrë banorët e bllokut e midis tyre edhe xha Qaniu!

...«I biri i Gjyslymes ishte vendosur disa herë në punë dhe nuk shtrohej. Veshjen s'e kishte si të të tjerëve. Po u thirr disa herë me radhë nga banorët e bllokut dhe tani punon në bonifikime. Ka marrë udhë...».

«Në lagjen Nr. 3, përqindja e kalimit të nxënësve sivjet është rritur 5.5 në krahasim me vitin e kaluar...»

«Golin e këmi pasur problem. Në shkollë s'vinte, vishej keq. Ndërhyri blloku. Tani është bërë shembullor. Mbaroi shkollën 8-vjeçare, mbaroi dhe shkollën profesionale...».

«I biri i Besimit, që ishte me vese të këqija, me punën e mirë të banorëve të bllokut është bërë xhevahir djalë, punon mirë, sillet mirë, vajti dhe dy herë në hekurudhë...».

«I biri i Hysenit ishte bërë problem i madh si rrugaç i lagjes. Me punën e banorëve ka bërë kthesë mijë për qind...».

...Këto nuk janë informacione të thjeshta. Këto janë sihariqet më të gëzueshme të jetës sonë. Ne

gëzohemi kur shohim çdo ditë tek rriten katet e këtij hoteli të madh në qendër të Tiranës, gëzohemi kur dëgjojmë të rritet rendimenti i grurit e i misrit, kur rriten lartësitë e veprave të mëdha, por gëzimi për rritjen e njeriut tonë na ngazëllon edhe më shumë. Kjo është rritja më e madhe e kohës, sepse është rritja e ndërgjegjes sonë shoqërore, është shkëlqimi i moralit tonë proletar.

Kështu ndodh kudo në vendin tonë. Ne jemi si një familje e madhe, ku një fëmijë ka qindra prindër njëkohësisht, qindra vëllezër e motra. Shkoni, po dëshët te kryqëzimi i rrugës. Një brigadë e transportit e punëtorëve të uzinës, i ka vënë fletërrufe një të riut që nuk donte të shkonte në punë. «Të presim në kolektiv, — i thonë shokët në fletërrufe. — Kthehu, mos ki frikë, se ne të duam dhe do të ndihmojmë me gjithë shpirt». Ai ka bërë gabim të madh që nuk shkonte në punë, por shokët e kanë zemrën të pastër e shpirtin të gjerë. Shoqëria jonë e ka gjirin të ngrohtë për njerëzit e saj. Ajo i ngjan një nëne që nuk të largon kur gabon, por të afron te vetja, të përkëdhel butë flokët e të bën vetvetiu ta duash. Ajo sillet në atë mënyrë që ty të vjen turp t'ia kthesh fjalën. I keni parë ca të rinj kur ngrihen e me fytyrën flakë nga turpi e sedra u thonë «më fal!» shokëve, shoqeve a banorëve të bllokut? Po përgjigjet e fletërrufeve? Ato në shumicën e rasteve janë të singerta. Ata përgjigjen me veprën e tyre në radhë të parë. Po dhe në qoftë se ata që gabojnë në fillim s'e kuptojnë dot mirë ndihmën e shokëve, shokët nuk përtojnë. Ata mbliidhen prapë dhe këtë herë zemërohen ca. Mund të marrin edhe ndonjë masë. Se ata nuk mund të lënë që një mollë e krimbur të prishë

tërë shportën. Këtë kuptim ka veç të tjerash dhe diktatura e proletariatit tek ne. T'i mbajë të gjitha «mollët» të shëndetshme tek ne dhe t'i heqë mënjane ato të kalburat fare. Dhe forcën më të madhe të diktaturës sonë të proletariatit e përbën forca e shoqërisë sonë, e opinionit tonë të shëndoshë shoqëror.

Prandaj Partia na thotë gjithmonë të mos jemi indiferentë. Dhe ne, përgjithësisht, nuk jemi të tillë. Prandaj e kemi kaq të madhe forcën e opinionit tonë shoqëror dhe shoqërinë të tillë, të pastër. Ja, ka nja dy ditë që tek xhamat e asaj kafesë afër reklamave të kinemasë, në Tiranë mblidhen grupe njerëzish. Ata lexojnë ca fletërrufe që u kanë vënë shokët e tyre. Kanë vendosur dhe fotografitë. «Po ç'i ha meraku këta pse tri-katër të rinj mbajnë flokë të gjatë? — mund të thotë dikush. — Jo, s'është ashtu! Familja jonë është tërë Shqipëria. Ne na zë turpi për çdo njeri, kemi përgjegjësi për secilin, sepse Partia na ka mësuar që fjalët «imja» ose «jona» të mos kenë kuptim vetëm brenda mureve të shtëpisë. «Na turpëruan bllokun» — thoshte xha Qaniu për ata dy të rinjtë që rinin pa punë. «Na turpëruan shoqërinë» — kanë thënë ata të rinjtë. Prandaj dhe vunë fletërrufetë e fotografitë.

Kështu duhet të bëjmë të gjithë. Mësuesja e shkollës «Skënder Çaçi», megjithëse kish një punë të saj me shumë ngut atë ditë kur pa dy fëmijë të bllokut që gjuanin njëri-tjetrin me copa buke u ndal. U foli fëmijëve. Pastaj shkoi te kazani i plehrave të bllokut. Edhe atje pa shumë copa buke. Dhe i dhembti në shpirt. Sepse buka del me djersë, buka është jeta jonë. Prandaj dhe mësuesja u kthye e revoltuar dhe organizoi me gratë e bllokut një mble-

dhje vetëm për mosshpërdorimin e bukës. Kështu është «Na turpëruan bllokun». Ne jemi një familje. Duhet t'i rregullojmë vetë gjërat tona: në shkallë, në bllok, në lagje, në fshat. Sa gjë e bukur, sa kënaqësi ndien kur dëgjon se banorët e shkallës së një pallati kanë organizuar midis tyre qarkullimin e të gjitha librave dhe shtypit që kanë! E mbarove së lexuari librin ose gazetën? Tjetri vjen ta merr që ta lexojë edhe ai në familje. Vërtetë gjë e bukur! A nuk ia vlen të bëjmë të gjithë kështu?

Ndien një entuziazëm të thellë brenda vetes dhe të pushton një qetësi e çuditshme në shpirt kur dëgjon fakte të tilla të thjeshta e të zakonshme, por që janë shumë të dobishme e sidomos kur bëhen vetvetiu nga njerëzit tanë, pa asnjë urdher. Ata e ndiejnë gjirin e ngrohtë të shoqërisë, gëzohen dhe bëjnë çdo gjë për të. Sa shumë u gëzua një plak një ditë me disa të rinj, për të cilët po lexonte një fletëfalenderimi, që Komiteti i Rinisë kishte vendosur përballë Mapos Nr. 2. Ai lexonte, dhe tërë fytyra i çelej nga fjalët e mira që thuheshin për këta të rinj të uzinës. Tek ne kush punon e silltet mirë, lëvdërohet; kush s'është në rregull, kritikohet. Dhe figura e njeriut të ri skalitet kurdoherë.

KURDOHERË NË REVOLUCION

Në Kongresin e 7-të të Partisë shoku Enver theksoi: «...që njerëzit tanë të jenë kurdoherë në revolucion, të mos shkëputen për asnjë çast prej tij, të luftojnë e të punojnë gjatë gjithë jetës me vetëmohim për çështjen e madhe të Partisë, për socializmin e komunizmin¹⁾».

Faktet e shumta tregojnë se Partia jonë ka qenë kurdoherë në revolucion e në ballë të tij, se kanë qenë kurdoherë në revolucion shteti ynë dhe mbarrë shoqëria.

Komunisti veteran Mehmet, nga Tropoja, është rreth të gjashtëdhjetave. Në qoftë se ai ishte delegat pjesëmarrës në të shtatë kongreset e Partisë, kjo do të thotë se ai ka qenë vazhdimisht pjesëmarrës në revolucion. Se çdo Kongres tek ne ka çelur një kapitull të ri pune, ka shënuar një etapë të re revolucionare. Dhe pjesëmarrës ka qenë Mehmeti çdo ditë në punë, edhe kur bëheshin aksione për mbledhjen e gështenjave, për korrjen e misrit, për hapjen e kanaleve etj. Nuk «harron» të jetë i tillë, revolucionar, edhe në familje, në edukimin e fëmijëve të tij. Mund të flasësh kështu për shumë pensionistë veteranë në Durrës, në Tiranë, në Vlorë e në gjithë Shqipërinë.

1) Enver Hoxha. «Raport në Kongresin VII të PPSH»
fq. 134.

Por këtu nuk është fjala vetëm për ata që luftuan revolucionarisht në llogoret e luftës e po e mbyllin pleqërinë e tyre, po ashtu, revolucionarisht, me nder e me faqe të bardhë, para popullit e Partisë. Është fjala për armata të tëra punëtorësh e kooperativistësh, të vjetër e të rinj, ushtarakësh, punonjësish e shkollarësh, që janë në ballë të revolucionit, të sakrificave e të vetëmohimit çdo ditë e çdo cast e që fitojnë çdo ditë, çdo cast. I riu Ilia Dashi nuk ishte revolucionar vetëm në momentin kur, për të shpëtuar anijen, pasuri e popullit, nga gjuhët e mëdha të flakëve, u përlesh me to dhe mbeti atje. Heroizmi i tij nuk zbriti nga qielli në ato momente. Akti i tij heroik, ashtu si edhe i Adem Rekës, i Shkurte Vatës, i Ilia Qiqit etj. etj. ishte plotësisht i ndërgjegjshëm. Ky akt final ishte gatuar e kalitur nga Partia vazhdimisht e çdo ditë. Edhe Ilia, edhe heronjtë e tjerë kalitjen dhe botëkuptimin revolucionar të klasës i kishin shprehur çdo ditë në frontet e tyre të punës e të mbrojtjes (Nuk është i rastit fakti që ata edhe në punën e tyre të përditshme kanë qenë shembullorë). Ata çdo ditë punonin, jetonin, mendonin e luftonin si revolucionarë. Dhe nuk ngurruan të jepnin jetën e tyre të re, sepse të gjitha momentet e jetës së tyre i kishin heroike dhe e shprehnin këtë heroikë në frontet e tyre të punës. Momenti i veçantë i vetëmohimit ishte një shkallë e re në vazhden e heroizmit të tyre të përditshëm. I vetmi ndryshim ishte se para tyre tani u shfaq një vështirësi e veçantë, një armik më i ashpër, që duhej përballuar në cast e që të rrezikonte jetën. Ata nuk e përfillën rrezikun, i cili mund t'u merrte jetën, dhe fituan mbi të. Dhanë jetën, por u bënë të pavdekshëm, sepse ranë për popullin,

ranë për idealin e Partisë. Nuk ishte momenti i vë-
shtirë e i rrezikshëm që i bëri ata heroikë, por ishin
ata vetë që, duke bërë edhe sakrificën supreme, e
kthyen momentin në heroik. Pikërisht këtu qëndron
madhështia e epokës së Partisë, forca e fjalës së Par-
tisë e të shokut Enver: në mbjelljen, në rritjen e
kujdesshme e të përditshme të heroizmit masiv, që
gjen shprehjen në të gjitha frontet e luftës së kla-
sës, e luftës për socializmin. Prandaj Partia na kë-
shillon vazhdimisht se nuk është i drejtë, bile është
i gabuar, ai mendim që thotë se luftën e klasave
të presim e ta zhvillojmë vetëm në momentet e
ndeshjeve të mëdha klasore. Është në gjendje ta
zhvillojë luftën e klasave në çdo situatë, ai që e zhvi-
llon atë çdo ditë, në çdo çast, atje ku ndodhet e në
çdo front të jetës. Luftën e klasave, na mëson Partia,
krahas problemeve të mëdha politike duhet të zbre-
sim e ta zhvillojmë edhe në problemet konkrete të
përditshme. Secili prej nesh mund ta bëjë bilancin
e zhvillimit të luftës së klasave çdo mbrëmje, çdo
javë, çdo muaj. Në qoftë se punëtori i një uzine ose
punëtorja e re e një uzine tjetër, janë shembullorë
në punë, në marrëdhëniet me shokët e në familje
dhe korrektë në sjellje e në veshje, kjo do të thotë
se ata janë kurdoherë në revolucion dhe e zhvilloj-
në drejt luftën e klasave. Fakti që disa të rinj e të
reja të Ersekës shkuan të jetojnë e të punojnë për-
gjithmonë në fshat, sepse kështu e kërkon interesi i
atdheut socialist, tregon se veprouan si revolucionarë.
Në qoftë se ajo brigadierja e re punon çdo ditë kra-
h për krahe me kooperativistët e është aktiviste e da-
lluar e organizatës së Rinisë, kjo do të thotë se ajo
është kurdoherë në revolucion dhe e zhvillon drejt
luftën e klasave. Po kështu, kur punëtorë të vjetër e

me përvojë janë jo vetëm meraklinj në punën e përditshme por edhe mbajnë afër punëtorë të rinj, i edukojnë ata me ndjenjën e dashurisë për punën e me ndjenjën e modestisë, me sjelljen e shijen e klasës, kjo përsëri do të thotë se këta punëtorë të vjetër janë të rinj në ideale, janë kurdoherë në revolucion.

Të jesh kurdoherë në revolucion do të thotë që çdo ditë, sapo del në mëngjes nga shtëpia e gjersa bie të flesh, të mendosh e të veprosh si revolucionar. Por mund të ndodhë edhe kështu: dikush del në mëngjes nga shtëpia, sheh shkallët e apartamentit, oborrin para tij plot guricka e mbeturina ushqimesh e «s'i bien» fare në sy; në hyrjen përballë tij kërcet sherri e ai thotë «s'dëgjova gjë»; në punë shkon për tetë orë e punon katër; në mbledhjen e kolektivit s'i tërheq fare vëmendjen as ai që ka një vit të tërë pa diskutuar, as ai që tregohet konformist e oportunist; del nga mbledhja dhe në vend që të blejë për vete ose për fëmijën një libër, shkon në bufe e vë përpara dy dopio konjak... Të gjitha këto duan të thonë se ai nuk e njeh e nuk e zhvillon luftën e klasave, nuk është vazhdimisht në revolucion. Por dihet mirë, siç na mëson Partia, se në punën ideologjike nuk ka boshllëk. Atë që nuk e mbush ideologjia socialiste, do ta mbushë ideologjia borgjeze. Siç u theksua me forcë edhe në Kongresin e 7-të të Partisë, armiku i klasës përpiqet të vërë me çdo kusht në gjumë vigjilencën e masave. Këto momente dobësimi në luftën e klasave ai përpiqet t'i përdorë për llogari të tij e të na godasë. Prandaj duhet ta mbajmë kurdoherë të mprehtë tehun e luftës së klasave, të jemi kurdoherë në sulm, kurdoherë në revolucion.

«SI E KA BIOGRAFINË DHËNDRI?...»

Ishte një kohë kur njerëzit vlerësoheshin nga «dyert» e shtëpive të tyre. «Të mirë» ishin ata të «derës së madhe», kurse të «këqijtë», (populli fukara), të «derës së vogël». Kësaj loje mizore të kohës u nënshtroheshin edhe marrëdhëniet më intime të njerëzve, si dashuria, për shembull. Qëllonte që ndonjë djalë trokiste në ndonjë «derë të madhe» e u kërkonte vajzën për nuse. Atëherë delte i zoti i shtëpisë dhe bëhej pyetja: «Nga ç'derë është dhëndri?» E meritonte vajzën po të ishte edhe ai nga ata: nga «dera e madhe». Natyrisht ky është kriter klasor vlerësimi.

Por revolucioni ynë popullor, i udhëhequr nga Partia, e ndërpreu në mes këtë «lojë» ironike të kohës. Ata të «dyerve të vogla» hynë në «të mëdhatë» dhe anasjelltas. Në këtë pjesë të dytë të «lojës», pra, u bë si të thuash një «ndërrim portash»... Tani të këqij janë ata të ish-«derës së madhe», që ne i quajmë element i deklasuar. Ka nga ata tani që ndonjëherë trokasin në derën tonë për të na kërkuar vajzën.

Dhe ne dalim te dera jonë dhe pyesim: «Si e ka biografinë dhëndri?». E meriton vajzën tonë, po qe se është nga «dera» jonë; po qe se është nga klasa jonë. Dhe ky është kriteri klasor i vlerësimit,

që ne mundohemi ta zbatojmë fort. Sepse, si mund të bëjmë ne krushqi me atë që dje na binte me kurrizin e dorës turinjve e na rrëzonte kotheren e bukës nga dora? Si mund t'i japim ne vajzën tonë, motrën tonë për grua djalit të atij që dje na e ngulte thikën në palcë të kurrizit, që na vrau vëllanë në gjumë, që i skuqi gjoksin me plumba babait tonë, që i lidhi për tërë jetën në kokë shaminë e zezë nënës sonë? Prandaj Partia na porosit çdo ditë të mos harrojmë të shkuarën, na mëson ta forcojmë çdo ditë këtë kriter klasor të vlerësimit të njerëzve. Dhe gjatë këtyre dekadave, të udhëhequr nga Partia, edhe të rinjve tanë u ka hyrë në gjak ky mësim i madh i Partisë. Ne dimë mirë tani cilin të duam. Edhe cilin të dashurojmë e dimë dhe e ndiejmë mirë. Dimë edhe cilin të urrejmë. Kjo është një fitore e madhe e të rinjve dhe e prindërve tanë. Ne nuk na bën sot goja të themi «Të trashëgohesh», pa bërë më parë pyetjen «Si e ka biografinë dhëndri?» ose «nusja». Tani ky kriter klasor është bërë plotësisht sundues tek ne. Kjo masë vlerësimi ka hyrë në jetën tonë. Shembuj të tillë jeta jonë të jep qindra e mijëra. Njerëzit tanë revolucionarë i bashkojnë së pari idealët revolucionarë të Partisë. E reja nga qyteti shkon e martohet në fshat me një fshatar të thjeshtë sepse, me të e lidhi së pari ideologjia e Partisë, normat e moralit proletar. Ose të tjerë kudo në Veri e në Jugë të vendit tonë. Këto norma të moralit tonë kur janë të shkrira në ndërgjegjen e gjakun e të rinjve, nuk janë të shkëputura e qëllim në vetvete. Ato bëhen motor lëvizës dhe ndikojnë fuqimisht jo vetëm mbi mendimet por edhe mbi ndjenjat tona. Këto norma vetvetiu pastaj të diktojnë veprimin edhe në ndjenja të tilla intime

dhe njerëzore, siç janë ato të dashurisë për shokun a shoqen e jetës. Vetvetiu e natyrshëm ti e do atë kur ajo ose ai do idealet e Partisë e normat e moralit proletar, që shfaqen në kuptimin e jetës, modës, sjelljes e kryesisht në dashurinë për Partinë e popullin. Në të kundërtën përsëri vetvetiu e përsëri natyrshëm njerëzit nuk bashkohen. Le të reklamojë e të propagandojë sa të dojë borgjezia e revizionizmi dashurinë... «e kulluar»..., nga «sytë», dashurinë pa ideologji. Në esencë çdo lloj dashurie midis njerëzve është klasore. Nuk është aspak rastësi ajo që na tregonte një ditë një i ri. «Në fillim unë mendoja se e doja e do ta doja tërë jetën — tha ai — Për mendjelehtësinë time, unë vonë pyeta për familjen e saj dhe doli se i ati ishte kriminel luftë. Fillova të mendoja: «Sa ka ndikuar i ati në familjen e saj? Si do të rrijë ajo bashkë me njerëzit e mi në një mbrëmje kur do të ndizet muhabeti për luftën, kur nëna do të tregojë si na e vranë babanë banditët e Isa Toskës, kriminelët? Po xhaxhai, po motrat si do të durojnë pranë vajzën e një krimineli? Dhe unë gjithashtu?» Shkova e takova i acaruar: «Ik-i thashë, pa e parë në sy — dhe nuk të kërkoj të falur aspak, se ma fsheve babanë tënd kriminel. Po atë e njeh gjithë populli»».

Revolucionarizimi i mëtejshëm e i gjithanshëm i jetës sonë, ashpërsimi i luftës klasore në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist këtë kriter vlerësimi po e forcon gjithnjë e më shumë. Mirëpo, a e dini se sa më shumë po e forcojmë ne këtë kriter vlerësimi, aq më të shpeshta po bëhen «dëshirat» e këtyre elementëve të deklasuar për të bërë krushqira me ne, sidomos me familje komunistësh? Ç'i shtyn, vallë, këta njerëz ta shtojnë kaq

shumë «dashurinë» për vajzat e djemtë tanë? Shumëkush mund të mendojë se këtë e bëjnë për të «përmirësuar» biografinë. Edhe ne kështu menduam në fillim, mirëpo e dini ç'na tha një plakë në Berat, kur ra fjala për këtë gjë? «Ti thua se kulaku, — tha, — bën krushqi me ty për të rregulluar biografinë e tij? Jo, or bir, jo. E ke gabim. Ai e bën krushqinë për të prishur biografinë tënde. Se kulaku është si puna e nëpërkës. Ajo të kafshon jo për të marrë gjakun tënd të ëmbël, por për të lënë helmin e saj farmak....»

Dhe e kishte shumë drejt. Në këtë sulm të madh e të përgjithshëm që bëjmë ne kundër ideologjisë armike, kundër shfaqjeve të huaja borgjeze e revizioniste, armiqtë reagojnë. Mbrohen dhe sulmojnë njëkohësisht. Koha dhe kushtet i detyrojnë të bëjnë një sulm me armë të çuditshme. Jo me automatikë dhe me bomba dore, siç ndodh në fushën e betejës, por me krushqira. S'është kjo arma e vetme e rafinuar. Ata përdorin edhe darkat e drekat për të komprometuar sidomos kuadrot e komunistët, ata bëjnë gjer edhe kërkesa për në Parti. Duan ta marrin kalanë nga brenda.

Por ne tani jemi regjur në luftë me ta. Nuk e hamë sapunin për djathë. Nuk e marrim helmin për mjaltë. Vetë populli, kuadrot e komunistët, të udhëhequr nga Partia, po i demaskojnë. Por është e vërtetë se ndonjëherë, megjithëse shumë rrallë, ata edhe kanë pasur sukses me armën «krushqi». Dhe kur arrin një sukses, armiku nuk pushon, por vazhdon, për të korrur suksese të tjera. Bile bëhet më i egër. Kur i jep gishtin, ai të merr dorën. E di ç'ndodhi me një njeri të deklasuar në Mat? Kërkoj të drejtë studimi për të birin. Nuk i doli. Se duhej të venin

më parë bijtë e punëtorëve e të fshatarëve tanë. Mirëpo ai u revoltua. U ankua. «Pse të mos më jepni të drejtë studimi për djalin? — tha. — Unë vërtet jam i deklasuar, po kam edhe anë të mira. Kam bërë krushqi në një familje që ka komunistë. Peshojini anët e mia të mira dhe të këqija!». E shihni që iu ngritën pretendimet? E shfrytëzoi menjëherë mungesën e vigjilencës së krushkut të tij komunist. Krushku i dha fëmijën e vet në shtëpi, armiku donte t'i «merrte» edhe ideologjinë, donte të futej kontrabandë në klasën e tij.

Armiku i klasës ka një karakteristikë të përjetshme: ai mbetet gjithmonë tinzar. Prandaj duhet qëndruar gjithmonë vigjilentë para tij, gjithmonë syhapur.

Bënë shumë mirë në një rast në Berat që e nxorën jashtë radhëve të Partisë një vajzë që u martua me një djalë nga një familje e deklasuar. Por jo gjithmonë mbahet një qëndrim i tillë i prerë ndaj komunistëve të tillë, që duke vepruar kështu nuk meritojnë për asnjë minutë të quhen anëtarë të Partisë. Ja ç'thotë shoku Enver lidhur me këtë problem: «Ka njerëz që pyesin: A i lejohet një komunisti të martohet me vajzën e kulakut? Unë them se nuk bën mirë ai komunist që martohet me vajzën e kulakut. Te ne ka plot vajza të punëtorëve e të fshatarëve që janë të mira, të bukura, të ndershme. Po deshe, ti merre për grua vajzën e kulakut, po Partia do të të shkruajë në dokumentet e tua se ti nuk e ke të zhvilluar urrejtjen e klasës¹⁾».

«Po unë nuk e dija që ai ishte ashtu»..., kishte thënë ajo vajza. Po pse nuk pyete? Një komunist

1) Enver Hoxha. Veprat, Vëllimi 13, fq. 222-223.

vigilent duhet të dijë me cilin ka të bëjë dhe kudo, jo më me atë që martohet. Kjo është tepër qesharake. Se këtu nuk është çështja për lodra fjalësh, po për luftë klasash.

«T'i përmbahesh apo të mos i përmbahesh luftës së klasave, — u tha në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror të Partisë, — të kesh për të një kuptim të plotë ose të cekët, ta zhvillosh atë frontalisht ose në mënyrë të njëanshme, ta zbatosh atë drejt në rrugë revolucionare, apo ta dobësosh e të bësh lëshime, kjo është një çështje jetike, nga e cila varet fati i socializmit¹⁾».

...«Varet fati i socializmit...» E ç'vlen një dashuri (dashuri i thëngjin!, me armikun e klasës), e ç'vlen një burrë, një jetë qoftë, qofshin edhe qindra e mijëra jetë tonat para socializmit, që mezi po e ndërtojmë, midis këtij rrethimi të egër e të gjithanshëm? Por këta dy a pesë që veprojnë kështu nuk janë komunistë. Ata kanë hyrë kontrabandë në radhët e Partisë. Bijtë e vërtetë të Partisë kanë ditur gjithmonë ta kenë syrin pishë e zemrën të çelikutë para sulmit të armikut të klasës. Prandaj dhe luftuam dhe e çliruam atdheun. Prandaj dhe kemi arritur në këtë lartësi të socializmit dhe të ndërgjegjes sonë. Se udhëheqin bijtë e vërtetë, trimat e Partisë. Që në krijimin e saj Partia i mësoi bijtë e vet komunistë të vendosin një vijë të prerë me armikun e klasës.

Dëgjoni ç'i shkruan në një letër nga burgu së dashurës së vet dëshmori Gjikë Kuqali: «...Dhe na-

1) Enver Hoxha. «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qendrimeve liberale ndaj tyre», fq. 98.

tën i shtrirë në gjumë mendoj për ty: «Ç'ta dua N., kur ajo nuk do Partinë tonë, Partinë që na shpëtoi nga jeta e ndyrë e borgjezisë, Partinë që na ngjalli, na bëri të duam popullin, atin tonë, që na ndezi me hov në punë!, asaj i kemi dhënë jetën që ta mbrojmë, ta ngremë e ta përparojmë... Unë e dua Partinë time; ty të dua, po ta duash Partinë.. .

Gjikë Kuçali

Burgu i Tiranës

15 qershor 1944

NJERIU YNË

Po t'ju qëllojë të kaloni afër një fshati të Pogradecit ndonjë mbrëmje vonë, do të shihni tek rrëshqet me një zhurmë të fortë arave edhe një traktor me zinxhirë duke tërhequr pas plugjet e rënda. Po të ndodhte vetëm kjo, natyrisht, mund edhe të mos e vinit re, sepse traktorët e plugjet janë të zakonshëm udhëve të fshatrave. Por bashkë me plugjet, çdo mbrëmje rrëshqet pas traktorit, si një shtëpi lundruese, edhe një barakë e vogël prej dërrase, si slitë (gati 3 x 3 m), me çati të pjerrët, me derë e një dritare të vogël, krejt e ngjashme me ato njësitë sezonale të fruta-zarzavateve (me ndryshimin se në vend të frutave e të zarzavateve ajo ka një krevat, ca pjesë ndërrimi dhe, dimrit, edhe një stufë të vogël).

«Po ky, ç'na shet mend!», tha dikush kur dëgjoi se traktoristi kishte kërkuar ca dërrasa për të ndërtuar një barakë, që të flinte natën ku ta zinte puna. Ai shtëpinë e tij e kishte në një fshat larg, e shtëpia lëvizëse do ta ndihmonte mjaft të kursente kohën sidomos gjatë fushatave. Prandaj edhe traktoristi bëri sikur s'i dëgjoi ato «pëshpëshet». «Leje nuk të dua për këtë «shtëpinë» time — i tha ai një

ditë duke qeshur kryetares së këshillit, — sepse sa herë të duash ti, më thuaj, dhe unë e fus menjëherë brenda vijës së verdhë...» Kështu, me shaka, e kapërceu traktoristi atë zërin e fshehur të «dikushit». Ai ishte mësuar me këtë zë. I kishte dëgjuar ato fjalë edhe dikur, pas një mbledhjeje, në të cilën ishte ngritur e ishte zotuar që brenda një viti të bënte dy plane vjetore. Kur e takuam ai na tha se punonte për vitin 1983, se edhe gjatë vitit 1975 kishte kursyer 1 900 litra karburant dhe se dymujorin e parë të vitit 1976 planin e kishte realizuar 180 për qind.

Na mbeti në zemër ai traktoristi heroik, por s'na u harrua edhe ajo shprehja cinike «po ky, ç'na shet mend!», të cilën ata që e thonë zakonisht e thonë duke qeshur në një mënyrë të veçantë. Por, dihet, njeriu kur qesh (sido që të qeshë) shpreh një mendim... Dhe cili është më shkoqur mendimi i tyre? Mendim të prapambeturish, përtacësh. Shprehjen «po ky ç'na shet mend!» ata ia thonë në «konfidencë» njëri-tjetrit në raste mbledhjesh, për diskutimin ose miratimin e shifrave të projektplanit në ndërmarrjet ose në institucionet e tyre, kur diskutohet për ngritjen e normave të punës, ose kur dikush propozon a përkrah ndonjë iniciativë të re. Shkurt, ata thonë «mos propozo shifra të larta për planin, mos propozo ngritjen e normës, mos merr ose mos përkrah iniciativën.» Pra, përpiqen të shuajnë frymën revolucionare të opinionit tonë të shëndoshë shoqëror. Por, njëkohësisht edhe i tremben fort këtij opinionit të shëndoshë shoqëror, sepse ndryshe nuk do të flisnin «pëshpësh» në «konfidencë» me pëshpërimën: «po ky ç'na shet mend!». Le t'u themi këtyre: «Atëherë si doni ju, të bëjmë ndryshe? Doni

të rrimë si përtacë, të mos lërojmë tokën e të mos mbjellim bukën dhe t'i shtrijmë dorën tjetrit? Të mos kursejmë karburant, ta derdhim atë lumë e të na heshtin makinat e fabrikat?»?

Këtë nuk do ta bëjmë kurrë. Dhe e di kush i thotë këto? I thonë disa të prapambetur, të plogësht e burokratë, të cilët venë në punë sa «për të qenë Kola në punë». Sa të veckël e mikroborgjezë duken ata para atij traktoristi të thjeshtë, që e merрте «shtëpinë» me vete arave, ose qindra e mijëra të tjerëve, që i vënë gjoksin punës natë e ditë për të ndërtuar Fierzën e Metalurgjikun, ose për të ngritur kullat e Ballshit! Këta njerëz të vegjël me siguri do ta quanin të «krisur» shoferin Hero të Punës Socialiste, po ta shihnin tek transportonte me aq rrezik makineritë gjigante të Metalurgjikut; ata do të hapnin gojën me habi po të dëgjonin se një kooperativist, në Drenovë të Korçës në vitin 1975 bëri 1.144 ditë-punë etj. etj. Kur nuk arrijnë të të thyejnë me përshpërimën «po ky, ç'na shet mend!», ata përpiqen të të vënë etiketën «karrierist», ose «qen i lekut». Dhe kur përsëri nuk ia dalin dot në krye, ata marrin pozën e njeriut «të dhembshur», që «të qan hallin» dhe, duke të dalë këtë herë më drejtpërdrejt dhe përsëri me të qeshur (ah, e qeshura!), të goditin në një pikë mjaft delikate: «E fortë ka dalë ajo gruaja jote! Si të duron, ajo qoftë! Po ti je martuar me traktorin!», ose «je martuar me makinën»; pra lidhin sa e sa «martesa» të këtij lloji. «Më erdhi shumë rëndë një ditë, — tha traktoristi, — kur njëri më tha si me shaka: «Po ty s'të njohin fare fëmijët e tu, a derëbardhë!». Natyrisht, këta «luftëtarë kundër asketizmit», në njërën ose në tjetrën mënyrë, shpifin, sepse edhe traktoristi

edhe të tjerët Heronj të Punës Socialiste ose qindrat e mijërat punëtorë kooperativistë a intelektualë të palodhur, dinë të gjejnë kohën edhe për të punuar, edhe për t'u çlodhur në familjet e tyre e për t'u kujdesur për fëmijët, ose për të studiuar. Por puna është se ata nuk mund të kuptojnë idealin e madh të njerëzve të punës, që vënë mbi gjithçka interesin e përgjithshëm, interesin e Partisë e të socializmit. Duke qenë mikroborgjezë, ata nuk mund të ndiejnë dot gëzimin e punës ndërtimore, që vlon në të katër anët e atdheut, nuk e shohin dot bukurinë e duarve të punës dhe të kallove. Duke qenë mikroborgjezë, ata siç thotë poeti, dinë vetëm të përsërisin monologun e tyre pa jetë: «Ç'ta vrasim mendjen, rrimë në guzhinë; bie erë gjellë, pa ngrënë s'mbesim; na pihet ujë, pimë; na rriten thonjtë, i presim». Janë pikërisht këta njerëz ata që s'arrijnë ta ndiejnë rrethimin e egër imperialisto-revizionist dhe s'arrijnë ta kuptojnë se «sot situata në botë është e tillë që interesat e vendit e të mbrojtjes kërkojnë që sakrifica dhe kursimi të jenë në rendin e ditës»¹).

Ndonjëherë të duket e çuditshme se si disa njerëz të vegjël nuk gjejnë dot sy të shohin ç'bëhet rrotull tyre, ç'energji të pashtershme ka zgjuar Partia te njerëzit tanë, për të mos kursyer asgjë për atdheun, për t'i vënë shpatullat socializmit e për të punuar atje ku janë frontet më të vështira të punës e të jetës.

Pikërisht njerëz të tillë, që e ndiejnë kënaqësinë e jetës në rehatinë personale e në «qoshet e

1) Enver Hoxha. «Politika jonë është politikë e hapur, është politikë e parimeve proletare», fq. 10.

ngrohta», janë ata që habiten me aktet e heroizmit e të punës së palodhur. Por sa madhështorë ngrihen para tyre qindra e mijëra punonjës të tjerë të palodhur, në të katër anët e atdheut! Me të tillë heronj e punëtorë të palodhur është bërë e tillë, e fortë dhe e lulëzuar Shqipëria.

«NATYRISHT, PARIMIN DO TË TË TREGOJMË...»

Tregonte me një shqetësim që nuk përpiquej fare ta fshihte. Përkundrazi. Edhe me cigaren që mbante në dorë mbillte mjaft shqetësim. E thithte fort dhe pa vëmendje. Kurse kur e mbaronte, e përplaste për tokë dhe e copëtonte me majën e këpucës.

— Kërcet miku, vëlla! — tha. — Ja, mor ja, ky shefi ynë i llogarisë, ky arrogant që të tregova, kushedi sa mijëra lekë deficit doli, kushedi sa shpërdorime ka bërë! Por e hodhi lumin, ia mbyllën. Vetëm 500 lekë pagoi.

— Shumë keq, — i thashë. — Po ti i dije këto?

— Si s'i dija! — tha. — Unë me të punoj.

— Po pse nuk ia the atëherë? Atij, drejtorisë, kolektivit...

Pas kësaj punonjësi nga Lushnja, me të cilin bisedoja, ia dha një të qeshure, por në mënyrë shumë ironike.

— More, — tha duke më rënë lehtë në sup, — more, po parimin do të më tregosh ti tani? Parimin e di unë, më mirë nga ti bile, por të thashë se ai është shef dhe të fundos, ta gjen ditën...

Ç'duan tjetër, vallë, këta njerëz t'u tregojmë? Kundërparimin? Pikërisht parimin duhet t'u tregoj-

më. Atë parim të cilin pretendojnë se e dinë, por nuk duan ta dëgjojnë e ta zbatojnë.

Zëra të tillë të dobët e të verdhë prej frikacakësh dëgjon jo rrallë. Ata hiqen sikur shqetësohen, marrin poza prej të revoltuari ndaj ndonjë padrejtësie, por ngaqë janë të frikshëm, të trembur dhe s'i dalin së keqes dot përpara, të lëshojnë «bombën»: «Parimin dō të më tregosh ti tani?!». Pse? Ata janë mikroborgjezë. Dhe mikroborgjezi ka një «konstrukcion» shpirtëror të tillë, që kërkon qetësi absolute, s'duron dot më të voglën lëkundje, sepse i lëkundet interesi. Punonjësi për të cilin treguam kishte shumë dëshirë që dikush t'i kundërvihet shefit të tij arrogant e vjedhës, veç ai jo. Prandaj edhe s'para i pëlqente t'i tregojë parimin. Sepse parimi i thotë «ngriu ti i pari; që e njeh më afër». Mirëpo, «ç'është ajo fjalë!». Punonjësit mikroborgjez kjo i dukej krejt e pamundur, bile e çuditshme. Prandaj edhe zbatimi i parimit i dukej i pamundur, i çuditshëm. Ndershmërinë dhe guximin komunist këta lloj njerëzish e quajnë naivitet. Kur të shohin që ti në ndonjë mbledhje kritikon hapur, kur të shohin që i vihesh ballë për ballë së keqes, ata marrin pozën e njeriut «praktik», të «pjekur», «të regjur» me jetën. Të shohin me buzëqeshje ironike nga koka në këmbë e të thonë: «Avash, djallë, ë-ë! Mos fluturo, se bie me hundë...». Këto «këshilla», që zakonisht i japin fshehurazi e me zë të ulët, përbëjnë «filozofinë» e tyre, «teorinë» e tyre. Mikroborgjezët në këtë mënyrë përpiqen ta shpëgojnë, ta përligjin, ta vënë mbi baza «teorike» pozitën e tyre regresive në shoqëri. Duke vepruar kështu, ata nuk përligjin «teorinë», por vetveten.

E vërteta është se aty-këtu ka edhe ndonjë drejtues hakmarrës, por këtë nuk e zbuluan njerëzit e

«pjekur». Lufta dhe sukseset e gjithanshme në jetën tonë kanë në vetvete edhe përmbysjen e së vjetrës. Dhe gjatë kësaj rrokullisjeje të madhe që po ndodh në ndërgjegjen e njerëzve, ka edhe ndonjë pakujdesi, edhe ndonjë shpërdorim, edhe ndonjë inkonsekuencë tjetër. Pra, edhe njerëz të pandërgjegjshëm. Por Partia na thotë edhe një gjë: që po nuk iu kundërvumë vetë këtyre njerëzve, unë që punoj e jetoj me të, ti, ai tjetri, atëherë ato vazhdojnë të thellohen. Indiferentizmi i ushqen të metat. Sikur të veprojnë të gjithë si «të regjurit», atëherë këto të meta nuk shmangen. «Mirë, mirë, — thonë ata, — por e pëson». Po, mund të ndodhë edhe që ta pësosh në ndonjë rast. Mund të ndodhë edhe që dikur përkohësisht, të mos dalë e vërteta. Por kjo s'do të thotë aspak që kjo të bëhet shkak të mos futemi në luftë me të pandërgjegjshmit.

Vështirësitë në socializëm ne i pranojmë vetë, por ato janë vështirësi të rritjes. Vështirësi të tilla ka e do të ketë gjer në triumfin e plotë të socializmit. Por Partia është vënë vetë në ballë të luftës kundër këtyre vështirësive. A nuk po rritet çdo ditë e më tepër ndërgjegjja politike e masave, me komunistët në krye? Pikërisht Partia është ajo që po e udhëheq me sukses luftën për thellimin e demokracisë socialiste, luftën kundër shfaqjeve të liberalizmit, arbitraritetit, arrogancës. Është në natyrën e Partisë sonë të jetë armike e tyre. Që në krijimin e saj ajo ka luftuar për demokracinë në Parti e në popull. Vazhdimisht për të ka luftuar e lufton, por Partia me demokracinë nuk ka nënkuptuar asnjëherë anarkinë, ashtu siç nuk nënkupton me centralizmin arbitraritetin. Demokraci dhe centralizëm. Luftë në të dy krahët, si kundër liberalizmit ashtu edhe

kundër centralizmit burokratik e konservatorizmit. Në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror të saj, Partia i dha hov të ri guximit të komunistëve e të masave. Komunistët, punonjësit, hapur, pa frikë, kritikuan të metat e tyre, të shokut, të shoqes. Drejtori kritikon vartësit, por edhe vartësi e punonjësi e kritikon atë. Çështja është që puna e Partisë, interesat e tyre, të venë mbarë. Dhe puna po na shkon mbarë sa asnjëherë tjetër. Ky shpërthim sidomos kohët e fundit pas Kongresit të 7-të të Partisë, i energjive krijuese të komunistëve e të popullit, i guximit e i trimërisë së tyre, është i pashembullt. Të fillosh të tregosh çaste të tilla të guximit revolucionar e të kritikës parimore e pa kompromis të njerëzve tanë për të mbrojtur Partinë e parimet e saj, do të thotë të bësh kronikën e çdo kolektivi, çdo ndërmarrjeje, çdo organizate Partie, çdo komunisti revolucionar. Po kufizohemi vetëm me një moment nga jeta e një punëtori komunist, i cili na ka lënë mbresa të veçanta...

— Epo fillojmë nga mbledhja, shokë — tha sekretari i byrosë së Partisë i ndërmarrjes. — Shoku sekretar i komitetit të Partisë na lutet ta marrë fjalën i pari, sepse nga sektori ynë gjer në qytet është rrugë e gjatë dhe ai duhet të kthehet shpejt.

Në fillim u bë pak qetësi. Pastaj ca përshpëritje dhe më në fund një zë:

— Me leje? Unë nuk jam dakord me ngutjen tuaj, shoku sekretar i komitetit. Ju e dini: me detyrat e planit nuk jemi aspak mirë dhe jo vetëm për fajin tonë. Detyrën e Partisë nuk po e bëjmë si duhet. Na vjen turp nga vetja. Po e marrim paranë kot. Kur ju pamë ju, thamë: «Shyqyr që erdhi sekretari i komitetit të Partisë, dhe ta pleqërojmë mirë këtë punë»

kurse ju, akoma pa thënë «si u ngrysët» kërkoni të ikni. Po të jetë për të na folur ca fjalë, pa na dëgjuar edhe ne, më mirë ikni. Ato fjalë mund të na i dërgoni edhe me letër...

— Kush je ti që flet kështu? — pyeti i nervozuar sekretari i komitetit.

Ai që foli në fillim u çua prapë.

— Unë jam një punëtor, — tha, — një komunist.

— Ashtu?! Po e di ti që unë jam sekretar i komitetit të Partisë?!

— Nuk ka sekretar pa komunistë, — tha punëtori. — Veç kësaj ju, jo vetëm nuk duhet të nervozoheni, por edhe duhet të rrini e të na dëgjoni pa u ngutur për në shtëpi. Ne një herë në dy-tri javë shkojmë në shtëpi, kurse ju, edhe sikur gjer nga ora 8-9 e darkës të rrini, e keni telefonin në shtëpi dhe mund të njoftoni që të mos bëhen merak...

«Drejt fole, — i thanë punëtorët. — Të lumtë!» Kanë marrë një hov të mëtejshëm të ri mendimi i lirë i masave, iniciativa, prodhimi. A nuk e vërejnë këtë ata elementë mikroborgjezë që ndodhen midis masës dërmuese revolucionare, në uzina, në lagje, në shkolla, kudo? Nuk duhet të habitemi nga verbëria e tyre. Psikologjia e mikroborgjezit është e tillë që i jep bartësit të vet disa karakteristika të çuditshme. Ajo i mjegullon të parët, e bën të shikojë vetëm veten. Dhe me metrin e vet mundohet të masë edhe të tjerët. Mikroborgjezin e çudisin aktet e heroizmit të luftës ose të punës. Ai nuk i shpjegon dot. Ose më mirë i shpjegon sipas mënyrës së vet. I shpjegon si rastësi, jo si një shkallë e lartë e ngritjes së ndërgjegjes politike të masave. Kjo e bën atë t'i mbajë veshët ngritur vetëm pranë zemrës së vet e të thotë se vetëm ajo rreh në botë... Mikroborgjezët

janë shpifës, denigrues të realitetit. Sepse kanë «maçokun» në zemër, siç thotë populli.

Kur për vete puna u shkon mbarë e janë të gëzuar, s'ua ka qefi t'u ngjajë njeri, s'u pëlqen që edhe të tjerët të jenë të kënaqur si ata. Po kur kanë ndonjë hall? Atëherë ndryshon puna. Në këto raste ata duan që të gjithë të tjerët të jenë të shqetësuar, të mërzitur, të pakënaqur. Dhe kur e shikojnë që s'ka të tillë, ata përpiqen të «krijojnë». Në përgjërimit e tyre, në frazat e tyre të dhimbshme e të mbushura me pasthirrma, rri dashuria për vetveten. Njërin në Burrel, para ca kohësh e kishin transferuar në një fshat për t'u njohur më mirë me jetën. Ai qahej e betohej se ia kishin bërë pa të drejtë, se ishte i edukuar më së miri. Dhe, siç e paraqiste punën ai, të dukej sikur i kishin rënë më qafë kot.

— Mirë, — i thamë, — kur qenka puna kështu, pse nuk e bën çështje?

— E mirë, mirë, — tha. — Do të më tregosh parimin mua ti. Po pse mua do të më japin të drejtë?...

Kështu tha ai. Mirëpo kur pyetëm, na thanë se kishte bërë edhe këtë, edhe atë... Pas këtyre, binde she me të vërtetë se ai ishte një njeri me shumë të meta, dhe se vendimi i marrë lidhur me të për të punuar në fshat, në gjirin e masave, ishte plotësisht i drejtë. Këta mikroborgjezë në momente të tilla qëmtojnë me këmbëngulje «për të gjetur» raste të veçanta padrejtësie, nga janë e nga s'janë, pyesin për këtë qëllim kudo. Dhe kur ilustrimi për idenë e tyre nuk është i saktë, ata e marrin, e përpunojnë, e shtrembërojnë, e interpretojnë dhe «ja, — të thonë, — edhe filanit kështu ia punuan. Të mbushet mendja që edhe unë kam të drejtë?». E shihni çfarë «argumentesh» përdorin? Hiqen sikur u qajnë ha-

llet të tjerëve, por në fakt të tjerët i «grumbullojnë» për t'i vënë në funksion të vetes. Është natyra e pesimistit mikroborgjez t'i zmadhojë shfaqjet e rastit, t'i përgjithësojë, t'i kthejë në tendencë. Por kjo është e natyrshme. Në kushtet e zhvillimit të vrullshëm të vendit tonë, do të precipitojnë edhe njerëz të dobët. Detyra e të gjithëve është t'i shkundim ata. Dhe kjo arrihet kur këta t'i fusim thellë në vorbullën e madhe transformuese e të gëzuar të jetës sonë. T'i bëjmë t'i shohin qartë sukseset e mëdha të arritura nga Partia e populli në kushtet e rrethimit të egër imperialist e revizionist. Pikërisht ky besim në fitoret e mëdha, që bazohet në njohjen e ligjeve objektive të zhvillimit shoqëror dhe të vijës së drejtë të Partisë, do t'i hedhë edhe ata, të vendosur në luftë e të bindur plotësisht për fitore.

Nuk janë të rrallë njerëzit që thonë: «Parimin do të më tregosh ti?» dhe vetë kanë frikë nga parimi; «të regjurit» me jetën, që thonë «mos fluturo», e vetë hiqen zvarrë. Por veç jo shpesh ndodh që pikërisht këto biseda të «rastit», ky dialog i këmbyer me mikroborgjezin në rrugë, në kafene, ose te porta e ndërmarrjes, të bëhen objekt i një mbledhjeje. Pse? Për mbledhjet kërkohen ndonjëherë gjëra më të mëdha, më të forta. Ka edhe shumë probleme të tjera, të mëdha e të rëndësishme, por edhe analiza e atij «dialogu» nuk është problem as i vogël, as i parëndësishëm. Po të thellohemi në trajtimin e tij ideologjik e politik, atëherë koncepti i huaj do t'i zbulojë hapur gjymtyrët e veta, do të bëhet fare i dukshëm, i kapshëm dhe lufta kundër tij me efekt.

SHFAQJE QË STRUKEN PO NUK ZHDUKEN LEHTË

Çlirimi i nënave, grave e motrave tona nga skllavëria e dyfishtë është një nga fitoret më madhështore të epokës së Partisë. Ato ecin tani në botën tonë të re e të bukur socialiste plot dinjitet. Nuk thonë më si dikur: «O ju malet me dëborë, pse s'qani halllet e mia!» Në ditët më të vështira atyre iu gjet pranë Partia, e cila çlirimin e plotë të gruas shqiptare nuk e ka parë si çështje sentimentesh, por si çështje vije, si pjesë përbërëse të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit. «Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, — tha shoku Enver në fjalimin historik të 6 shkurtit, — të djegin me zjarr zakonet prapanike e t'i këpusin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave e të vajzave»¹⁾. Forcat dhe energjitë krijuese që zgjoi Partia tek gratë e vajzat tona janë të pallogaritshme. Ato sot ecin plot dinjitet e krenari krah për krah burrave e vëllezërve të tyre. Pjesëmarrja e tyre në të gjithë sektorët e prodhimit si punonjëse e si drejtuese

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», fq. 8.

janë grushte të fuqishme që i janë dhënë konservatorizmit.

Shikojini ato në aksione, në institucionet kërkimore shkencore, në auditorët e Universitetit, si ministre, si deputete të Kuvendit Popullor, si anëtare të Komitetit Qendror të Partisë, etj... dhe do të vëreni njëkohësisht veprën monumentale të Partisë të ngritur në sajë të luftës që udhëheq Partia kundër konservatorizmit. Shikojini në familje e në shoqëri duke gëzuar dashurinë dhe respektin e mbarë njerëzve tanë.

Por ka akoma prapanikë që i trishtojnë disa nga vajzat tona dhe u prishin, qoftë edhe përkohësisht, gëzimin e jetës, që Partia ua siguroi me gjak e sakrifica. Një mësuese e re mbaroi shkollën pedagogjike dhe për herë të parë zuri t'u mësojë femijëve të shkruajnë fjalën «Parti». Por i ati, një prapanik i keq, i preu gëzimin në buzë. Ai e gënjeu të bijën dhe ia dorëzoi «dhëndrit» e vëllait të tij. Vajza nuk e donte atë me të cilin e kishin fejuar që kur ishte 7 vjeç. «Urdhëro, — i tha i ati i saj dhëndrit, — ta solla. — Tani nuk të kam asnjë borxh»...

Kundërshtoi vajza, por ata ja mbyllën derën. Një skenë pak a shumë e tillë ndodhi edhe në një rreth tjetër. Për më keq, «dhëndri» këtë herë ishte edhe komunist!

Në të dyja rastet, patriarkalët nuk ia arritën dot qëllimit. Po përse na ndodhin këto gjëra? Këto e kanë burimin në disa botëkuptime të vjetra patriarkale, që e kanë bazën në pronën private. Është zëri i egër i kanunit që vjen nga shekujt dhe përcillet nëpër ndërgegjet e prapanikëve: «...Baba ka të drejtë me rrahë, me lidhë, me burgosë e me

vra të birin dhe të bijën... Gjaku i grues ban 1500 grosh». Duhet t'u hapim breshëri të pandërprera zjarri këtyre zakoneve prapanike, që dëmtojnë shoqërinë tonë, që hidhërojnë jetën e lumtur e të gëzuar të të rejave tona. Këto zakone prishin harmoninë dhe unitetin tonë, që është edhe dëshira dhe detyra e armikut të klasës, sidomos në kushtet e sotme të rrethimit imperialisto-revizionist. Ai përpiqet që me çdo kusht të ketë vatra të tilla të patriarkalizmit, të gjejë në këto vatra ndonjë thëngjill akoma të mbetur, t'i fryjë e të krijojë flakë për të djegur fitoret tona.

Shkaku tjetër që na ndodhin disa herë këto shfaqje të shëmtuara, janë edhe të metat në punën tonë. Disa mendojnë me mendjelehtësi se lufta kundër konservatorizmit mbaroi, u fitua. Tani e «ka radhën» liberalizmi. Sa gabim! Përse duhet të mendojmë se lufta kundër patriarkalizmit mbaroi, kur presioni mikroborgjez, i frymëzuar nga psikologjia e pronës private, ekziston akoma? Përse ta luftojmë armikun nga njëri krah, kur ai na sulmon nga të dy krahët? Në Kongresin e 7-të të PPSH u theksua se Partia jonë ka qenë gjithnjë kundër çdo lloj shtrembërimi e nënvleftësimi të orientimit të saj për një luftë ideologjike e konsekuente në të dy krahët, si kundër liberalizmit, ashtu edhe kundër konservatorizmit. Ajo ka qenë dhe është kundër çdo lloj spekulimi, që në emër të luftës kundër njërit krah, të lihet pas dore ose të harrohet lufta kundër krahut tjetër.

Shfaqjet e vetëkënaqësisë janë një nga arsyet që kemi akoma zakone të tilla poshtëruese. Vetëkënaqësia, sidomos dehja nga sukseset e arritura, lufta vetëm në një krah krijon një gjendje gjumi.

Pas kësaj gabimet e vogla trashen e bëhen shqetësuese dhe, më në fund, shumë të rrezikshme, pikërisht sepse ato i quajnë gjëra të vogla, të rastit, dhe luftën kundër tyre, duke u nisur nga ky mendim i gabuar, disa e bëjnë kur i kujtojnë të tjerët ose, kur u «pëlçet bomba në dorë», pra me fushata. Ndryshe s'kanë si shpjegohen rastet e sipërme. Vajza nga fshati kishte dy vjet e fejuar me mblesëri. Përse opinioni shoqëror në fshat qëndroi indiferent ndaj kësaj gjendjeje për dy vjet me radhë? A nuk duhej dënuar publikisht kjo fejesë që kur u fillua? Duhet pasur në mend të ditës shfaqje të tilla, pasi këto nuk vihen re vetëm atje, dhe vetëm në një rreth. Kjo luftë duhet zhvilluar jo me fushata, por çdo ditë dhe në të gjitha drejtimet, në të gjitha aspektet ku mund të shfaqen fenomenet e botës së vjetër. Nga lënia në harresë ose nënvleftësimi i kësaj lufte ka ndodhur që në disa raste të kryhen nëpër familje të veçanta festa të kësaj ideologjie tinzare, të bëhen shpenzime të tepërta në dasma e vdekje, të përgatiten paja të mëdha etj. Këto shfaqje janë të huaja e të papranueshme për ideologjinë tonë, për rendin tonë socialist, po aq sa janë të rrezikshme, të dëmshme e në esencë konservatore edhe shfaqjet e huaja të ideologjive borgjeze e revizioniste. Siç na mëson Partia, karakter konservator kanë jo vetëm ideologjitë e vjetra, që vijnë nga thellësitë e shekujve, por edhe ideologjia e kultura e sotme e degjeneruar borgjeze e revizioniste, i gjithë liberalizmi e modernizmi i tyre. Për t'u prerë rrugën këtyre shfaqjeve, në radhë të parë duhet njohur thellë problemet, familjet dhe njerëzit. Kjo njohje e thellë dhe e gjithanshme të bën të mos veprosht vetëm kundër shfaqjeve, por të ndalesh mi-

rë tek botëkuptimet që i pjellin këto shfaqje. Këto botëkuptime nuk zhduken menjëherë, sepse kanë ndenjur për dekada të tëra në mendjet e njerëzve. Prandaj këto koncepte patriarkale duhet të zbulohen aty ku janë dhe të goditen me ashpërsi që në lindje, që të mos ntrashen e të bëhen shqetësuese.

Kritika e hapur publike me fletërrufe është shumë e efektshme. Organizatat e rinisë të disa fshatrave mund të shfrytëzojnë eksperiencën e mirë të disa organizatave të rinisë punëtore që me anën e fletërrufëve e të karikaturave po i luftojnë me shumë sukses disa shfaqje të huaja në modë e në sjellje.

Ndryshime kolosale janë bërë në jetën shoqërore të vendit tonë, në marrëdhëniet shoqërore të njerëzve, si dhe në botëkuptimet e tyre filozofike. Për lidhjet martesore Partia jonë ka përcaktuar një vijë të qartë marksiste-leniniste. Ajo inkurajon një martesë të shëndoshë, të qëndrueshme, duke pasur parasysh në radhë të parë kriteret klasore, pëlqimin e lirë e të hapur të çiftit, inkurajon një dashuri të singertë e të pastër proletare. Këto kritere krijojnë bazën e harmonishme të një familjeje të shëndoshë. Kështu mendonte të vepronte një vajzë e re nga një fshat tjetër i Jugut, prandaj edhe vendosi të mos martohej me atë me të cilin e kishin fejuar pa dëshirën e saj kur ishte fëmijë 12 vjeç. Mirëpo prapanikët e të dy familjeve u alarmuan, e quajtën qëndrimin e saj të drejtë «shkelje të nderit». Kështu ndodh gjithmonë me patriarkalët: të mbash ata dhe kanunin mbi zverk, ky është për ta kulmi i ndershmërisë e i drejtësisë, kurse demokracinë ata e quajnë shturje, liberalizëm. Ata nuk kanë besim te të rinjtë. Rastet e veçanta që mund të

ndodhin me ndonjë të ri ose të re ata zënë e i tjerin, i fryjnë, i zmadhojnë, i përgjithësojnë dhe nuk shohin jetën e mrekullueshme e me moral të lartë shembullor të rinisë sonë. Kështu ndodhi edhe me prapanikët e atij fshati. Që vajza të «mos e shkelte» nderin, një ditë «dhëndri» me një tjetër e rrëmbyen me forcë. Njerëz të tillë prapanikë arrijnë deri në krime.

Edhe në këtë rast të fundit, rrënjët e së keqes duhen kërkuar edhe tek indiferentizmi e fushatizmi në punën edukative. Duke qëndruar pranë njerëzve, pranë familjeve të tyre, t'ua njohim nga afër shqetësimet atyre që kanë preokupime të tilla. Duhet të ngrëmë në këmbë gjithë opinionin shoqëror kundër këtyre shfaqjeve të shëmtuara për jetën tonë. T'u krijojmë atyre një atmosferë mbytëse publike, të përgjithshme si gjithmonë. Partia po i jep një lulëzim të jashtëzakonshëm jetës materiale e shpirtërore të nënave e të motrave tona. Ky është ligji i revolucionit dhe s'ka forcë që ta ndalojë, sepse ai vepron edhe jashtë vullnetit të këtyre prapanikëve.

««Xha Emrush» duhet të jetë konsekuent, duhet të ndjekë revolucionin — thotë shoku Enver. — Në qoftë se nuk i kupton këto gjëra, Partia duhet të bëjë përpjekje të mëdha që ai t'i kuptojë; në qoftë se nuk është i bindur, ta bindim; në qoftë se nuk bindet, ta neutralizojmë; në qoftë se, më në fund, ai ngre dorën kundër revolucionit, atëherë diktatura e proletariatit e shtyp»¹).

1) Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1969-1970, f. 150.

JO VETËM KUR TË SHKELIN NË KALLO...

«Në institucionin tonë ka mjaft shfaqje të burokratizmit dhe fryrje të tepërt të organikës. Veç kësaj ka edhe tarafilëqe dhe shkelje të normave...» Kur lexon këto radhë të letrës së një punonjësi, të lind një mendim i mirë në kokë për këtë njeri, që iu dhemb çështja e Partisë dhe shkroi. Mirëpo, për fat të keq, letra e tij nuk mbaron këtu. Themi kështu, sepse paragrafët e mëvonshëm të kësaj letre t'i thyejnë iluzionet:

«Në diskutimin popullor lidhur me shfaqjet burokratike unë kam dhënë mjaft mendime konstruktive, por si shpërblim më futën në listën e shkurttimeve dhe më caktuan jashtë Tiranës. Nuk është e drejtë. Porsa krijova familjen... Kam dhe një nënë në ngarkim. Ajo është shumë plakë...»

E shihni ku doli koka e muhabetit? Ky njeri mori në dorë lapsin dhe e shkroi këtë letër jo i frymëzuar nga motivet e larta të interesit të përgjithshëm, jo se iu dhemb çështja e Partisë, siç pretendon me pompozitet, por sepse iu dhemb vetja. Nuk janë të rralla raste të tilla, që njerëz të ndryshëm revoltohen, ankohen dhe akuzojnë të tjerët vetëm kur u preket interesi i tyre, vetëm kur i shkelin në kallo. Me të drejtë mund t'i pyesësh

këta njerëz: Ju i dinit që më parë këto gjëra të këqija dhe gjersa pretendoni me të madhe se niseni nga interesi i përgjithshëm, pse nuk i denoncuat më herët? Po sikur juve të mos ju shkelnin në kallo? Atëherë asnjëherë nuk do t'i kundërviheshit së keqes? Interesi i përgjithshëm nuk është diçka abstrakte e jashtë secilit prej nesh veças. Duke mbrojtur e luftuar për të, secili prej nesh mbron njëkohësisht edhe interesin vetjak.

«Partia kërkon jo vetëm nga çdo komunist, por edhe nga çdo punonjës, — thekson shoku Enver, — që ta thotë hapur e pa frikë fjalën e tij, të mos jetë sehirxhi, por të reagojë e të veprojë kur shikon se shkelen e shtrembërohen direktivat e Partisë e ligjet e diktaturës së proletariatit, kur abuzohet e spekulohet me lirinë e demokracinë proletare»¹). Kur nisesh nga këndvështrimi thjesht personal e subjektiv, mikroborgjez, edhe reagimi ndaj një vendimi që merret ndaj teje do të jetë i tillë, subjektiv, i gabuar. Njerëzve të tillë edhe një vendim i drejtë që merret ndaj tyre u duket padrejtësi, goditje. Dhe i hedh aq shumë «përpjetë» kjo dhembje për vetveten e vogël, ua mjegullon aq shumë të pamit, sa zënë e flasin, zënë e shkruajnë gjëra të atilla që stonojnë krejt me atmosferën kaq entuziazte e revolucionare që është krijuar në të katër anët e atdheut. Bile kërraba u tërheq aq shumë nga vetja, sa nuk arrijnë të kuptojnë se ç'thonë e ç'shkruajnë. Sepse është afër mendjes. Mos vallë sipas atij punonjësi të ri që përmen-dëm, të gjithë të martuarit rishtas duhet të qëndrojnë në Tiranë?(!) Po në Veri nuk jetojnë të rinj të

1) Enver Hoxha «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre», fq. 85.

sapomartuar? Fryma e lartë revolucionare e qindra të rinjve që po shkojnë për të punuar e jetuar gjithmonë në fshat, duhet ta frymëzojë atë. Ai flet për nënën e tij plakë. Mos vallë në Veri nuk jetojnë qindra e mijëra gra e nëna? Jetojnë, bile shumë mirë, sepse atje ka një klimë të mrekullueshme dhe, aq më tepër, edhe atje ndërtohet socializmi si në çdo skaj të atdheut tonë. Ky njeri, jo vetëm që është i papjekur ideologjikisht, ndryshe nga ç'pretendon, por nuk ka as dashuri, as pasion, për profesionin e tij. Si nuk e frymëzojnë atë jeta dhe sukseset e punonjësve tanë në çdo skaj të atdheut? Si nuk e frymëzon ajo gatishmëri e lartë revolucionare e qindra e mijëra punonjësve e kuadrove tanë, që bashkë me familjet e tyre shkuan të punojnë e të jetojnë në skajet më të largëta të atdheut, në qytet e në fshat? Dhe po punojnë atje në mënyrë shembullore, Në punë e mes njerëzve të thjeshtë ata kanë gjetur gëzimin e vërtetë të jetës. Ose le të kujtojmë dhjetëra e qindra të rinj e të reja të qyteteve që kanë shkuar për të punuar e jetuar përgjithmonë në fshatrat tanë të bukur socialistë. Sa admirim ngjallën tek njerëzit tanë ata të rinj e të reja fierakë që shkuan në Hoxharë e gjetkë! Me sa respekt e dashuri e dëgjonin delegatët e Kongresit të 7-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë atë të riun e qytetit të Ersekës që bashkë me mjaft të rinj të tjerë dhe me shoqen e vet, vendosën e shkuan të punojnë e të jetojnë në fshat, etj. etj. Të gjitha këto flasin së pari për pjekurinë e lartë politike të njerëzve tanë. Ata shkuan në fshat si revolucionarë e po punojnë si revolucionarë, pa vrrarë mendjen të shkruajnë letra për ankesa a pendime.

Letrat nga populli janë një thesar i madh për

Partinë, janë një burim i pazëvendësueshëm informacioni. Me anë të tyre Partia bisedon me popullin. Dhe në këto biseda, shqetësimi nuk është për «shtëpinë time», ose për «kopshtin tim», por për çështjen e Partisë e të popullit. Në këto letra të thjeshta e pa bujë punëtorë, fshatarë, intelektualë revolucionarë, shprehin dashurinë për Partinë, shprehin gatishmërinë e propozojnë të shkojnë të punojnë në frontet më të vështira të ndërtimit të socializmit. Ato nuk janë letra, ato janë poezi. Ka në to edhe ankesa, por jo të nisura nga motive personale. Para ca kohësh, në Komitetin e Partisë të një rrethi të Veriut shkoi një letër. E dërgonte një plak nga një rreth tjetër. Ai shkruante i shqetësuar se ato ditë duke kaluar rastësisht në një nga fshatrat e këtij rrethi kishte parë disa gra që mbanin shami të zeza në kokë. «**Është zakon i vjetër, — thoshte në atë letër. — Të vërë dorë Partia**». Ç'e shtyti këtë plak të vjetër të merrte mundimin e të shkruante letër? Asgjë personale, vetëm çështja e madhe e Partisë. Ose edhe qindra letra të tjera që i vijnë Partisë, nisen nga motive thjesht shoqërore e aspak personale. Partia lufton që asgjë e keqe të mos zërë vend në trupin e shëndoshë të shoqërisë sonë. Por të metat, kudo që shfaqen, që të shmangen, duhet të luftohen e të ndreqen nga të gjithë e sistematikisht, sa herë që vihen re. Mirëpo kur ti, si qytetar, të metat që ke rrotull i sheh, por i lë të trashen dhe ngrihesh kundër tyre vetëm kur ato të prekin ty, kjo do të thotë se ti i denoncon këto duke u nisur nga interesi vetjak. Natyrisht, me këtë nuk duhet nënkuptuar aspak se duhet të heshtësh kur të bëjnë një padrejtësi ty personalisht, sepse padrejtësia e ka emrin padrejtësi dhe është e dënueshme nga Partia, pasi

cenon normat e saj, edhe kur i bëhet njeriut që ankohet. Por, siç ankohemi të revoltuar për padrejtësinë që na ka bërë ne dikush, aq më tepër dhe me më shumë rreptësi, duhet të ngrihemi të denoncojmë a të kritikojmë në mbledhje, me letra e me fletërrufe mu në mes të qytetit a të fshatit, edhe ata që dëmtojnë, fjala vjen, pronën e përbashkët, që i shmangen qarkullimit, që bëjnë tarafilëqe e shkelin normat morale të shoqërisë sonë, vijën e Partisë.

Disa nuk e kuptojnë se fshati dhe punët e bujqësisë janë nga frontet më të rëndësishme të socializmit, atje prodhohet buka, prandaj duhet shkuar me gëzim e dëshirë. Problemi i një punonjësi të një institucioni ishte fare i qartë. Siç thoshte vetë, «jam diplomuar agronom, por deri më sot nuk e kam ushtruar asnjë ditë këtë profesion. Më kanë caktuar agronom në rreth». Bukur fort. Çdo gjë normale. Pothuaj gjithë kohën kishte punuar në qytet, në të njëjtin vend, e tani duhej të qarkullonte. Ku më mirë se në fshat ky agronom do ta gjente gëzimin e jetës e kënaqësinë e punës? Por ja «argumentet» e tij: «Nuk kam as kundërshtimin më të vogël për të më qarkulluar. Këtë e kam shprehur edhe në mbledhjet e kolektivit. Mirëpo kam kërkuar që të merren parasysh: puna ime e gjatë me librin, moshën, dhe sëmundjet... Jam prej disa vjetësh me hipertension dhe me sëmundje të tjera që shoqërojnë moshën. Sapo qëndroj pak në diell, kur bie rasti, më fillon një dhembje e madhe koke, më ngrihet tensioni, të cilin arrij ta stabilizoj pas shumë ditësh vetëm nëpërmjet rezepinës...». Po atëherë cilat mbeten «argumentet» e tij? Ka harruar profesionin? Le ta kujtojë. Është i sëmurë? Në çdo rreth

ka spital e rezerpina... Këto janë vërtet qesharake. Arsyeja serioze është ajo që letërshkruesi e thotë vetë në fund të letrës: «Më ka pëlqyer dhe më pëlqen t'i mbyll edhe këta 5-6 vjet me librin...» (kupto qytetin).

Ç'nuk i punon mendja mikroborgjezit!

Po të qe se këta njerëz, me modesti e pa bujë, do të ngriheshin e të shkonin atje ku i duan atdheu e puna, atëherë askush nuk do t'i kursente lavdërimet për ta e do t'u thoshte «ju lumtë!», siç po u thonë qindra e mijëra punonjësve revolucionarë, që ngrihen vetë, pa u thënë kush, e bashkë me familjet e tyre shkojnë të punojnë e të jetojnë përgjithmonë në fshatin tonë të bukur, ku prodhohet buka e ndërtohet jeta e gëzuar socialiste, në Fierzë, në Ballsh a në Tropojë, në secilin nga fshatrat a qytetet tona. Kudo.

INDIFERENT NUK ËSHTË VETËM AI QË HESHT

Jo rrallë, kur portretizojmë indiferentin, ne bëjmë një gabim: quajmë ndonjëherë të tillë vetëm ata që heshtin ose që nuk ndërhyjnë për të kritikuar e zhdukur diçka të keqe, që zë vend midis nesh e që na pengon të bëjmë përpara. Doemos, këta janë indiferentë. Veprimet e tyre janë shprehje të individualizmit borgjez e mikroborgjez përderisa shmangen, hiqen mënjanë, ruajnë lëkurën e tyre, kur është fjala për t'u angazhuar në luftë me të keqen. Por duhet të kemi një koncept akoma më të gjerë për indiferentizmin e indiferentët.

Dihet mirë se socializmi ka nevojë jo vetëm të zhdukë rrënjët e çdo të keqeje, por edhe të lindë e të zhvillojë filizat e së ardhmes. Pra jo vetëm të dërrmojë e të zhdukë, të mohojë të vjetrën reaktionare, por edhe të ndërtojë, të pohojë të renë. Kjo do të thotë se, të jesh luftëtar i socializmit duhet jo vetëm të kritikosh të metat që sheh, por dhe të përqafosh e të marrësh pjesë aktivisht në çdo lëvizje të re revolucionare. Vërtet bën mirë kur kritikon një zakon prapanik, që vë re në bllok, lagje e fshat, por duhet njëkohësisht që në bllok, lagje a fshat të futësh edhe zakone e norma të reja socialiste, proletare. Bën mirë që kritikon nëpër

mbledhje ata që në një formë e në një tjetër kremtojnë festa fetare, po njëkohësisht duhet të vrasësh mendjen si e qysh mund të futen e të festohen më mirë në lagjen e në fshatin tënd festat e reja patriotike revolucionare, që afirmojnë të renë tonë. Po bëre vetëm të parën, po mbete vetëm tek mohimi i së vjetrës, pa pohuar aktivisht të renë, përsëri je indiferent. Në mjaft fshatra të rrethit të Lezhës lufta kundër indiferentizmit po manifestohet jo vetëm duke luftuar normat, zakonet prapanike, mbeturinat e ritet fetare, por edhe duke i zëvendësuar ato me zakone të reja, duke futur gjerësisht në jetën e kooperativistëve mënyrën socialiste të jetesës. Në mjaft fshatra të këtij rrethi tanimë nuk festohen festat fetare, po përvjetorët e Çlirimit, dita e Reformës Agrare, dita e krijimit të kooperativës etj. Indiferent në kushtet tona është ai që, duke vënë interesin personal mbi atë të përgjithshëm, u shmanget vështrësive, «ruan» veten, familjen, rehatinë personale e familjare, nuk futet në shqetësimin masiv të Partisë e të popullit tonë, jo vetëm për të zhdukur çdo gjë regresive, mbeturinë të së kaluarës e influencë të ideologjive borgjeze e revizioniste, por edhe për të përkrahur çdo gjë të re, socialiste, proletare. Le të marrim ndonjë shembull të thjeshtë për ta ilustruar këtë ide. Para disa kohe ishim në zyrën e njërit prej sekretarëve të Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit. Ishte orari i pritjes së popullit. Midis atyre që u ankuan ishte edhe një shofer i parkut të eksportit, komunist. Përse ankohej? Ndërsa dhjetëra shoferë të parqeve të ndryshme të vendit tonë kanë shprehur dëshirën për të punuar disa vjet në ndërtimin e hidrocentralit të Fierzës, duke mos qëndruar indiferentë kështu në luftën për një front të ri të

socializmit, ai shofer për të cilin flasim tha: «Unë pranova kot, po nuk dua të shkoj në Fierzë». Dhe pse? «Unë vetë kam qenë partizan, — tha, — dy vëllezërit e mi po ashtu kanë qenë partizanë. Veç kësaj, — shtoi — kam qenë menjëherë pas Çlirimit edhe në disa aksione të rindërtimit. Kështu që e kam mbaruar detyrën time. Tani e kanë radhën të tjerët». Dëgjuat? A mund të thuhet se kjo është logjika e një njeriu që jeton me shqetësimet e Partisë e të popullit tonë, të qindra e qindra punonjësve të Shqipërisë që po ngrenë veprën e madhe të dritës? Në asnjë mënyrë! Cilido ka të drejtë të pyesë: cilat janë detyrat e këtij komunisti këtej e tutje, përderisa detyrat e Partisë i paska mbaruar? Është e tepërt të thuhet se detyrat e komunistit nuk mbarojnë kurrë, apo se janë më të vështirat. Pas kësaj le të thonë sa të duan se ai shofer nuk hesht në mbledhje, se ai kritikon. Ai në esencë mbetet indiferent. Njeriu nuk peshohet nga fjalët boshe e pompoze, bile as edhe nga kritikrat që nuk sjellin ndonjë «zarrar» për të. Çdo njeri, aq më tepër një komunist, peshohet në aksionin konkret revolucionar, në gatishmërinë aktive për të përkrahur e ndërtuar të renë revolucionare.

Në gazetë para disa kohësh u botua një njoftim i thjeshtë për një iniciativë të disa punëtorëve e specialistëve të uzinës «Partizani». Vërtet, na thanë për disa prej tyre, janë fjalëpakë, por ata vendosën që së bashku me familjet e tyre të punojnë përgjithmonë në Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit. Po a duhet ta quajmë indiferent ndonjërin prej tyre, sepse nga natyra vjen ca i heshtur? Fjala e tyre në mbledhjen e fundit, kur thanë «Do të shkojmë të punojmë me gjithë familjet e përgjithmonë në

Kombinatin Metalurgjik» nuk peshohet me qindra diskutime. Natyrisht diskutimet, kritikak në mbledhje a kudo qofshin, kanë rëndësinë e tyre të madhe, por veç ka edhe llafazanë e demagogë, që me fjalë përpiqen të tregohen më të «hedhurit», hiqen më revolucionarët, të krijojnë përshtypjen se janë aktivistët më të dalluar, bëjnë edhe kritika (bile me pasion të madh), kur e shohin se nga ajo kritikë s'i gjen gjë, ose kur atij që kritikohet i ka dalë boja dhe i është kundërvënë tërë kolektivi. Secili e ka për detyrë t'i demaskojë e t'i zhveshë këta pseudorevolucionarë të maskuar me fraza revolucionare, t'i peshojë me punën, jo me gunën, t'i peshojë me kontributin real, sakrificën konkrete që bëjnë sot për shoqërinë e socializmin.

Frymëzimet idealiste, individualizmi, e bëjnë indiferentin që, në kushte e ambiente të ndryshme, të marrë pamje të ndryshme, të përshtatet. Ai s'ka si të rrijë gojëkyçur kur të gjithë flasin. Është i detyruar të thotë edhe ai dy fjalë: «Jam dakord me kritikak e parafolësve». Merita e secilit është që, duke mos u gënjer nga fjalët «e bukura» të tyre, t'i ballafaqojnë me direktivën konkrete të Partisë, me frymën e opinionit të shëndoshë shoqëror, pra t'i vënë para gurit të provës, ku të mbe-ten «zbuluar» dhe, ose të ndreqen, ose të demaskohen. Mund të ngrihet një banor i bllokut dhe të kritikojë i revoltuar fëmijën e X-it ose Y-it, që luan me top para dritares së tij «duke thyer rregullat». Por ai që ngrihet duhet të matet jo vetëm nga kjo kritikë me pasion por edhe nga kontributi konkret që jep ai në lagje kundër kësaj të keqeje në punë vullnetare, në luftë kundër zakoneve prapanike, etj. Po të shkosh në mbledhjet e lagjeve

të qytetit e fshatrave të vendit tonë do të vësh re me kënaqësi debatin e gjallë revolucionar për të mbrojtur vijën e Partisë e normat e moralit proletar gjatë diskutimit të mjaft problemeve shoqërore, për mënyrën e jetesës, sjelljen, modën, mbrojtjen e pronës së përbashkët, etj. etj. Dhe përgjithësisht ata që flasin e kritikojnë në mbledhje janë revolucionarë e luftëtarë kundër indiferentizmit e që vetë së pari janë në rregull. Ka dhe nga ata që flasin pak ose nuk flasin fare në këto mbledhje, por duke dhënë shembullin personal e të familjes në punë e luftë konkrete për zbatimin e vijës së Partisë, ata përsëri janë luftëtarë kundër indiferentizmit. Kurse disa nuk përtojnë kurrë të kritikojnë, por vetë e familjen e tyre nuk e kanë në rregull. T'i thuhet atij që kritikon p.sh., se pse nuk e dërgon në fermë vajzën e vet, që ka mbaruar gjimnazin, por fut miq për t'i gjetur një «punë me kalem». Dhe në qoftë se i ka këto shfaqje, pavarësisht se bën kritika «të zjarrta», është indiferent. Mundet që një drejtues kooperative t'i kritikojë në punë, por përderisa nuk organizon e tërheq përvojën e mirë të kooperativës e të brigadës që ka pranë, prapë është indiferent. Mundet një punëtor ta kritikojë përgjegjësin e vet, pse ndonjëherë bërtet, dhe bën mirë që e kritikon, por kur e sheh se norma e tij e punës është e ulët, e ai nuk kërkon ta ngrejë, prapë tregohet indiferent. Botohen në shtyp herë pas here iniciativat revolucionare të punonjësve tanë. Po ata që e lexojnë sa për të shuar kureshtjen dhe nuk marrin asgjë për ta zbatuar, duke menduar se «nuk përmendet ndërmarrja e tyre», përsëri tregohen indiferentë. Ka akoma punëtorë që duhet të rikthehen në fshat, siç kanë bërë

shumë shokë të tyre; veprat e mëdha të pesëvjeçarit, Fierza, Metalurgjiku, etj., kanë akoma nevojë për punëtorë e specialistë me përvojë. Mënyra e re e jetesës duhet të futet më thellë në jetën tonë, cilësia e punës duhet të jetë më e lartë kudo. Kudo zakonet e normat e reja duhet të sundojnë më fort në jetën tonë.

Ja, në të tilla fronte konkrete të socializmit dallohen revolucionarët nga indiferentët.

MË PARË DUHEN SHKULUR KONCEPTET

Rinia jonë është rini e idealeve të mëdha. Partia e ka mbajtur atë gjithmonë pranë, si ndihmëse besnike dhe rezervë të sajën luftarake. E ka edukuar me të gjitha virtytet e moralit proletar; me bindje të shëndosha politike e ideologjike, me ndershmërinë komuniste, me shpirt sakrifice e vetëmohimi. Të gjithë jemi dëshmitarë të forcës e të bukurisë së saj shpirtërore, që e ka treguar dhe e tregon në aksionet e ndryshme në çdo skaj të atdheut. Jemi dëshmitarë të pjekurisë së saj politike, që e ka treguar dhe e tregon, me vigjilencën e saj të lartë, me mendjen e saj krijuese dhe me forcën e saj. Çdo ditë e shohim rininë tonë entuziazte që zbukuron uzinat, fabrikat, shkollat jo vetëm me duart e veta, por edhe me sjelljet e veta, me paraqitjen e vet të thjeshtë e të hijshme.

Pikërisht kjo tablo e bukur dhe madhështore e rinisë sonë, ky potencial i saj i madh shpirtëror, na bën të gjithëve të vërejmë më lehtë e të shqetësohemi kur aty-këtu shohim ndonjë që s'është në udhë të mbarë. Dhe themi: «Ç'i shtyn këta të kenë botëkuptime të paqarta?». Gjejmë shkaqet dhe i kthejmë edhe ata në radhët tona të fuqishme. Ja, p.sh., në uzinën «Partizani» në Tiranë jeton e pu-

non një rini revolucionare. Duart e saj flori i kemi parë në qindra artikuj të bukur. Por vallë ç'i shtyti dy të rinj të kësaj uzine të këmbëngulin aq shumë në paraqitjen e tyre jo të hijshme, e aq më keq edhe t'i kërcënonin ata që i këshillonin? Pavarësisht nga puna e mirë që bëhet atje, këtyre pyetjeve nuk u kishin dhënë dot përgjigjen e plotë, përderisa kishin mbetur vetëm te problemi «Kush u qeth e kush nuk u qeth akoma». Nuk mund të thuhet se në këtë rast ka një punë të thelluar. Duhet qëndruar mirë te pyetja: «Ç'duhet të bëjmë më tej? Ndryshe të kërcënon rreziku i fushatizmit, për të cilin Partia na ka paralajmëruar gjithmonë me forcë. Që të dimë si duhet të veprojmë më tej, duhet më parë t'ia bëjmë të qartë vetes pyetjen: «Përse na ndodhin këto fenomene?» Na ndodhin për një radhë shkaqesh objektive e subjektive.

Dihet se presioni ideologjik i armiqve të jashtëm e të brendshëm është i madh e i vazhdueshëm. Dhe përderisa presioni ideologjik i armiqve është i vazhdueshëm, përse disa këtë luftë nuk e zhvillojnë vazhdimisht?

Armiku përpiqet që edhe nëpërmjet modës, flokëve, veshjes dhe sjelljeve të pahijshme t'u degjenerojë njerëzve tanë, në fund të fundit, ndërgjegjen. Por ka dhe një shkak tjetër që na ndodhin këto fenomene: janë dobësitë e punës sonë në disa raste. Është gabim të kënaqesh me qethjen e flokëve, pa shkukur nga rrënjët konceptet që i ushqejnë këta flokë. Dhe këto koncepte shkulen me një punë të gjerë ideopolitike duke krijuar bindje të shëndosha te të rinjtë.

Ka disa të rinj mendjelehtë që thonë: «Ç'u duhet të tjerëve si i mbaj unë flokët ose fustanin?»

Këto janë çështje thjesht personale». Të gjithë, por sidomos vetë të rinjtë, e kanë për detyrë t'u shpjegojnë shokëve e shoqeve të tyre se shijet kushtëzohen nga interesat shoqërore dhe kanë karakter shoqëror. Këta të rinj nuk rrojnë në hava, por janë njerëzit tanë dhe jetojnë midis njerëzve tanë të partishëm, të ndershëm e të palodhur, prandaj nuk do t'i lëmë këto mollë të kalben që të na prishin edhe të tjerat, që janë të pastra e të kuqe. Ne u themi këtyre të rinjve se këto shije nuk janë tuajat. Ju jeni njerëzit tanë, socializmi është yni, i baballarëve, vëllezërve, motrave tuaj e tonave. Dhe këto koncepte të huaja u bëjnë të stononi në shoqërinë tonë, që frymëzohet nga botëkuptimi marksist-leninist. Shijet, sjelljet, mënyra e jetesës borgjeze e revizioniste nxisin degjenerimin, parazitizmin, karrierizmin e një mijë të këqija të rendit borgjez dhe, duke qenë pranë nesh njerëz me shfaqje të tilla, na pengojnë në idealin tonë, që na frymëzon për punë të palodhur në ndërtimin e socializmit, krijimin e njeriut tonë të ri, me ndërgjegje socialiste proletare. E përderisa këto koncepte pengojnë zhvillimin tonë, ne do të luftojmë kundër këtyre rrënjëve të këqija, duan a s'duan bartësit e tyre.

Lufta kundër këtyre koncepteve bëhet duke forcuar më tej frontin unik të edukimit, ku përfshihen të gjitha organizatat e masave, shkolla e familja, kolektivi punonjës, mbarë shoqëria, me organizatën bazë të Partisë në krye, pa nënvleftësuar, në të njëjtën kohë, punën individuale.

Të gjithë e kanë për detyrë të qëndrojnë afër të rinjve e jo të mjaftohen me punën e një «të ngarkuari me rininë». Dhe, që këto marrëdhënie të jenë sa më të forta e të qëndrueshme, nuk duhet të sille-

mi ndaj këtyre të rinjve nga «pozita zyrtare», por të krijojmë lidhje shoqërore, intime, që i riu të ndiejë thellë ngrohtësinë e sjelljes sonë, të fjalës e të preokupimit tonë. Ta shohim të riun si birin e si shokun tonë më të ri të luftës e të idealit, si një nga ata që do ta çojnë më tej veprën e nisur e të realizuar me kaq punë, mund e sakrifica. Çdo leksion e bisedë duhet bërë e gjallë, interesante e konkrete, duke e ngjeshur me materiale faktike të ndërmarrjes ose të institucionit përkatës. Në një uzinë, shkollë, kooperativë bujqësore, për shembull, ka mjaft të rinj shembullorë në punë, në veshje e në sjellje. Janë pikërisht këta djem e vajza që i japin aty tonin jetës dhe e kanë vënë ndërmarrjen, shkollën a kooperativën e tyre në radhën e më të përparuarve. Pra leksioni më i bukur e më bindës do të jetë ai që do të marrë si «lëndë të parë» pikërisht jetën dhe eksperiencën e punës e të sjelljes së këtyre punëtorëve. nxënësve a kooperativistëve.

GRUAJA NË KONTROLLET PUNËTORE E SHTETËRORE

Të gjithë themi se materialet e Partisë «na bëhen udhëheqje për veprim», «na hapin horizonte të reja», «na çelin dritare të reja» për të parë e për të zhvilluar më tej jetën tonë shoqërore. Dhe kjo është një e vërtetë e pamohueshme, që e ndesh kudo në jetën tonë. Do të përipiqemi të tregojmë për njëërën nga këto «dritare të reja» që e ndeshëm në një bisedë që bëmë para ca kohe me disa kuadro e njerëz të thjeshtë në një rreth të Veriut, pasi ata kishin studiuar letërkëmbimin e shokut Enver me kooperativistet e Këmishtajt. Në letër, midis të tjerash, shoku Enver shkruan: «Shembulli i kooperativës së Këmishtajt, sukseset e saj të mëdha të gëzojnë e të frymëzojnë shumë edhe për faktin se atje në drejtim të punëve ka shumë gra... Kjo dëshmon edhe një herë se porosia e Partisë, për ta ngritur sa më lart rolin e grave në ndërtimin socialist, për t'u besuar atyre pa druajtje dhe në çdo fushë vende me përgjegjësi, ka qenë plotësisht e drejtë»¹⁾.

Ky konkluzion i shokut Enver e solli bisedën te roli i madh i grave në kontrollet punëtoare. Një

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1974-1975», fq. 366.

instruktor i Komitetit të Partisë të një rrethi na tregonte me entuziazëm për këmbënguljen, seriozitetin, pjekurinë politike, por sidomos për thellësinë e njohjes së problemeve në ato kontrole punëtore që ishin kryer nga gratë. Disa shoqe bënë një kontroll në NB për prodhimin e perimeve dhe respektimin e kontratave për furnizimin e tregut. U bë një debat i fortë midis këtyre shoqeve dhe drejtuesve e specialistëve të NB-së. Këta shokë fillimisht nuk i pritën mirë kontrollin dhe vërejtjet e shoqeve, duke menduar se ato nuk merrnin vesh nga perimet. «Si global ju ndoshta e realizoni planin, — u thanë ato, — por ne jemi vetë amvisa dhe ua dimë mirë kimetin në familje cilitdo lloj nga perimet, prandaj duhet t'i prodhoni të tëra e jo vetëm ato që ju ngrenë peshë për planin». «Ju e bëni vjeljen duke respektuar në mënyrë strikte grafikun, pa vënë re se janë pjekur ose jo prodhimet, vetëm që të realizoni planin si global. Ky është plan burokratik...». Para një logjike të tillë shokët drejtues të ndërmarrjes nuk kishin si të lëviznin.

Po me kaq entuziazëm na folën edhe për gratë që morën pjesë në kontrollin punëtor në ndërmarrjen e Grumbullimit, ku ato bënë vërejtje për cilësitë e bukës ose në ndërmarrjen e ushqimit social, ku treguan se ia dinin të gjitha «yçklat» tregtisë. Dhe vërejtjet e këtyre shoqeve në të dy rastet u quajtën të drejta dhe u vunë në vend.

Kur bisedonim në një kooperativë bujqësore me anëtarët e një brigade, ata na thanë se e kishin bërë zakon që kontrollin e realizimit të normës e të cilësisë së punës ta bënin jo me një njeri të caktuar, por me një grup prej disa vetash nga të brigadës. Mirëpo, siç thanë ata, një gjë u kishte rënë në sy.

Kur kontrollin e bënin gratë, asnjëherë nuk u kishte ndodhur të bënte njeri «gëk», nuk kundërshtonte, për arsye se këto gra, që kontrollonin, vetë e tejkalonin normën, dhe cilësinë e punës e kishin më të mirë se gjithë të tjerët.

— Ne na shkojnë shumë mirë brigadat që drejtojnë gratë, — na tregonin një ditë disa kuadro të një kooperative tjetër. — Dhe kështu nuk mendojmë vetëm ne, por shumica, sepse ato i rrinë gjithë ditën punës mbi kokë e nuk dinë ta ndërpresin për gjëra të vogla, siç mund të ndodhë me ndonjë burrë...

Natyrisht, me të gjitha këto nuk duam të themi se burrat nuk janë të kujdesshëm në detyrat e tyre. Por është fakt që jo rrallë në kontrollet punëto-revizione dhe në disa seksione të kontroll-revizionit e financave, në komitetin ekzekutiv të k.p. të rrethëve preferohen më shumë burrat se gratë. Pse në seksionin e financë-kontroll-revizionit të komitetit ekzekutiv të një rrethi në 6 veta të mos ketë asnjë shoqe dhe në atë të organizimit përsëri asnjë? Në një rreth tjetër po kështu: Seksioni i financë-kontroll-revizionit në 6 veta ka vetëm një grua, në atë të organizimit po kështu. Pjesëmarrja e grave në kontrollet punëto-revizione të kohëve të fundit në rrethin e Veriut për të cilin flasim ishte e mirë, por në 11 veta të seksionit të financë-kontroll-revizionit ka vetëm 3 gra dhe në atë të organizimit raporti është 3 : 1. Përse të ndodhë kështu?

Siç do të ishte e palogjikshme të vihet në dyshim ndërgjegjja e burrave për t'u besuar në kontrollet e ndryshme, po ashtu edhe ndërgjegjja e grave jo vetëm që nuk duhet vënë në dyshim po edhe duhet vlerësuar. Shoku Enver ka thënë se gratë dhe të rejat, përkrah burrave dhe të rinjve, janë një

forcë kolosale e progresive, revolucionare, se gruaja është kudo, se ajo dallohet në punë, në mendime krijuese e me frymë revolucionare, në shkollë, në drejtim, se ajo dallohet për vendosmëri, për patriotizëm e zgjuarsi, se që të flasin gratë, që të dëgjohet fjala e tyre, që të marrin ato vendet e përshtatshme në punë me kapacitetin e zotësinë e tyre, nuk është detyrë vetëm e Bashkimit të Grave, është ligj i Partisë, dhe se Partia punon e duhet të punojë gjithnjë e më shumë në këtë drejtim». Këto mësimet e porosi duhen zbatuar duke i kuptuar thellë arsyet ideologjike, politike dhe ekonomike që e bëjnë Partinë të ngulë këmbë fort në këtë problem të madh. Çdo njeri, sidomos çdo komunist, kuadër a drejtues, duhet ta konsiderojë detyrë thellimin në filozofinë marksiste-leniniste dhe në dokumentet e Partisë, si për çdo problem, edhe për problemin e madh të gruas, për t'i dhënë asaj vendin e merituar në shoqëri. Partia na mëson se duhet ta kuptojmë një herë e mirë dhe thellë se emancipimin e gruas, përkrahjen dhe ndihmën që duhet t'i japim asaj për të zënë vendin e merituar në shoqërinë socialiste nuk duhet ta konsiderojmë si «dhuratë» ose si një farë koncesioni, hapje rruge që u bëhet femrave nga burrat, që gjoja janë eprorë nga intelekti, më të zot, më të besuar dhe të predispozuar vetëm ata të komandojnë, të udhëheqin e të kontrollojnë, por si një çështje jetike.

Ja ç'thotë Lenini lidhur me problemin që përmendëm më sipër: «...gjithë masa punonjëse, si burrat ashtu dhe *sidomos gratë*, të marrin pjesë në Inspektimin Punëtor-Fshatar... T'i kushtohet vëmendje e posaçme (dhe të caktohen rregulla sa më të përpikta) që kontrolli i Inspektimit Punëtor-Fsha-

tar mbi llogaritjen e produkteve, të mallrave, depove, veglave, materialeve, lëndëve djegëse etj. etj. (të mensave etj. sidomos), të jetë *sa më i gjerë*. Në këtë punë të tërheqin *medoemos gratè* dhe bile pa përjashtim»¹⁾.

Lenini e thekson me qëllim domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së grave në Inspektimin Punëtor-Fshatar dhe arsyet për këtë janë të shumta. Gruaja ka qenë e para skllave, ajo është skllavëruar përpara skllavit që përmendet në historinë e njerëzimit. Edhe gruaja shqiptare ka qenë dyfish e skllavëruar, nga shfrytëzimi kapitalist dhe nga kanuni, nga burri. Prandaj edhe ajo e ndien, i do, dhe sidomos lufton me shpirt për t'i ruajtur, forcuar e konsoliduar fitoret që i dha në dorë Partia. Kjo e bën gruan këmbëngulëse, kërkuese dhe të ndërgjegjshme për t'i zbatuar deri në një detyrat e Partisë. Mjaft njerëz të thjeshtë me të cilët biseduam rreth këtij problemi, sillnin secili argumente shumë interesante mbi domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së grave në këto kontrole. Dhe në të gjitha fjalët e tyre ndihej i njëjti vlerësim dhe respekt për gruan.

Bisedat me ta ose shifrat, si ato që përmendëm më sipër, duhet të na tërheqin vëmendjen të gjithëve, prandaj le të qëndrojmë e të thellohemi seriozisht në esencën e tyre politike, ideologjike e filozofike, duke bërë përgjithësime e duke nxjerrë detyra.

1) V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, fq. 339-340.

KUNDËR KONCEPTIT: «TË JETË PËR MUA, MOS E BËNI KURRË...»

Njerëzit tanë lënë kokën për Partinë, me fjalën e Partisë hidhen në zjarr. Ky është një realitet i madh, i mrekullueshëm. Dhe ata veprojnë kështu, sepse e kanë parë dhe e shohin veprën e Partisë, e kanë ndier, e kanë provuar këtë realitet madhështor çdo ditë e çdo vit. Shkurt, janë bindur nga fjala dhe vepra e Partisë. Këto bindje janë bërë të qëndrueshme, të patundura. Dje, kur e udhëhoqi në luftë për lirinë e vendit, ose më vonë për rindërtimin e tij, për kolektivizimin e bujqësisë etj., me shembullin e bijve të saj, me fjalën e tyre të zjarrtë e bindëse, Partia i tregoi popullit se kjo rrugë do ta çonte atë drejt një jete të lirë e të ndershme, të begatshme. Prandaj edhe populli e ndoqi pas Partinë. Edhe sot populli «me fjalën e Partisë hidhet në zjarr», direktivat e saj dhe ligjet e shtetit i vë në jetë me entuziazëm, jo vetëm sepse vetë ai e ka provuar Partinë, e ka çelikosur besimin ndaj saj, por edhe sepse komunistët, që janë vetë bijat dhe bijtë më të mirë të popullit, për çdo gjë japin shembullin e vet dhe, kur shkojnë në popull, siç i mëson Partia, ia shpjegojnë këto direktiva e ligje një herë, dy herë, pesë herë, bëjnë zbërthimin e tyre politik,

ideologjik e organizativ. Dhe të gjitha këto ata i bëjnë me bindje, jo me fjalë burokratike e urdhëruese, por të ngrohta, mobilizuese, me pasion e entuziazëm. Le të marrim një shembull të thjeshtë.

Organizata e Partisë dhe nën shembullin e saj edhe kryesia e një kooperative në Gjirokastër, kur marrin në dorë planin e hapjes së tokave të reja, nuk zënë të rrudhin buzët e të thonë: «Bobo, ç'është ky plan kaq i madh!». Jo. Kështu veprojnë të pafomuarit. Sepse kur vetë si drejtues a si komunist nuk ke bindje të plotë për këtë, ndodh pastaj si me disa që shkojnë, mbledhin brigadën e i thonë: «Dëgjoni, shokë! Na dërguan planin e hapjes së tokave të reja. Është ca i madh, por s'është faji ynë. S'kemi ç'i bëjmë, është urdhër nga lart. Por ju e dini... Të jetë për mua, mos i hapni kurrë...». Ç'janë këta njerëz? Ata janë burokratë tipikë, e si të tillë, siç thotë shoku Enver në fjalimin e 6 shkurtit, përpiqen t'i bëjnë jovepruese ligjet dhe urdhëresat revolucionare, për t'i mërzhitur masat, për t'i bërë ato të pakënaqura dhe, më në fund, indiferente.

Por në këtë kooperativë plani për hapjen e tokave të reja realizohet gjithmonë. Atje komunistët dhe drejtuesit ua shpjegojnë kooperativistëve direktivën e Partisë në mënyrë revolucionare. Dhe të parët hidhen vetë në punë. Pas tyre edhe të gjithë të tjerët. Veç kur ti nuk krijon bindjen vetë së pari e pastaj nuk ia zbërthen mirë këtë direktivë të Partisë kooperativistit; kur ti, për shkak të mosorganizimit të mirë të punës e të neglijencës, megjithëse i hap, nuk i mbjell tokat e reja, do të thotë se ti së pari e kupton direktivën në mënyrë burokratike dhe pastaj i jep të drejtën tjetrit të thotë: «Unë punoj kot». Kështu njerëzit nuk binden dhe re-

zultatet janë negative. Ndryshe s'ka si shpjegohet fakti që disa kooperativa bujqësore nuk kanë shkuar mirë me hapjen e tokave të reja. Shoku Enver ka thënë se ata njerëz që e kuptojnë në mënyrë burokratike direktivën ose ligjin, s'ka si ta zbatojnë atë në mënyrë revolucionare. Direktiva ose ligji për ta është urdhër nga lart, që duhet zbatuar verbërisht. Pra ata nuk marrin mundimin të thellohen ku e ka origjinën ligji ose direktiva, ç'situata kanë qenë ato që e kanë detyruar udhëheqjen t'i bëjë këto. Një shikim i tillë i cekët e burokratik i këtij problemi i bën ata që edhe t'i zbatojnë në mënyrë burokratike.

Që ta bindësh tjetrin për ta zbatuar me entuziazëm e me krahë të lehta një direktivë a një ligj, duhet më parë vetë ta kesh studiuar e kuptuar atë plotësisht e të bësh përpjekje për t'ua bërë edhe të tjerëve të qartë. Kjo pastaj të bën të japësh she-mbullin tënd në radhë të parë, ta bën edhe fjalën bindëse, të argumentuar, të ngrohtë, të mbush me pasion e vendosmëri. Kjo bën që edhe masa të mobilizohet në punë e ta çojë deri në fund zbatimin e direktivës ose çdo detyrë tjetër. Kështu i ka edukuar të veprojnë gjithmonë bijtë e vet Partia. Që kur lindi, edhe gjatë luftës, kështu i edukoi. Në Kuç të Kurveleshit na tregonin për Heroin e Popullit Memo Meto, gjuhëbilbilin. «Kur hipte Memoja mbi gurë, — thoshnin, — e i fliste fshatit për Partinë e për luftën, shkrinte edhe guri nga fjala e tij e zjarrtë. Dhe kur ai mbaronte, ngriheshin njëherësh 15-20 djem dhe i vinin pas në mal». Po pse, si fliste Memoja? Mos vallë u thoshte fshatarëve: «Luftoni, o shokë, sepse kështu është urdhri, po të jetë për mua

mos dilni në mal kurrë»? Jo. Ndryshe s'do ta ndiqnin pas, dhe «guri s'do të tretej», e fshatarët do t'i kthenin krahët. Por ai u tregonte fshatarëve ç'ishin Partia e partizanët dhe pse luftonin ata me aq heroizëm.

Edhe sot, kudo që veprohet kështu, rezultatet janë të mëdha. Në një kooperativë bujqësore të rrethit të Tepelenës, p.sh., ka një çetë vullnetare. Ajo të entuziazmon kur e sheh në stërvitje. Natyrisht janë bindjet dhe kuptimi i drejtë nga të gjithë vullnetarët e fshatit se mbrojtja është detyrë mbi detyrat. Veç atje komunisti, i cili drejton çetën, përpara se të fillojë një stërvitje të vështirë, përpiqet t'i bindë njerëzit me fjalën e mirë se duhet të lodhen e të djersinë ose ta kryejnë stërvitjen me përpikmëri jo duke u thënë «Na zuri, o shokë tani, s'kemi ç'i bëjmë, është urdhër nga lart, se po të jetë për mua...» Jo! Ai u shpjegon mirë se duhet të lodhemi tani, sepse jemi të rrethuar nga armiq të egër, që s'na duan të mirën, të lodhemi tani, që nesër, në rast lufte, armikut t'i thyejmë brinjët e të mos e lëmë të hedhë dot as majat e gishtave të këmbës në tokën tonë të shtrenjtë, ku ndërtohet socializmi. Mirëpo ka edhe ndonjë rast që nuk veprohet kështu. Ndonjë nga ata që drejton çetën, duke mos dashur të prishë «muhabetin» e miqësinë me shoqet e shokët e çetave vullnetare etj., duke dashur të tregohet «njerëzor» e me «kulturë», kur rifillon stërvitja, u drejtohet me këto fjalë: «Çohuni, po deshët, mor vëllezër. E shoh që jeni lodhur, por ç't'i bëjmë, është urdhër. Po të jetë për mua, rrini shtrirë gjithë ditën.»... Jo, ky nuk është njerëzillëk, por e kundërta, kjo nuk është kulturë por mungesë kulture e, në radhë të parë, mun-

gesë kulture politike. Kërkesa e llogarisë dhe disiplinë janë krejt të kundërta me arrogancën e prepotencën. Fjalët e këtyre njerëzve tregojnë moskuptimin politik të detyrës, tregojnë se në ndërgjegjen e tyre kanë zënë vend botëkuptimet e huaja për moralin tonë proletar, flasin për qëndrime burokratike dhe oportuniste. Ndodh kështu edhe me ndonjë drejtues kooperative ose sekretar organizate partie që, kur duhet të shtrojë në organizatë problemin e ngritjes së gruas në përgjegjësi, «E dimë, — thotë, — që ato s'janë të zonjat të marrin në dorë një brigadë të tërë, por ç'të bëjmë?... Ka orientim nga lart. Po të jetë për mua...».

Si t'u përgjigjesh këtyre njerëzve me koncepte kaq të gabuara dhe me gjykime kaq të papjekura, burokratike e oportuniste? Ç'duhet të bëjmë sikur «të jetë për ju» shokë? Të mos e bëjmë?! Pra, të mos stërvitemi e armiku të na zërë në befasi, të mos hapim toka të reja e t'i shtrijmë dorë armikut për bukë? Të mos ngremë normat e ekonomia të ecë prapas? Të mos ngremë gratë në përgjegjësi e të mos emancipohen, që të rikthehemi te kanuni i Lekë Dukagjinit? etj. etj. Natyrisht, po t'u përgjigjesh kështu këtyre shokëve, ata «kërcejnë» përpjete e të thonë: «Jo, se na fute thellë...». Por në fund të fundit njerëz të tillë, që hiqen sikur të qajnë hallin, fshehin në ndërgjegjen e tyre koncepte të dëmshme, bile të rrezikshme, antisocialiste, sepse në esencë dashje pa dashje synojnë që masat t'ua kundërvënë Partisë, cenojnë unitetin e popullit me Partinë, që është çelësi i fitoreve tona dhe objektiv kryesor i punës së armikut të klasës. Por për masën revolucionare këta njerëz bëhen njëkohë-

sisht edhe qesharakë. Sepse masa u thotë atyre:
«Nuk kemi nevojë për mbrojtjen dhe «shpirtgjerë-
sinë» tuaj. Na mbrojnë parimet e Partisë dhe ligjet
e shtetit, të cilat mishërojnë interesat tona, i kemi
vendosur vetë dhe i mbrojmë vetë».

NJERËZ PA EMRA...

Mund t'ju tingëllojë ndoshta ca paradoksal ky titull, por s'është pa kuptim. E vërteta është se emri i njeriut regjistrohet në zyrën e gjendjes civile që kur lind. (Bile shpesh na pëlqen dhe ia zgjedhim emrin fëmijës që para se të lindë). E megjithatë ka edhe njerëz pa emër. Ja, dëgjoni zërin e njërit prej tyre:

«...M.N. është për ne brigadieri më i ulët që kemi parë gjer më sot, arrogant, fyysi më i madh, me fjalët më të ulëta karshi burrave e grave. G.N. njihet si dallaveraxhi, dembel, intrigant dhe i qelepirit, që sillet poshtë e përpjetë rrugëve, ha ku dar-ka e ku dreka... Për të gjitha këto që ju shkruajmë më lart, kërkojmë ndërhyrjen tuaj. Veç kësaj, ja edhe propozimet e poshtëshënuara të masave:

1) M.N. gënjeshtar, kapadai, vjedhës i kooperativës, servili më i keq në këtë krahinë, të hiqet nga brigada e të dërgohet në prodhim.

2) G.N., servil, dembel, imoral, intrigant, qelep-xhi dhe që kërkon vende të ngrohta, njeri që ka vrrarë peshk me dinamit, ka falsifikuar dokumente, të dërgohet në prodhimin më të rëndë dhe nga Partia të mbahet qëndrim...

Nënshkrimi: Nga brigada X.

E dëgjuat? Është zëri i një autori të një letre anonime dërguar Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit. Po ngutemi t'ju tregojmë se kooperativistët M.N. dhe G.N., që akuzohen aq rëndë, jo vetëm që s'kanë asnjë nga këto «tribute», që u vesh letërshkruesi i panjohur, por janë nga kuadrot më punëtorë e më të ndershëm të një kooperative të zmadhuar. Këto i thanë vetë kooperativistët e brigadës ditën që u organizua mbledhja për të diskutuar letrën e anonimit për brigadierin dhe të tjerët, që akuzoheshin kot. Atëherë, ç'e shtyn këtë të panjohur të shpifë kaq rëndë kundër njerëzve të ndershëm? Me sa duket, brigadieri ose tjetri nuk i kanë shkuar pas avazit, nuk i kanë bërë lëshime. Ndodh ta kenë kritikuar këtë dembel rëndë në ndonjë mbledhje. Dhe atëherë hakmarrja tinzare. «Po hedh një gur, — ka thënë ai. — Po doli, mirë; po s'doli, kush e merr vesh?... Letrës nuk ia vë emrin në fund». Shihni sa krahë merr fantazia e një njeriu që vepron prapa krahëve! Propozon edhe masa konkrete kundër tyre. Flet edhe në emër të masës.

Kur fillon të lexosh këto letra, të mbërthen një shqetësim i vërtetë. Për një çast u beson atyre që shkruhen dhe trishtohesh. Pastaj lexon edhe shënimin e shqetësuar të sekretarit të Komitetit të Partisë në fund të letrës, drejtuar ndonjë punonjësi të aparatit: «Shoku...! Të lutem verifikojeni urgjent çështjen në vend dhe më njoftoni menjëherë».

Pas kësaj shqetësimi të rëndon akoma më tepër. Por... përfundimi asgjë. «Asgjë për t'u shqetësuar, shoku sekretar. Vajtëm në popull dhe populli foli fjalët më të mira për kryetarin». Asgjë. Vërtet asgjë. Por sa gjëra humbasin për të dalë tek kjo asgjëja?! Një letër, që me lehtësinë më të madhe e

hedh në kutinë e postës një intrigant, ua prishi gjakun nja tridhjetë njerëzve të ndershëm, krijoi dyshime të kota. Lëre pastaj kohën e humbur! Siç na tregonin disa shokë në Komitetin e Partisë të Rrethit të Elbasanit e të Gramshit, humbin ditë të tëra duke shkuar kot nëpër kooperativa, humbin orë të tëra kot duke diskutuar nëpër mbledhje. Një njeri i panjohur, me mendjehetësi e keqdashje, hodhi gurin e fshehu dorën (sa neveri ka populli ynë për njerëzit që hedhin gurin e fshehin dorën!) dhe alarmoi një fshat të tërë. Në vend që të prashitin misrin, të mbjellin grurin e të çlodhen në shtëpi, njerëzit detyrohen të bëjnë edhe një herë karakteristikat e brigadierit ose të kryetarit e të shokut të tyre të mirë.

Letrat e popullit kanë qenë, janë e do të jenë kurdoherë një burim i madh, i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm informacioni për Partinë. Kur lexon ato, të duket sikur Partia ka vënë veshin në zemrën e popullit dhe dëgjon të rrahurat e saj. Dhe në shumicën e rasteve ato ngrenë probleme mjaft të rëndësishme e të interesit të përgjithshëm. Por këtu e kemi fjalën vetëm për ata që shpifin. Shpifjet nuk janë letra populli, nuk janë informacion, por dizinformacion. Shpifjet (sidomos me forma anonime) janë «dinamit» intrigantësh, këtë radhë jo për gjueti peshku... Ato ngrenë kokën kundër unitetit të Partisë me popullin.

Në Komitetin e Partisë të një rrethi para ca kohësh erdhi një letër e panënshkruar. Autori i saj kishte zbratur gjithë «bateritë» kundër kryetarit të një kooperative. Të vjen turp të citosh nga letra e tij, por qëllimi merret vesh. Shkoi i deleguari i Komitetit të Partisë dhe mblodhi gjithë popullin. Ia

tregoi «historinë». Populli u revoltua. Kryetarin e donin shumë dhe zunë të thonë për të fjalët më të mira. Bile një plak 80-vjeçar, nga merakuri për kryetarin, iu afrua të deleguarit:

— More, po kush është ai i poshtër që na shan kryetarin? More po kush është ai qerrata që kërkon të na futë sherrin në shtëpi?...

U shqetësua plaku. U revoltua. Dhe jo vetëm ai, por të gjithë. Por kundër kujt? Ai që vuri urën e zjarrit që i padukshëm. T'i thërrisje? Ai s'kishte emër. Ai që njeri pa emër. Se më përpara që njeri pa karakter.

Sa keq që një njeri mohon emrin e vet! Mohon veten. E shndërron veten në një X!

Po sikur të gjithë ata t'i vinin vetes si detyrë ta gjenin këtë njeri? Do ta gjenin. Po të donin, po. Popullit, organeve të diktaturës së proletariatit nuk u shpëton asgjë. Ç'do të bënte njeriu pa emër midis këtyre njerëzve të revoltuar? Ç'do të thoshte? Si do të justifikohet? Po nuk e bënë këtë. Sepse as Partia nuk këshillon kështu. Kudo, punonjësit e aparateve ose kuadrot e kooperativave nuk i kanë vënë ndonjëherë këtë detyrë vetes. Ata gjithmonë janë nisur vetëm nga rëndësia e problemit. Dhe nuk e kanë kërkuar autorin, jo se kjo është një punë pa krye, por sepse nuk është në karakterin as të Partisë, as të popullit tonë. Pse atëherë duhet spekuluar mbi karakterin thellësisht demokratik të pushtetit tonë?

Dikush mund të thotë se qëllon që ndonjë kryetar ose brigadier është hakmarrës dhe ngrihu kundër tij hapur, pa ta shohësh. Ka raste që kjo është e vërtetë. Të mohosh këtë do të thotë të mos jesh realist. Së pari, cilidoqoftë reagimi, ai që nuk gu-

xon të kritikojë është mikroborgjez. Pastaj njerëzit që përmendëm nuk ia dërgonin letrat kryetarit, por ua dërgonin përfaqësuesve të Partisë në rreth. Atëherë nga kush kanë frikë ata? Ata kanë frikë nga vetja. Ata tremben nga hija e tyre mikroborgjeze. Sepse goja e tyre pjell shpifje. Një pjellë krejt subjektiviste, që është shumë larg kritikës dashamirëse dhe konstruktive. Qëllimi i tyre është t'u prishin harmoninë njerëzve, t'u hapin punë të pagena. Lëngu i këtyre letrave është thjesht denigrues, prandaj edhe reaksionar. Dhe a e dini se këta njerëz, që duken kaq trima në letrat pa emër, janë pikërisht më frikacakët? Në një fshat në Shqipërinë e Mesme punon një arsimtar. Një komunist shumë i ndershëm, mësues shumë i mirë dhe për të cilin lë kokën, kur i thonë, gjithë fshati. Mirëpo, ngaqë akoma nuk ka strehim, është i detyruar të jetojë në një nga dhomat e kooperativës. Por një intrigant, të cilit me sa duket mësuesi nuk i shkon pas qerres, i shkruan Komitetit të Partisë të Rrethit:

«Shoku X mendon t'i krijojë rehati personale familjes së tij në kurriz të pasurisë së përbashkët, pasurisë së kooperativës... Besoj se nuk i ka hije një komunisti të bëjë gjëra të tilla. Aq më keq një mësuesi me universitet, siç është shoku X., që edukon brezin e ri. Sa mirë u flet ai nxënësve të tij rreth bejlerëve e pasanikëve! Me sa dimë ne, ai vepron kështu, sepse përkrahet nga ndonjë shok që ndodhet në sekretariat pranë Komitetit të Partisë. Shoku i sekretariatit në qoftë se e ka mik, ta marrë e ta strehojë në shtëpinë e tij.

...Emrin tim nuk po jua shkruaj. Mund të thoni ju se qenke burracak. Nuk është kështu. Fakti qëndron se gabimbërësi nuk e kupton drejt kritikën,

gabimin e bërë, por mund të më mbajë mëri, etj...».

Ata janë dhe gënjeshtarë:

«...Unë do të ngre zërin edhe gjer lart, në qoftë se nuk gjen zgjidhje kjo... do t'i bëj një artikull «Zërit të popullit» me titull «Komunistët e fshatit..... pasurinë e përbashkët e bëjnë pasuri të vetën...». U prit por ai nuk e dërgoi. Pse s'e mbajti premtimin? Sidoqoftë dëshira iu realizua. Pikërisht kjo është letra e tij. E gjitha është. Mungon vetëm nënshkrimi i tij. Duket gjë pa rëndësi? Nuk është aq pa rëndësi sa duket, sepse raste të tilla krijojnë vështirësi për të të dërguar honorarin...

KUR JE VETË NË RREGULL

Ndodh në ndonjë mbledhje që, megjithëse është plotësisht e qartë se ndonjëri ka gabuar, disa nuk ngrihen ta kritikojnë. Shpesh edhe revoltohemi: «More, po ç'është ky indiferentizëm! Pse heshtni? Ku është kritika paralele? Apo doni të mbronni shokun?!...» Është e vërtetë, edhe dëshira për «të mbrojtur» shokun e mbjell heshtjen. Por është edhe një arsye tjetër më e fortë: dëshira për të mbrojtur veten. Po të mos jesh vetë në rregull më parë, jo vetëm që nuk e ke të drejtën morale t'i kërkoksh llogari tjetrit, por ke edhe frikë, sepse ai të ngrihet e t'i numëron të tuat një e nga një. Dhe ti, si mikroborgjez, mendon: «Më mirë i vë kyçin gojës, sesa të më hapen havaze...». Ndryshe ndodh me atë që është i «larë» vetë. Ai s'ta përton. Pastërtia e figurës së vet morale e politike i jep atij edhe guximin, edhe principialitetin.

U habitën ca në Lushnjë me sekretarin e byrosë së Partisë të një kooperative bujqësore. «I fortë doli! — thanë. — Si, ore, sa vajti ai dhe e mori mbarësia kooperativën!...»

Natyrisht është e pamundur që një njeri i vetëm, qoftë ky edhe sekretari i Partisë, të vendosë fatet e një kooperative. Por njerëzit u entuziazmu-

an, sepse sekretari «e kapi demin nga brirët». Ai vuri re se punët në këtë kooperativë shkonin keq për arsye se ishte dobësuar themeli i gjithë punëve, roli udhëheqës i organizatës-bazë, lidhjet e Partisë e të kuadrove me masat. Njerëzit kishin humbur besimin te disa prej tyre. Organizata e Partisë ishte dobësuar, sepse shumë komunistë e kuadro kishin zënë për vete dhe për të afërmit e tyre qoshet më të ngrohta dhe s'prishnin dot rehatin e tyre. Ndonjë kuadër tjetër ishte bërë kapadai, fodull, dhe s'guxoje t'i thoshe gjysmë fjale. Pra organizata-bazë duhej vënë në rolin pararojë, që masa t'i besonte e pastaj t'i vinte pas. I pari vetë sekretari vendosi të jepte shembullin. Dhe ai nuk e filloi punën «nga vizitat» e gostirat nëpër shtëpitë e fshatarëve për «t'u shkrirë» me masën, siç bënte ndonjë tjetër. Ai «u shkri» me punën. Në mes të fshatarëve e gjeje kurdoherë që të veje, në mes të punës. Sepse që t'i kërkosh llogari tjetrit duhet të jesh më parë vetë në rregull. Bile jo vetëm kaq por sipas mësimeve të Partisë duhet të kemi në rregull jo vetëm veten, por edhe familjen, motrat, vëllezërit e shokët që kemi pranë. Dhe ai shqetësohej për të gjithë këta. Kjo është shumë e rëndësishme. Se ja, për shembull, disa komunistë në kooperativë i kishin rregulluar të afërmit e tyre nëpër qoshe me punë të lehta. Po si mund të kishin gojë këta komunistë t'u thoshnin kooperativistëve: «Shokë, të shkoni aty ku është puna më e vështirë». «Pa shiko veten!» — të thotë ai tjetri dhe ta mbyll gojën. «S'e merr dot me mend, sa merak ka edhe për një të vëllanë — na thanë për sekretarin — sa shkon në darkë në shtëpi: «Hë, i thotë, sa ditë-punë dhe sot?!». Dhe e ka në rre-

gull të vëllanë. Ka bërë mbi 400 ditë-punë gjer tani...».

Këtë merak ka sekretari edhe për shokët e tij komunistë. Në krye të çdo pesëmbëdhjetëditëshi ai llogarit ditë-punët e secilit. Tani komunistët në këtë organizatë janë pararojë. Jo vetëm që mbi 90 për qind e tyre punojnë drejtpërdrejt në prodhim, por mesatarja e ditëve të tyre të punës është më e madhe se e çdo kooperativisti. Këto e kanë forcuar mjaft organizatën-bazë të Partisë. Një vit më parë komunistët e kishin përjashtuar nga radhët e tyre njërin që nuk delte rregullisht në punë. Dhe kjo nuk e uli autoritetin e tyre. Përkundrazi, bile e ngriti më lart. Pas këtyre masave nuk u ngrit vetëm autoriteti i komunistëve e i kuadrove, por u rritën edhe prodhimet. Si rezultat i kësaj në këtë kooperativë u prodhuan 6 mijë kv. grurë më shumë, d.m.th. aq sa ishte gjithë prodhimi i drithit një vit më parë. Por më e rëndësishme është se u rrit më lart autoriteti dhe besimi, faktor i domosdoshëm për të siguruar lidhjen e fortë të organizatës së Partisë me masat e kooperativës. Shoku Enver thotë se besimi në masat e popullit duhet të vërtetohet e të forcohet në jetë, në praktikë, se kjo është një karakteristikë e madhe e Partisë sonë, që duhet të ruhet, të zhvillohet më tej, se duhet të bëhen përpjekje që besimi të fitohet deri edhe tek një individ i vetëm, sepse pika-pika bëhet lumi.

Partia themelet e kësaj dashurie e të këtij besimi të madh të popullit i ka hedhur që në krijimin e saj. Ishin komunistët, lulja e vendit, ata që u gjakosën të parët në barrikadat e para. Partia i flaku tutje teorizimet e ndryshme armike, si ajo e «ruajtjes

së kuadrove», dhe i edukoi bijtë e vet të vinin gjoksin aty ku ishte rreziku më i madh. Dhe populli i pa të gjitha këto gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Komisarët e komandantët, jo nga fundi, por nga kreu i çetës ose njësisë thërrisnin kur hidheshin në sulm me pushkë në dorë: «Para, partizanë!». Iu çelikos besimi popullit të Partia dhe prandaj u bashkua me të e ndau bukën e fëmijëve me partizanët. Edhe më pas, pikërisht sepse komunistët e kuadrot i vunë përsëri gjoksin të parët ndërtimit të socializmit, pa u shkoi populli pas, pa janë çelikosur më tej besimi dhe uniteti i popullit me Partinë. Ky rol pararojë i komunistëve, na porosit vazhdimisht Partia, është jetik. Në qoftë se komunistët dhe kuadrot nuk janë vetë në rregull, ata jo vetëm që nuk mund t'i kritikojnë dot të tjerët për të metat, por vihen në rolin e keq të atij që ndryshe bën vetë, ndryshe u thotë të tjerëve. Dhe njerëzit një herë, dy, pastaj nuk të vijnë më prapa, por të përqeshin. Si mund të ndikonte një shofer komunist për të qenë i ndershëm shoku i tij ose të luftonte me të metat e tij, kur vetë përvehtësonte pronën e përbashkët? Këto e ulin autoritetin e komunistit e të kuadrit dhe cenojnë besimin e njerëzve. Komunisti është edukator i masës dhe duhet të udhëheqë me shembullin e mirë.

Na bëri përshtypje një fakt që na tregoi një herë sekretari i organizatës së Partisë të një ndërmarrjeje: «Ishim si ndërmarrje në një aksion për korrjen e misrit. — Punuam sa punuam, kur shoh që disa po largoheshin. Midis tyre kishte edhe dy-tre komunistë. «More, po ku shkoni?! — u thashë atyre. — Pa mendoni njëherë, kemi gojë ne t'u themi të tjerëve kur largoheni ju të parët?!»

Ky dialog i vogël, kishte një domethënie të madhe. Kjo ishte me të vërtetë një ngjarje e rëndësishme për organizatën e tyre të Partisë. Të tilla ndodhi duhet t'i preokupojnë shumë organizatat-bazë, duhet të bëhen objekt për diskutime shumë serioze mbi rolin pararojë të komunistit. Çdo punë, sidomos komunistët e kuadrot, duhet ta fillojnë nga vetja, atë që i kërkon tjetrit duhet më parë t'ia kërkoshet vetes. Se pastaj fjala nuk të zë vend. Ndryshe ndodh kur vetë je në rregull. Pastërtia moralo-politike dhe të qenët në rregull me punën, të bëjnë që të jesh i qetë shpirtërisht, i singertë, por të bëjnë edhe që të jesh i pjekur, i guximshëm, trim. Je ballëhapur e ia përplas në fytyrë kujtdo qoftë, kur nuk ka të drejtë, ose kur nuk është në rregull me punën. Kështu lartëson veten, por me kritikën tënde të guximshme e konstruktive ndihmon edhe tjetrin të vihet në udhë të mbarë. Akoma më mirë kur je komunist a drejtues, sepse bën që pas shembullit tënd të mirë të ecin edhe të tjerët. Për shembull, përgjegjësi i një sektori është shpallur Hero i Punës Socialiste. S'dinë ç'të mirë të të thonë më parë për të kur pyet. I ndershëm, modest, punëtor sa s'ka ku të vejë. «Në zyrë e mban lopatën e kazmën, — na thanë për të. — Sa gjen pak kohë të lirë, shkon e punon. Kështu i ka mësuar edhe kuadrot e tjerë të sektorit». Dhe kjo ndodh sepse nuk kanë si të veprojnë ndryshe kuadrot e sektorit kur përgjegjësi, që ka më shumë punë se ata, gjen kohë edhe të punojë në prodhim. Drejtori i një ndërmarrjeje kërkon llogari një më një, sepse është vetë në rregull në radhë të parë. Një drejtor që punon, nuk i lë vartësit duarkryq; një drejtor që nuk komprometohet, nuk i lë as vartësit e vet të shohin nga xhepat e njëri-tjetrit... Sekretari i orga-

nizatës-bazë së Partisë të një ndërmarrjeje të prodhimeve të ndryshme është rrobaqepës vetë. Por jo nga ata rrobaqepës që me një dorë marrin në ndërmarrje, me dy duke bërë punë private. «E kam makinën në shtëpi, por për nder edhe një fustan të gruas që prej tre muajsh nuk po gjej kohë ta qep». Dhe pikërisht pse nuk komprometohet vetë në punë private pa u kërkon llogari gjer më një atyre që bëjnë gjëra të tilla. «Po pse, moj, bën punë private? — i tha një shoqeje rrobaqepëse në mbledhje. — Kush është më mirë se ti nga ana ekonomike?...».

Kjo është gjuha e njerëzve të ndershëm, punëtorë, modestë e të pakomprometuar. Është gjuha e njeriut të pastër, të panjollësuar. Këta janë balli i shoqërisë sonë, sepse jo vetëm janë vetë në rregull por, duke qenë të tillë, luftojnë më mirë edhe të metat e të tjerëve, i vënë dhe të tjerët në radhët e tyre.

Por mund të thotë dikush: «Mos vallë duhet të jesh i përsosur që të mund t'i vësh në dukje tjetrit një të metë?». Natyrisht që nuk ka njeri pa të meta, nuk ka njeri që të mos gabojë. Por revolucionar është ai që i njeh gabimet e veta dhe përpiqet seriozisht t'i ndreqë ato. Dhe njëkohësisht me të metat e veta të mësojë të ndreqë edhe ato të të tjerëve. Ja, për shembull, të kujtojmë sekretarin e byrosë së Partisë të kooperativës që përmendëm në fillim të shkrimit. «Isha një ditë në një organizatë-bazë, — tha. — Më kritikuan atje komunistët e asaj organizate, më bënë... ç'të të them. Pse? Sepse kritikova jo me takt një komunist. I fola shumë ashpër. Gabim i madh. Ashpërsinë ne duhet ta ruajmë për armiqët... Dhe nuk e harroj kurrë atë ditë dhe fja-

lët e komunistëve. Dhe tani, sa herë që bie fjala të kritikoj ndonjë, «kujdes, — i them vetes, — kujdes! Me takt. Pa kujto njëherë atë mbledhjen e asaj organizate e pastaj fol!... Ia kam vënë detyrë vetes të mos e përsëris kurrë».

NË DEBAT ME VLERË

NJË DEBAT ME VLERË

«Fshati që duket nuk do kallauz» thotë populli. Ta shtrosh sot çështjen duke thënë «e bën dot grua-ja detyrën e brigadieses a s'e bën», «ky është mendimi im, ky është mendimi yt», pra të hysh për orë të tëra në diskutime të tilla akademike e pa «bukë», siç na ndodhi me disa kuadro të një ndërmarrjeje bujqësore, kjo do të thotë, pa e tepruar, të mos shohësh dot ç'bëhet rrotull teje, do të thotë t'i kesh sytë të mbyllur. Shumica e punëtorëve të bujqësisë në këtë ndërmarrje bujqësore përbëhet nga gra e vajza, por në të gjitha brigadat ka vetëm tri brigadiere, asnjë përgjegjëse sektori. Në një mbledhje për rishikimin e vendeve të punonjësve të administratës të gjashtë vendet që u shkurtuan mbuloheshin vetëm nga gra e vajza. Merret me mend si tingëllojnë pas gjithë këtyre fjalët e mira të disa shokëve të ndërmarrjes, që thanë se «gratë e vajzat aty punojnë natë e ditë me heroizëm, megjithëse me fëmijë, me punët e shtëpisë, etj. etj».

— Nuk e bëjnë dot gratë detyrën e brigadieses, — thoshte shefi i kuadrit.

— Puna e brigadierit, kërkon përgjegjësi materiale, — thoshte drejtori. — Janë qindra thasë që duhet të mbahen në ngarkim në kohën e grumbullimit të misrit, po sa për mua...

— Brigadieri duhet të rrijë vonë natën, kurse gratë...

Ndërsa gratë me të cilat biseduam na thanë të kundërtat e atyre.

— Ne edhe natën punojmë kur kemi fushata, — tha njëra. — Në orën 3 e 4 çohemi. A nuk është natë?

— Kur ne shkojmë në stërvitje ushtarake me ditë të tëra, gratë e drejtojnë brigadën, — tha brigadieri i foragjereve.

— E bëjnë që ç'ke me të detyrën e brigadies vajzat tona, — tha një grua. — Ç'u mungon? Shkollën e kanë, aftësitë i kanë. Drejtorja e ka fajin, që nuk cakton gra e vajza...

— E kemi fajin edhe ne vetë..., — tha një tjetër.

Të duket gjë vërtetë qesharake të kundërshtosh arsyetime kaq bindëse. Si mund të thuash për to se nuk e njohin profesionin, kur ato kanë lindur e janë rritur me dashurinë për grurin e misrin, kur ato nga mëngjesi deri në mbrëmje, gjithë jetën, si fëmija e kanë rritur me kujdes bimën? «Nuk kanë shkollë të mesme, që t'i fusim në administratë a t'i bëjmë brigadiere», thoshte shefi i kuadrit. Po ata 20 e ca burra pa shkollë të mesme që punojnë në administratë mos vallë kanë mbaruar ndonjë shkollë shtatë-a tetëvjeçare të veçantë? Drejtori, siç na tha, e çmonte shumë punën e grave, i vinte keq dhe kishte shumë dëshirë t'i vinte në vende drejtuese, bile «qysh nesër» — tha ai, — jap urdhër të bëhen brigadiere, por do të pendohen». Jo! Partia na mëson se duhet ta kuptojmë një herë e mirë dhe thellë se emancipimi i gruas, pra edhe ngritja e saj në përgjegjësi, ndihma që duhet t'i japim asaj për të zënë vendin e merituar në shoqërinë socialiste, nuk duhet të konside-

rohet si dhuratë, por si detyrë, jo si mëshirë a si hapje rruge femrave nga burrat, që gjoja janë eprorë nga intelekti dhe të destinuar të udhëheqin e të komandojnë. Çdo njeri, e sidomos çdo komunist, e ka detyrë t'i kuptojë thellë arsytet ideologjike, politike e ekonomike dhe të ngulë këmbë fort për ta zgjidhur këtë problem kaq të madh. Një komunist që e ha merakun për një çështje kaq të madhe, nuk rri të diskutojë për orë të tëra «e bën a s'e bën dot gruaja», por vret mendjen të gjejë rrugët si ta vërë në jetë këtë detyrë partie. Ka ngurrime edhe nga vetë gratë ndonjëherë, mund të thotë dikush. Edhe kjo është e vërtetë. Ato duhet të luftojnë vetë për të mbrojtur të drejtat e tyre që ua ka garantuar Partia. Por secili ka detyrë, sidomos komunistët, që në vend t'ua bëjnë gogol grave e vajzave punën e brigadierit a të përgjegjësit të sektorit, siç ndodh me ndonjë, duhet t'i ndihmojnë ato që këto punë t'i kryejnë sa më lehtë e sa më mirë. Vajzat e gratë e Shqipërisë, që me fjalën e Partisë në zemër dje u përleshën me fashistët e më vonë me diversantët, sot po ndërtojnë socializmin kantier më kantier, janë bërë drejtoresha ndërmarrjesh, sekretare partie, kryetare komitetesh në rrethe deri dhe ministre e jo më të mos jenë të zonjat për të drejtuar një brigadë me shoqet e shokët e tyre. Por për këtë, siç thotë shoku Enver në letrën që u dërgon kooperativisteve të Këmishtajt, «organizatat e Partisë dhe komunistët të bëhen promotorë të fuqishëm për t'i ngritur të gjithë njerëzit në këmbë, për të rritur tek ata sedrën, besimin dhe optimizmin revolucionar...»¹).

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime. 1974-1975», fq. 371.

Kjo këshillë e shokut Enver është e duhet të jetë një mësim i madh për të gjithë.

— Pse të mos përpiqemi t'i ndihmojmë gratë e vajzat të ngrihen në përgjegjësi? — na tha kryetari i një kooperative. — Pikërisht sektorët e brigadat që drejtohen prej tyre kanë arritur rezultate më të mira në prodhimet bujqësore. Veç kësaj, — shtoi kryetari, — të gjithë e kemi vënë re se vajzat dhe gratë drejtojnë po aq mirë sa edhe burrat.

— Pse mos burrat nuk drejtojnë mirë?! — tha njëri me buzën në gaz.

— Ka edhe brigadierë të dalluar, — ia ktheu kryetari, — por megjithatë gratë dhe vajzat (dhe ky është mendimi i shumicës dhe e vërteta) janë më të kujdesshme.

Dashurinë dhe këmbënguljen për punën, të grave e të vajzave të kësaj kooperative, e ka vërtetuar jeta. Veç rezultateve shumë të mira në të gjitha kulturat, le të sjellim edhe një fakt të vogël, në dukje, por shumë kuptimplotë: Gjatë një viti, nga 40 brigada të kësaj kooperative vetëm 10 mundën ta realizonin planin e prodhimit. Por këto 10 brigada drejtoheshin nga shoqe. Edhe në këtë kooperativë ka pasur nga ata që i shihnin me mosbesim aftësitë drejtuese të grave e të vajzave. Kur u caktua një brigadiere në sektorin e parë, 10-15 burra lanë mënjëherë punën e ikën. «Pse, — mbetëm ne të na drejtojë një femër? — thanë. — Ajo ka për të na fikur». Mirëpo nuk kaloi shumë dhe brigada e saj e tejkaloi me 6 kv për ha rendimentin e grurit, kurse duhan dorëzoi më shumë se të gjitha brigadat.

— S'të lë brigadierja, t'i shkelësh një santim rregullat e kodit agroteknik — thonë kooperativistët.

Por nuk është kjo e vetmja kooperativë dhe nuk janë vetëm këto gra e vajza nga të cilat mund të marrin shembull ata që «friken» t'i ngrenë vajzat e gratë në vende drejtuese. Ka boll. Mjafton t'i shohësh e të përpiqesh të fitosh nga shembulli i tyre, i cili të gëzon e të entuziazmon. «Partia jonë e dashur, — thotë shoku Enver në letrën që u dërgon kooperativistëve të Këmishtajt, — ka edukuar e përgatitur gra të tilla revolucionare, punëtore të palodhura..., që me vullnet të madh e me këmbëngulje mësojnë dhe luftojnë për të përvetësuar e për të vënë në jetë eksperiencën e përparuar e të rejat e shkencës, për revolucionarizimin dhe për të çuar përpara prodhimin bujqësor. Kjo dëshmon edhe një herë se porosia e Partisë, për ta ngritur sa më lart rolin e grave në ndërtimin socialist, për t'u besuar atyre pa druajtje dhe në çdo fushë vende me përgjegjësi, ka qenë plotësisht e drejtë»¹).

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1974-1975», fq. 366.

GJURMUESIT E PUNËVE TË «ZGJEDHURA»

Në zyrën e punës të një qyteti, vajti një i ri 17-vjeçar. Ai nuk ishte pa punë. Kishte qenë tornitor. Mirëpo «punohet me tri turne!?!», tha «Punohet — i thamë ne. — Sidomos kur je i ri, 17 vjeç». Atëherë ai nxori një arsye tjetër: kishte ca ditë që se si i kishte hyrë në qejf të punonte në port. Kjo kishte qenë një arsye e vjetër e përsëritur e tij: brenda fare pak kohësh ai kishte ndërruar pa asnjë arsye tri ndërmarrje.

Ka nga këta «tipa», që gjurmojnë punë të zgjedhura. Midis tyre ka edhe vajza të reja, që presin me muaj të tërë në shtëpi me shpresë se një ditë babi do të sjellë lajmin e gëzuar: «Të gjeta një punë me kalem, bijë!»

Habitesh, si munden, vallë, këta njerëz të jetojnë si parazitë!? Po kur ulen të hanë mëngjesin, drekën, darkën, a nuk u shkon ndër mend vallë, se aty është djersa e babait, që vjen nga uzina me këmi-shën «ujë», e nënës, që kthehet nga puna në 12 të natës, etj?

Tek ne, pas Çlirimit, papunësia asnjëherë nuk ka qenë problem. Përkundrazi. Ne kemi nevoja, bile të ngutshme, për fuqi punëtore. Të tilla janë tani ritmet e ndërtimit të socializmit. Edhe në edukimin

e këtyre njerëzve që sorollaten pa punë duke gjurmuar punët «e zgjedhura» kemi pasur sukses. Organizatat e masave, të udhëhequra nga Partia, i kanë bindur ata për domosdoshmërinë e punës në socializëm. Prandaj numri i njerëzve që jetonin parazitë në kurriz të shoqërisë është shkurtuar mjaft, sidomos pas vendimeve të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë. Dhe kjo sepse këtyre njerëzve po u krijohet një opinion mbytës.

Por veç jo kudo po ndodh kështu, përderisa ka akoma njerëz që jetojnë në krahët e të tjerëve. Ka mjaft vajza të reja që kanë mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme. Ato nuk shkojnë të punojnë në fabrika ose uzina ku u thonë, po presin mos rregullojnë ndonjë vend si laborante ose karteliste, «punë me kalem», siç thonë vetë ato. Pse? Ku punojnë prindërit, vëllezërit, motrat e tyre? Mos vallë janë bërë të gjithë laborantë? Pse nuk mësojnë nga shembulli i 80 e ca shoqeve të rrethit të Durrësit, që megjithëse mbaruan shkollën e mesme shkuan të punojnë tornitore, frezatore, në serrat, ose ndërmarrje industriale? Por jo vetëm këta. Qindra e mijëra të rinj e të reja punojnë e jetojnë sot në çdo skaj të Shqipërisë e në ballë të vështirësive.

Ndodh shpesh që ndjenjën mikroborgjeze të punës «së zgjedhur» e ushqejnë edhe disa prindër. Në një komitet ekzekutiv na treguan për prindin e një-rës që ngulte këmbë t'i gjenin ndonjë «nëpunësi» vajzës së vet, megjithëse ajo vetë ishte me tetëvjeçare. Komiteti i kish rekomanduar kësaj vajze disa lloj punësh, po ajo s'pranonte që s'pranonte. Ç'duhet bërë? Në radhë të parë në lagje e qendra pune duhet të bëjnë një punë më të kujdesshme bindëse me ta. Por duhet lënë mënjanë një farë sentimentalizmi që

vihet re tek ndonjë shok, që nën maskën e «dhënies prioritet metodës së bindjes» nuk zbaton si duhet ligjin mbi vendosjen e detyruar të parazitëve në punë. Metoda e bindjes ka qenë e do të jetë gjithmonë në themel të punës së Partisë dhe jo vetëm për problemin e atyre që sorollaten pa punë. Por kjo s'do të thotë që të mos zbatohet detyrimi. Të dyja duhen konfirmuar.

Lidhur me sistemimin e njerëzve që ende janë të pazënë në punë dalin mjaft probleme, të cilat janë të vështira, por pas një studimi të hollësishëm e një organizimi më të mirë mund të gjejnë zgjidhje. Së pari duhet bërë maksimumi i zëvendësimit të burrave që punojnë brenda në qytet me gra; burime të tjera janë edhe kthimi në fshat i specialistëve jo të domosdoshëm të tërhequr prej andej. Specialistë, në qoftë se nuk ka plotësisht në qytet, le të përgatiten. Pastaj, pse të mos dërgohen akoma më shumë, sidomos të rinj, të punojnë jashtë rrethit? Janë qindra e mijëra të rinj e të reja sot që punojnë në të katër anët e atdheut, bile me vite të tëra, pa as më të voglin pretendim. Në një zonë të thellë të Veriut a në Jugë, mund të punosh jo vetëm mësues, mjek a inxhinier, por edhe tornitor, karpentier, bujk. Socializmi është i të gjithëve, socializmi ndërtohet me të gjitha profesionet dhe ndërtohet në çdo skaj të Shqipërisë.

Ka edhe mjaft shkaqe të tjera që bëjnë të mbiten qoftë dhe përkohësisht mjaft forca të lira, të pazëna në punë. Lëvizjet e tepërta, për shembull. Po të shohësh disa librezat punëtorësh do të vësh re të regjistruara në to 7, 8, 10, 15 a më shumë ndërmarrje. Pse? Vërtet këtë e sjell ndjenja e tyre mikroborgjeze e rendjes pas punës së rehatshme, por këtë

e sjell edhe puna e paktë edukative e bindëse në ndërmarrjet ku ata kanë punuar më parë. Jo, vjen tjetri të thotë «Dua të largohem» dhe ti, shef kuadri a drejtor, menjëherë: «Posi! E ke të drejtën tënde. Urdhëro librezën». Duhet qëndruar tek njeriu. Si, pse do të largohesh? Qysh? Tek? Duhet bërë problem largimi i tij. Ai mund të largohet vetëm në qoftë se ka arsye të forta të largohet: në qoftë se, për shembull, shihet se mund t'i japë socializmit më shumë në vendin tjetër që kërkon të shkojë (raste të tilla ka mjaft), ose në qoftë se ka vërtet ndonjë arsye të fortë familjare. Dhe jo thjesht pse «ashtu i ka shkrepur atij në kokë», ose se atje ku shkon ai «del më lehtë leku». Le të edukohet aty ku është të punojë më shumë, që të marrë më shumë, shoqëria në radhë të parë, pastaj dhe ai, ose ajo.

I thamë këto, pasi në mjaft ndërmarrje të ndërimit, sidomos në disa NB, këto «ik ti, hajde tjetri» janë bërë të zakonshme.

Puna për edukimin e njerëzve është e vështirë. Po kjo është detyra jonë, e të gjithëve. «T'i japësh duart» tjetrit, ta «shtysh» është më e lehta punë që mund të bëhet. Qëllon për shembull që duhet bërë shkurtim i fuqisë punëtore, dhe e kanë gjetur lehtë disa drejtues, shefa kuadri: gjithmonë shkurtojnë më të padisiplinuarit. Ose e kundërta: i dërgon zyra e punës e qytetit një ose dy të tillë: «Nuk të pranoj — i thotë shefi i kuadrit — se, je kështu, je ashtu». Asnjëri nuk dëshiron të ketë shokë pune një njeri të padisiplinuar. Kjo është e natyrshme. Po në fund të fundit ai ekziston realisht dhe diku do të punojë e do të edukohet patjetër. Po ku? Ti nuk e merr, ai tjetri jo! Atëherë (!) Kjo është tendencë mjaft e gabuar.

Ndodh edhe kështu. Në një zyrë pune bëhet ky dialog:

— Punëtori: — Më jep një vërtetim, se dua të punoj në ndërmarrjen X.

Nëpunësi: — Atje nuk ka vend bosh.

Punëtori: — Ka, ka. Ç'ke ti? E di unë. Ka biseduar babi me drejtorin...

Nëpunësi ngre supet. Kuadrin, fuqinë punëtore duhet ta dërgojë ai, kur ja... hatërllëku, miqësia ngre kokën. Nëpunësi mund të ketë planifikuar të tjerë në këtë ose atë ndërmarrje, por i zë më parë drejtorin, shefi i kuadrin dhe të planifikuarit e nëpunësit të zyrës bëhen të tepërt. Këto praktika janë shumë të dëmshme, prandaj është përsëri detyrë e organizatave të Partisë, në radhë të parë, që jo vetëm të dinë sa punëtorë vijnë në ndërmarrjen e tyre, por edhe si vijnë.

Problemi i normalizimit të fuqisë punëtore është shumë i gjerë e i komplikuar. Aty ngërthehen mjaft çështje të mprehta ekonomike, sociale, politike, ideologjike dhe nuk mund të ezaurohen as me një shkrim, as me një mbledhje ose me një aksion. Kërkohej një punë më e harmonizuar, e studiuar me vëmendje dhe e organizuar më mirë.

AUTOKRITIKË DHE «AUTOKRITIKË»

Ka një tregim anekdotik për një të quajtur Thanas. Namin siç thonë, bënte Thanasi në punë: grin-du me një shok, shpif për tjetrin; pesë ditë e shihje në repart, të gjashtën «avullohej», do ta ndajë kot gruan Thanasi; Thanasi rrahu një fqinj në pallat... Shkurt një mbledhje të paktën në muaj kolektivi i repartit e kishte peshqesh nga Thanasi. Por kur vinte dita e mbledhjes, ai Thanas aq harbut e aq «i hedhur» bëhej qengj. Ulej në një cep të sallës së mbledhjes, vinte një bllok përpara dhe ndërsa shokët fillonin ta kritikonin me radhë, ai ulte kokën dhe i heshtur mbushte fletët e bllokut njërën pas tjetrës.

— Hë, Thanas, fol — i thoshte në fund përgjegjësi i repartit. — Si i kupton ti kritikrat e shokëve?

Thanasi çohet ngadalë e kokulur. Merrte bllokun në dorë, me fytyrë gjithë dhembje dhe si i persekutuar fillonte autokritikën:

— Të gjitha kritikrat tuaja janë plotësisht të drejta, shokë. Bile me ca nga shokët nuk jam dakord. Kritikrat e tyre ishin shumë të buta. Më kritikoni ashpër, shokë. Më dërrmoni. Unë nuk e meritoj besimin tuaj. Gruaja dhe pesë fëmijët presin rrogën time në shtëpi, kurse unë bredh pijetoreve. Unë jam kri-

minel i fëmijëve të mi, i gruas, që e kam një vit të sëmurë, i nënës plakë, që kam në shtëpi, i... Ju lutem më dënoni...

Por Thanasin nuk e linin të mbaronte autokritikën. Ngrihej e para nënë Xhevrija e gati me lot në sy i drejtohej kolektivit:

— Amani, more çuna, po ç'bëni kështu! Faljani, se gjynah! Nuk e shikoni si flet?! Po nuk pritet kokë e falur, de!...

Ky ishte pothuaj fundi i çdo mbledhjeje. Pas këtyre fjalëve të nënë Xhevrijës ose të ndonjë tjetre dëgjoheshin edhe ca thënie të tilla si:

— Po faljani, dreqit, faljani, se gjynah!

— Edhe këtë herë po të falim, po...

— Faljani!...

Njerëzit dilnin nga mbledhja. Kur Thanasi shihte se s'kishte njeri në sallë, ia shkelte njëherë syrin vetes: «Ua drodha dhe këtë radhë», thoshte pastaj, dhe largohej.

...U zgjatëm ca me historinë e Thanasit, por na duket se skena të ngjashme me këtë, ku njerëz të tillë të pacipë e hipokritë luajnë mbi naivët, tolerantë, e njerëz të sëmurë nga sentimentalizmi, ka mjaft. Nuk janë të pakta rastet kur «autokritikën» ata e përdorin thjesht si një varkë shpëtimi në lumin e gabimeve të tyre. Një punëtor motorist në një ndërmarrje e kishte bërë zakon të merrte nga «një sy gjumë» natën në orar të punës. Po iu bllokua një natë motori, iu dogj, dhe 200 mijë lekë fluturuan... Dhe ç'ndodhi në mbledhje?

— Hë, fol pse e bërë gabimin? — i thanë.

Ai në fillim s'fliste. Por disa shokë të tij mendjeshkurtër, duke e ndier se heshtja do ta rrezikonte, zunë t'i përshpërisin nga mbrapa:

— Ngrihu, a derëbardhë, futi një autokritikë dhe dil matanë. . .

Dhe kështu ndodhi vërtet.

Ose rasti i një të riut në shkollën e mesme industriale. Gabim pas gabimi e kishte mbushur mirë kupën. Mirëpo «shoqëria», që e rrethonte në mbledhjen e fundit të organizatës së rinisë u tremb mos e pësonte shoku i tyre, prandaj filloi ta orientonte:

— Po ngrihu, more, bëj një autokritikë, pse rri kështu si i humbur? . . .

Bile këta shokë e kishin porositur që para mbledhjes shokun e tyre: «Mos u mërzit, s'të bëjnë gjë po bëre autokritikë. Ti ngreu, formulën e autokritikës e di, e ke mësuar përmendsh, ato fjalë që ke thënë do të thuash rapë dhe. . . e hodhe. . .»

Dhe do ta kishte hedhur vërtet përsëri lumin po të mos kishte insistuar kolektivi i klasës që vendosi me këmbëngulje ta përjashtonte nga shkolla.

Përse duhet mbajtur qëndrim sentimental nga disa ndaj këtyre lloj njerëzve? Tek ta duhet qëndruar seriozisht dhe gjatë. Ata duhen diskutuar e dënuar në radhë të parë si njerëz që mbartin në vetvete një nga veset më të këqija: hipokrizinë. Përse duhet qëndruar «me dorë në zemër» për këta, kur ata fare hapur tallen e luajnë me një kolektiv të tërë? Dhe kjo nuk ndodh vetëm me të rinj. Kjo ndodh edhe me të moshuar, bile edhe me ndonjë komunist. Ndodh që mblidhet organizata-bazë e Partisë pesë-gjashtë herë me radhë duke diskutuar për një njeri që përsërit gabimet. Ndoshta edhe të njëjtat gabime disa herë me radhë. Dhe ne në çdo kohë, duke gjykuar si «gjyshër sentimentalë», bëjmë kritikën e zakonshme, dëgjojmë autokritikën e tij të zakonshme for-

male dhe me një «T'ia falim edhe këtë herë» e mbyllim mbledhjen.

Mbledhja e kolektivit, e aq më tepër mbledhja e organizatës-bazë, nuk është faltore. Çdo njeri, çdo komunist në këto raste nuk duhet të gjykojë cekët. Përse duhet të nisemi në këto raste nga mëshira kristiane «Koka e falur nuk pritet» kur ne e shohim fare hapur që në këtë kokë gjoja të ulur nga turpi lëvizin dy sy dredharakë, që kërkojnë t'u hedhin hi dhjetëra syve të tjerë? Dashamirësia është së pari për njerëzit e sinqertë, për ata që vërtet e kuptojnë thellë gabimin, për njerëzit me sedër të shëndoshë, që u vjen turp të dalin para shokëve për një gabim, u skuqet faqja kur e shikojnë veten në faj dhe autokritikën e bëjnë më tepër me punë, se me fjalë. Dashuria dhe dashamirësia janë tjetër gjë, sentimentalizmi i sëmurë, karakteristikë e tolerantëve e naivëve, është tjetër gjë. Sepse edhe një logjikë fare elementare të thotë se përderisa një njeri nuk ka respekt për një kolektiv të tërë, që i mban kot 2-3 orë në mbledhje, ose më mirë që tallet 2-3 orë me shokët, atëherë pse shokët nuk paskan të drejtë të marrin një masë kundër tij? Por ja, të del përpara shprehja «Koka e falur nuk pritet». Ka mjaft njerëz që autokritikën e lidhin gjithmonë me faljen e një gabimi. Fjalën «autokritikë» e bëjnë gati-gati sinonim të fjalës «falje», «kërkesë për falje». Kush e tha këtë?! Në radhë të parë njëherë edhe sikur gabimi të bëhet pa dashje, ose të mos jetë i përsëritur, ai ndëshkohet (Pavarësisht nga lloji i ndëshkimit). Autokritika nuk e përjashton masën, dënimin. Sepse masa, dënimi që jep kolektivi ose organizata është reagim, masë edukimi, është «çmim» për atë që ke bërë (që është bërë fakt) dhe jo për atë që

mendohet të bëhet më vonë. Kurse njerëzit që gabimet për të cilin gjykohen nga kolektivi ose organizata-bazë i shtojnë gjatë mbledhjes gabimin tjetër, mungesën e sinqeritetit, hipokrizinë (në qëndrimin ndaj shokëve) duhen gjykuar për të dyja.

Autokritika është një armë e fortë që na rekomandon Partia për të na ecur më mbarë puna, qoftë në ndërmarrje ku punojmë, në lagje ose në shoqëri. Ajo është një bisedë e madhe, e thellë dhe e sinqertë me vetveten, në radhë të parë. Është një analizë e drejtë, e ashpër e parimore që bëjmë në radhë të parë me vetveten. Nuk ka njeri ose komunist që të mos gabojë, na mëson Partia. Po ka njerëz ose komunistë që pasi dinë t'i njohin mirë gabimet e tyre, t'i njohin sinqerisht gabimet e tyre, dinë pastaj edhe t'i korrigjojnë. Autokritika bëhet me punë për ndreqjen e gabimeve. Ky është i vetmi kriter vlerësimi.

Para nja dy vjetësh disa shokë të drejtorisë dhe të organizatës së Partisë të një uzine mbanin qëndrim skeptik ndaj prodhimit të makinave larëse. «Nuk i bëjmë dot», thanë ata duke injoruar në mënyrë subjektive forcën dhe frymën luftarake të një kolektivi të tërë. Por plenumi i Komitetit të Partisë të rrethit i kritikoi rëndë. Bile vendosi dhe u vuri një fletërrufe mu në mes të ndërmarrjes. Dhe ç'ndodhi paskësaj? Ata nuk brodhën duke u lutur para kolektivit të uzinës duke thënë «Amani, shokë, na falni, mos na dënioni». Ata nuk menduan për dënimin, po filluan seriozisht të gjejnë vetë dhe me ndihmën e shokëve shkaqet e mendimeve të tyre të gabuara. Dhe me ndihmën e kolektivit ata i gjetën gabimet. Vetëm pas kësaj drejtuesit e ndërmarrjes dhe të organizatës së Partisë dolën e bënë autokritikë. Bënë autokriti-

kë të sinqertë në organizatën e Partisë dhe në kolektiv. Dhe që ishte e tillë autokritika e tyre, këtë e tregoi puna, e treguan rezultatet e mëvonshme. Uzinat jo vetëm që i prodhoi makinat larëse, po shumë të mira, bile. Dhe autokritika e tyre pati jehonë të gjatë. Pas makinës larëse uzina filloi të ngrejë edhe mjaft linja e reparte të reja. Ngriti repartin e galvanizimit, repartin e veglave të pajisjeve bujqësore (për të cilat u krijua një uzinë më vete); u ngrit linja e prodhimit të stufave të emaluara tipi I (kohët e fundit edhe një tip i dytë); u ngrit linja e tenxhereve tip «bombe» siç i thonë ata, linja e vendosjes së shiritit inoksidabël në buzët e enëve të aluminit, bateritë gjysmautomatike e automatike për kombinatin e pularisë etj. Ja, kjo është autokritika e tyre. Kjo mund të quhet vërtet autokritikë. Autokritika e vërtetë na duhet si uji, si ajri, si drita. Efektin e saj të jashtëzakonshëm po e shohim e provojmë kudo, në ndërmarrje, kooperativa bujqësore, reparte ushtarake, institucione, shkolla etj. etj. Ajo është shndërruar në armë të vërtetë për të korrigjuar të metat tona dhe për të ecur më vrullshëm përpara.

PUNËS NJERIUN, JO NJERIUT PUNËN

Gjithçka e arritur te ne gjatë viteve të pushtetit popullor është rezultat i një pune vetëmohuese të popullit, të udhëhequr nga Partia. Partia është përpjekur dhe po përpiqet të na e fusë në gjak edukatën e punës, të na e bëjë natyrë. Sepse puna e përbashkët shoqërore është nga kriteret bazë që përcakton vlerën e njeriut. Ajo të bën të aftë të transformosh natyrën, të ndihmon të ndërtosh socializmin në të gjitha fushat ekonomike, politike e ideologjike. Dhe kemi arritur gjer këtu, se kemi punuar, se kemi qenë të aftë të bëjmë kaq shumë. Mirëpo koha, stadi i arritur, kushtet e reja kërkojnë një lartësi të re, të disiplinës së punës dhe të kualifikimit. Çdo qëndrim liberal në kërkesat për aftësimin e mëtejshëm në punë të vetvetes, është qëndrim liberal ndaj shoqërisë, ndaj socializmit. Por megjithatë nuk janë të rralla rastet kur në disa sektorë për sentimentalizëm të njërit ose të tjetrit i gjendet një punë e mirë, e lehtë, me pagë të mirë, por për t'i bërë mirë këtij ose atij e jo punës. Natyrisht rruga është përpjekja e vazhdueshme për t'u kualifikuar. Dhe përgjithësisht kështu po ndodh. Shembujt janë të panumërt. Njohim një njeri, për shembull. E vërteta është se në fakultet ai ishte student i 5-ës dhe

i 6-ës. Kishim vite pa u takuar dhe u habitëm kur për të si agronom thanë fjalët më të mira në një aktiv për bujqësinë. «Është e pamundur — tha njëri. — Ai ka qenë nga të fundit e studentëve. Si i ka arritur gjithë këto rezultate?!» «Ndoshta është ndo një agronom tjetër me emrin e tij», tha një tjetër. Po ishte pikërisht ai, por jo «ai i pari». Puna e Partisë, njerëzit me të cilët kishte punuar, jeta e kishite pjekur, e kishte bërë punëtor të palodhur, i kishite dhënë pasionin e punës. Dhe ai kishte ecur përpara si kanë ecur qindra e mijëra shokë e shoqe të tij në të katër anët e vendit tonë.

Por ka edhe të tillë që s'kanë ecur dot me kohën. Mirëpo puna nuk pret dot ritmin tënd të ngadalshëm të aftësimit. Sidomos ka disa që për kaq e kaq vite nuk kanë dhënë sa duhet e si duhet, kanë mbetur prapa. Arsimi i paktë, horizonti i kufizuar kulturor (natyrisht këtu është fjala edhe për kulturën profesionale) ua ka mbyllur perspektivën për atë vend pune. Ç'duhet bërë? Një njeri i ndërgjegjshëm, që i kupton drejt orientimet dhe politikën e Partisë, që e kupton se, dashur padashur, i bëhet pengesë socializmit, vullnetarisht largohet në një punë tjetër, ku mund të japë më shumë. Dhe shembuj të tillë ka tek ne. Ka dhe nga ata që kanë qenë edhe në luftë, bile nga më trimat. Gjer disa vite më parë i kanë përballuar kërkesat e punës në atë sektor. Por më tutje s'e kanë ndjekur dot kohën. Por njerëz të tillë, me aftësi të pamjaftueshme ka dhe të rinj, bile me diplomë në xhep. Po si e kanë marrë atë diplomë!... Me të shtytur. Me një pesë ose gjash-të. Me riprovime. Edhe tani në jetë ka ish-studentë të prapambetur që nuk kanë gjetur dot forca për

të dalë nga mediokriteti. Pra, ka shfaqje të dyan-
shme.

Por, siç thamë, ka prej tyre që duke e kuptuar Partinë nuk ngurrojnë t'ua lënë vendin të tjerëve. Akti i tyre tregon dashuri për Partinë e për socializmin, tregon për qartësi politike e ideologjike.

Njëherë takuam në një qytet një njeri të tillë. Punonte si kuadër në një organ të rrethit. Është një njeri që kur bisedon me të të fut entuziazmin në shpirt. Singëriteti, ndershmëria prej komunisti të bëjnë ta duash. E di ç'bëri në një mbledhje të organizatës së vet të Partisë? U ngrit dhe «unë, vëllezër — tha — po e shoh që aftësitë e mia nuk po e përballojnë dot punën që më kanë caktuar. Prandaj më zëvendësoni me një njeri më të aftë». Dhe kjo që bëri nuk është gjë e vogël, që e bëjnë lehtë të gjithë. Në punën e re paga ishte më e vogël. Por ai kishte katër fëmijë dhe i kishte nëpër shkolla. Bile për një nga ata paguante çdo muaj. Pastaj gruaja e tij nuk punonte, se ishte e sëmurë prej vitesh. Veç kësaj jeta ka, si për të gjithë, shqetësimet, preokupimet e veta. Kurse ka mjaft të atillë që megjithëse i kanë të gjitha kushtet për të punuar, për të studiuar e për t'u bërë zot të profesionit, kanë mbetur të paftë dhe e fshehin me fanatizëm paaftësinë e tyre.

Njeriu e ndien veten të qetë, ai ka dinjitet, ka personalitet, kur në radhë të parë është i zoti i punës së vet. Ç'kuptim ka të punosh sa për të marrë një rrogë? Por ndodh shpesh që edhe vetë shokët, kolektivi, një opinion jo i shëndoshë qëndron indiferent ndaj njerëzve që nuk përpiqen të aftësohen. Ne e kritikojmë një shok për arrogancë, për indiferentizëm, po rrallë i themi «Je i paftë për këtë punë.» Qëllon që kur një shok e pranojmë në organi-

zatën e Bashkimeve Profesionale e pyesim për ndonjë të metë që ka. Dhe ai nuk druan të të thotë për vete se është ca kokëfortë, se ka ndonjë shfaqje liberale, por vështirë të të thotë «jam i paaftë për këtë punë». Mirë, ai s'e thotë, po ne pse nuk e pyesim? Ose kur bëjmë në kolektiv karakteristikën e një shoku ose të një shoqeje që transferohet, zor se shënojmë në të se është i paaftë për filan punë. Ka shumë burime që ushqejnë paaftësinë profesionale. Ne vetë ndonjëherë me keqardhje mikroborgjeze e ushqejmë paaftësinë. Ose lajkaxhinjtë, për shembull, oportunistët. Ata, megjithëse janë të bindur plotësisht në vetvete se shoku ose shoqja e tyre punën nuk e ka kryer mirë, e lavdërojnë. «E ke qarë», i thonë duke i shtrënguar dorën. Dhe ajo punë është vërtet për të qarë, por jo në kuptimin figurativ... Përgjithësisht të paaftët ushqehen nga të paaftët. Një njeri i paaftë ngre në përgjegjësi një të paaftë. Ca e bëjnë këtë pa ndërgjegje. Ai kaq e ka horizontin e vet.

Të paaftit njeriu me horizont të kufizuar i duket i aftë. Ca të tjerë (që janë më të dëmshmit) e bëjnë me ndërgjegje. Ata zgjedhin pranë vetes, ose pak nën vete, të paaftë, se këta kanë pak shanse për t'i kritikuar, por sidomos për t'i zëvendësuar. Njerëz të tillë janë karrieristë. Ata nuk i ha meraku i punës, por i vendit. Por ndodh që të paaftët ushqehen edhe nga të aftë në profesion, por naivë, njerëz të ngathët e miopë. Ata e shohin që i paafti e shfrytëzon punën e tyre për të mbuluar dobësitë e veta, por megjithatë heshtin. Herë tregohen frikacakë, herë konformistë e herë oportunistë. Nuk përpiqen ta evidentojnë paaftësinë e tjetrit, që pastaj ta shërojnë më lehtë.

Qëndrimi formal në një vend pune e dëmton

rëndë atë sektor. «Partisë i bën mirë — na tha kuadri veteran për të cilin treguam në fillim — kur punon mirë, jo kur mban një vend të mirë, por formal. Mirëpo disa flasin bile bukur me parimet për qarkullimin, por kur vjen puna, s'e lënë karriken. Kush i pengon? Xhepi, interesi personal. Duan ta mbyllin periudhën e punës me karriken, që të mos u ulet pensioni. Kush pengon tjetër? Opinioni i sëmurë. Kanë turp mos u thonë «E hoqën filanin se nuk qe i zoti i punës». Por ne duhet ta thyejmë këtë opinion të sëmurë. Se po nuk e thyem ne, që jemi komunistë, ne, që Partia na ka besuar funksione, atëherë kush duhet ta thyejë?! S'ka pse të na vijë turp. Turp është kur pengon punën. Po të punoj mirë unë, atje ku të më çojnë, s'ka pse të më vijë turp. Kështu na mëson Partia. E ç'do të ishim ne pa Partinë?» Kështu ka qenë gjithmonë ky veteran me Partinë, i ndershëm, i sinqertë. Ai ishte vëllai i një dëshmori pra që në kohën e luftës e tregoi dashurinë për Partinë. Ai qe partizan trim. Trim u tregua edhe pas luftës. Ku e dërgoi Partia punoi. Me aq sa mundi. Dhe nuk është hera e parë që u ngrit vullnetarisht të kërkonte qarkullim. Dhe kjo nuk qe një gatishmëri e përgjithshme, sa për të hedhur «lumin», siç bëjnë disa që detyrohen të thonë vetëm fjalët: «Jam gati të shkoj atje ku ka nevojë atdheu». Që në 1966-tën ai kërkoi të qarkullonte. «Kërkova të punoja murator — tha kur bisedonim. — Pse të mos punoja? Unë atë zanat kam pasur. E dua atë zanat, se më ka mbajtur me bukë».

Ky është vlerësimi i vërtetë për qarkullimin, për punën. Mirëpo ndodh edhe kështu. Atë e kanë hequr për paaftësi «de facto», kurse «de jure», i thonë: «Do të të çojmë në filan sektor, si dorë të fortë.

Se atje ka çrregullime qamet...». Edhe në kolektivin ku shkon, me këtë motivacion e paraqesin. Atëherë i paraqituri me këtë kompliment bëhet megaloman. Merr me vete idenë e kundërt me të cilën e kanë përcjellë realisht. Dhe në vend të përpiqet të aftësohet, tani e fle mendjen përfundimisht (është quajtur «dorë e fortë») dhe megjithëse i pazoti, vihet në krye të një grupi njerëzish si më i zoti. Mendo pastaj çfarë «përforcimesh» mund të bëjë ai atje!

Aftësia nuk transportohet. Ajo edukohet vazhdimisht. Me punë sistematike, me lodhje. Prandaj janë përpjekjet e secilit, ndërgjegjja e secilit ato që vendosin. Ata që e ngrehin veten nga dita në ditë (dhe janë qindra mijëra punëtorë, kooperativistë, kuadro) që ndërtojnë socializmin, janë pikërisht nga njerëzit që dinë ta njohin veten, që dinë t'i kërkojnë llogari vetes. Çdo qëndrim zbutës ndaj vetes, të bën parazit në shoqëri. Se i paafiti në punën e vet faktikisht është parazit, pavarësisht se ka një emërim zyrtar dhe firmos në një bordero. Por ka dhe të atillë që nuk arrijnë ta kuptojnë se janë të paafte, mund të thotë dikush. Si s'e kupton?! Kur të kritikojnë gjithmonë për cilësinë dhe sasinë e punës, a nuk duhet vallë t'i vësh gishtin kokës e ta pyesësh veten për paaftësinë? Ose mundet që edhe s'të kritikojnë po kur s'të thonë njëherë «mirë», a nuk duhet të mendosh për punën tënde? Por edhe kolektivi ku ti punon nuk duhet të presë kur të të mbushet mendja ty ta pranosh vetë mediokritetin. Në mbledhjet vjetore, siç diskutohet për planin dhe detyrat e secilit të diskutohet dhe për mundësitë e zëvendësimit. Cilido qoftë: drejtues, punëtor, nëpunës. I vjetër ose i ri. Bile të rinjtë justifikohen më pak.

«FËMIJË, MOS LUANI PARA ZYRËS!»

1.

Ky titull që shënuam sipër shkrimit është «i vjedhur». I kopjuar fjalë për fjalë. E lexuam të shkruar mbi fasadën e zyrës së një këshilli popullor ku kaluam rastësisht një ditë. Por të çudit një fakt: toni i prerë i këtij urdhri të shkruar me gërma kapitale dhe me një ngjyrë të kuqe të fortë nuk u tërhiqte aspak vëmendjen nja dhjetë a pesëmbëdhjetë fëmijëve që luanin fare afër tij, m'u përpara zyrës së këshillit. Bile nja dy vajza të vogla, ndoshta për «variacion» (ndoshta dhe për ironi) zunë t'i përplasnin topat e llastikut mbi mur. Shenjat e topave të tyre të lagur e me baltë mbetën edhe mbi urdhrin e këshillit të lagjes. U afruam tek fëmijët:

— Pse luani këtu, para zyrës së këshillit?! — u thamë.

Ata lanë lojën dhe të heshtur panë njëri-tjetrin në sy.

— Si e ke emrin ti, çuni? — i thashë njërit, që ishte më pranë, dhe nxora bllokun.

Por ndërsa prisja që ai të më përgjigjej, papritur, shumica e tyre ia dhanë vrapit. U zhdukën. E pashë se u nxitova që në fillim me bllokun dhe ata që mbetën zura t'i marr me të mirë. Të merrja vesh të paktën pse u larguan ashtu në panik.

— Ne thamë se je nga ata të këshillit ti — tha njëri, që ishte nxënës në klasën e tretë. — Ata na bërtasin pse luajmë këtu me top.

— Jo, jo, nuk jam nga ata të këshillit. Ata pasdite vijnë...

— Ashtu, po... — tha.

Pas kësaj bisede, fëmija shkoi pas një pallati.

— O çuna! — thirri me zë të fortë. — Hajdeni, mos kini frikë, se nuk qenka nga ata të këshillit!...

Pas pak u grumbulluan të gjithë. M'i treguan dhe emrat. Shënova vetëm disa prej tyre. Agimi, Hektori, Altini, Dritani, Sokoli, Ermira.

Dhe biseduam gjatë. Po kopjoj fjalët e secilit që kam shënuar:

Arbeni: Mirë, po pse, ku të luajmë ne tjetër? Pse, ku ka vend tjetër, këtu në lagje?!

Dritani: Lum ata të lagjeve të tjera që kanë sheshe shumë të bukura!

Altini: Ja, ne lozim dhe këtu, te ky sheshi në mes të pallateve, po ku të lë Meti? Ai del te penxherja. «Do të ikni në shtëpi, — na thotë — apo t'ju vij aty unë?..».

Hektori: E, ashtu, ashtu... Ai Meti sa rregullojmë portat e futbollit ne, shkon në këshill... Ata të këshillit vijnë e na përzënë pastaj.

Dritani: E, e. Ça Meti! Ai të bërtet, po ai s'ta çan topin si ky Vasili që ka këtë shtëpinë e madhe të rrethuar me gardh. Po të ra topi te bahçja e tij, ai ta merr e ta çan. Ja, alamet topi që kisha unë, treqindç, ma çau...

Hektori: Edhe mua ma për lau topin pesëdhjetë.

Dritani: Ndonjëherë ai dhe s't'i çan topat, po e di ç'bën!? T'i merr dhe t'i vën atje te tarraca. Ja, ja tek janë topat!!! I shikoni? (Hodha sytë nga tarraca

e atij që çante topat e fëmijëve. Pashë tre topa radhë. Ngjanin si një pre lufte, tepër kërcënuese. Me ta, ai sikur donte të thoshte: «E, i shikoni këta topa! Edhe tuajët këtu do të dergjen, këtë fat do të kenë, po të luani ndonjëherë pranë shtëpisë sime!»).

Rudina: (duke u drejtuar po nga unë) Pse, ju keni ardhur për të na bërë fushë, ë?! Urra! (Dhe hodhi me gëzim topin në ajër...)

Sokoli: Po të doni na i bëni si fushën e lagjes së Albanit. Sa e mirë është ajo?!

Agimi: Po ne kishim vetë alamet fushe. Kënaqeshim, për kokën e babait! Ja, këtu e kishim. Dhe e bëmë vetë, ë? Për kokën time vetë. Me bar, me porta prej druri. Po na i hoqën... Ça t'i bësh?

Shpresa: Epo ja, vetëm këta çunat luajnë. Neve hiç. S'kemi ku luajmë. Këta s'të lënë, se duan të luajnë vetë.

Agimi: Kush më?! Ne s'të lëmë?!

Drita: E më ju, po kush?!

Agimi: Ik më tutje ti!

Drita: Ik ti, ore!

(Ata filluan t'ia hedhin fajin njëri-tjetrit, të grinden. Sa keq kur je i vogël! Mund të grindesh, bile edhe mund ta pësosh kur fajin e ka një i madh...)

U ndamë me fëmijët dhe pritëm mbasditën për t'u takuar me ndonjë nga shokët e këshillit popullor të lagjes. Erdhi mbasditja. Takuam në zyrën e këshillit popullor të lagjes, vetë kryetarin. Ja një pjesë e dialogut që bëmë me të:

— Fëmijët te ky sheshi para zyrës i keni ndaluar ju, atje para pallatit i ndalojnë banorët. Shesh lojnash s'ka. Po ku do të luajnë ata?

— Ashtu është. Përsa i përket problemit të ndër-

timit të terreneve sportive për të luajtur fëmijët gjendja është shumë e keqe. Derman për të lojtur, fëmija s'kanë. Ne kemi dhe lagje të madhe: 8 blloqe. Kemi vetëm një shesh të vogël, që s'del as për një bllok. Po të kishim këmbëngulë ne mund të bënim diçka, se banorët e lagjes janë gati për çdo thirrje që mund t'i bëjmë ne për të ngritur terrene. Edhe ndërmarrjet, gjynah të qahemi, na japin material po t'u kërkojmë.

— Po atëherë?...

— Po ja, o, kemi dhe probleme të tjera. Jo strehimi, jo puna...

— Po kjo nuk kushton shumë. Mjafton një të diel dhe...

— Ashtu është, ashtu. Po ne nga prilli kemi ndër mend ta marrim në shqyrtim problemin e madh të pushimeve verore të fëmijëve...

— Vonë gjer aherë...

— Epo... Kurse përsa i përket problemit të marrjes së topave të fëmijëve nga banorët, ashtu është, siç ju kanë thënë fëmijët, marrin topat e fëmijëve dhe nuk i dorëzojnë. E thirrëm njërin një herë në lagje dhe e kritikua. Ai u detyrua të dorëzojë topin e marrë...

2.

Hymë qëllimisht nëpër ca hollësira po vetëm duke menduar se pothuaj të njëjtat dialoge e të njëjtat skena zhvillohen në lagje të tjera të disa qyteteve. Po ku do të luajnë ata pas mësimit kur njëri u thotë «shkoni në shtëpi», tjetri «Largohuni nga dritarja ime» e një i tretë u merr topat?... Shpeshherë pro-

blemi i hapjes së terreneve sportive ka marrë karakter fushatash.

Janë interesuar për këtë problem komitetet e Partisë, të rinisë dhe komitetet e kulturës fizike dhe sportive në rrethe. Por disa nga shokët e këshillave popullore të lagjeve e konsiderojnë këtë problem të madh të fëmijëve si «vrimë të fundit të kavallit». Dalin me pretekstin se gjoja nuk mund të gjejnë vende në lagje për të ngritur sheshe lojrash për fëmijë. Por në një rreth komisioni i ngritur i brodhi të gjitha lagjet e qytetit. Dhe thanë se në të gjitha blloqet kishte vende, dhe bile shumë të bollshme, për t'u ndërtuar fëmijëve shesh lojrash. Atëherë? Iu bë thirrje ndërmarrjeve të qytetit që të ndihmonin lagjet me materiale për ngritjen e terreneve sportive. Bile disa ndërmarrje premtuan se do të ndihmojnë edhe vetë për t'i hapur këto sheshe që kishin marrë nën kujdes. Dhe, ç'është e vërteta, ndërmarrjet nuk e hëngrën fjalën. Ja, për shembull, mjaft punëtorë të një uzine, me në krye drejtorin e tyre, iu përveshën punës dhe e ngritën sheshin e lojrave të lagjes. Bile fushën e basketbollit dhe të volejbollit edhe me pluhur tulle e shtruan. Edhe ata të ndërmarrjes metalike e ndërtuan terrenin sportiv të lagjes. Po kështu edhe disa ndërmarrje të tjera. Mirë, atëherë i ndërtuam, po sot? Ku janë terrenet e ndërtuara? Shumë prej tyre kanë marrë të tatëpjetën. Janë prishur. Pse? Janë prishur e, siç na thanë në komitetin e fiskulturës, këshillat e disa lagjeve janë mësuar që çdo gjë ta marrin si «qofte». Ata duan edhe t'ua zgjedhësh vendet e terreneve sportive, edhe t'ua ndërtosh, edhe t'ua mirëmbash. Nga kjo dëshirë e disa këshillave të lagjeve për t'ua dhënë çdo gjë «në gojë» e kanë pësuar terrenet

sportive të lagjeve. Se ndonjë marifet i madh nuk duhet për t'u kujdesur për terrenet sportive të fëmijëve. Duhet në radhë të parë ato të mos i quash «punë fëmijësh». Pastaj duhet ta zësh e ta vrasësh pak mendjen se fëmijët, po nuk u grumbulluan për të luajtur diku në ato vende të caktuara, ose do të luajnë me top para dritareve (që mund edhe t'i thyejnë) ose nëpër lulishtet e qytetit (e të prishin lulet), ose para ndonjë zyre (e të ironizojnë duke njollësuar me baltë urdhra të tilla si: «Mos luani para zyrës!»); ose do të luajnë në rrugë e do të rrezikojnë jetën nga makinat. Një nga këto rrugë ata do ta zgjedhin patjetër. Se fëmijë janë. Dhe fëmija sado i bindur e i edukuar të jetë, përderisa quhet fëmijë, do të luajë doemos. Loja është në natyrë të tyre. Prandaj të mos e quajmë të mbaruar punën tonë vetëm me ngritjen e terreneve sportive. Ndryshe do të përsëritet historia e vjetër.

«PSE T'I VIJË E KEQJA NGA UNË?!»

Përfytyrojeni veten në një mbledhje. Punonjësi (filan) e ka mbushur kupën më në fund dhe kolektivi është mbledhur t'i tregojë vendin:

Një punëtor: E, burazer! Njëzet herë vetëm për kokën tënde jemi mbledhur. Ti mungo në punë, ne fal; ti shpërdoro mallin e popullit, ne fal. Epo tani, që vure edhe dorë mbi djersën tonë, unë them që të largohesh menjëherë nga ndërmarrja jonë!

Filani: Bëj autokritikë të thellë, shokë. E kam ndier sinqerisht gabimin... Më falni! Po e përsërita më...

Një punonjës: Me sa mbaj mend unë nja shtatë herë e ke hedhur lumin me këtë autokritikën «e thellë» ti, shoku... U ngopëm. Edhe unë them të largohesh.

Shefi i kuadrit: Turp të kesh! Apo nuk të kujtohet si të kam pranuar në punë? Me aman e me derman, me... Jo, jo! Të largohesh!

Vendimi i kolektivit: «Filani të largohet nga puna dhe të dërgohet direkt në prodhim. Shkaku i largimit t'i shënohet në librezën e punës: «ka vënë dorë mbi pronën e përbashkët».

...Dhe «filani», pas disa ditësh, i mërzhitur shkon në zyrën e kuadrit, merr librezën e punës dhe largohet.

het. Bën dy hapa, pesë... Hap një herë librezën. Po ç'të shohë! Në librezë është shënuar: «Largohet me dëshirën e vet». Filani hap sytë nga habia. Ai ka lëvizur njëqind gurë për të mos u larguar, kurse... Megjithatë shënimi i pëlqeu. Me atë shënim ai mund të punojë ku t'i teket. I kënaqur, fut librezën në xhep dhe shkon i qetë të kërkojë punën që do...

...Ndoshta mund të ketë pasur nuanca të tjera mbledhja e zhvilluar para ca kohësh në një ndërmarrje tjetër. Veç esenca mbetet e njëjtë. Një kuzhinier e larguan nga puna, e zbuan. Kolektivi vendosi që ai të punojë në minierë, për t'u riedukuar pranë minatorëve, se doli deficiet, përvetësoi pronën e përbashkët. Por në librezën e punës shokët e kuadrit i shënuan: «Largohet me kërkesën e vet...» Doli «i larë» kuzhinieri. Dhe ia mbathi në një rreth tjetër. Kërkoi të hynte përsëri në tregëti. Se aty i dilte «Asi». Edhe kolektivi i ndërmarrjes tjetër e zboi nga gjiri i vet kuzhinierin sepse kishte përveçësuar pasurinë e përbashkët. Por edhe shokët e kuadrit të kësaj ndërmarrjeje në librezën e tij të punës shënuan: «Largohet me kërkesën e vet»...

Pse veprojnë kështu shokët e kuadrit të disa ndërmarrjeve? Ata janë «zemërmirë», janë «xhananë burra». Fjala «largohet me kërkesën e vet», është e magjishme. Ajo është si një «vizë», që atyre u jepet për të mundur të punojnë ku të duan. Ai për shembull mund të ketë punuar në tregëti dhe të ketë përveçësuar djersën e ballit të të tjerëve. I ligji e ndalon të punojë përsëri në tregëti. Po nga ta dinë ata të ndërmarrjes tjetër se ai ka qenë vjedhës? Fjalët «largohet me kërkesën e vet...», ia fshijnë si me dorë pluhurin e së kaluarës dhe ai mund t'i krijojë përsëri të gjitha kushtet për t'u ndodhur si ujku në

mes të dhëve. Pronën e përbashkët mund ta dëmtojë po aq lehtë sa në ndërmarrjen nga e cila u largua «me kërkesën e vet». Këto kuadro u bëjnë vjedhësve «të mira», se janë «shpirt njeriu». Kur një njeri e kanë përjashtuar nga puna dhe vete t'u kërkojë librezën e punës, ata përnjëherësh bëhen shumë «të ndjeshëm», shumë «të dhimbshëm», sentimentalë. Mblidhen kokë më kokë dhe pak a shumë bëjnë këtë dialog midis tyre:

— E mo?! E përjashtuam dreqin nga puna, si t'ia shënojmë arsyen e largimit në librezë?! Vodhi të themi? Sikur s'bën...

— Opo jepja, dreqit! Mos ia nxi! Shënoi: «Largohet me kërkesën e vet», që të mos i hapen avaze më tutje. Tani, që do të hajë një ditë kokën ai, kështu siç e ka nisur, kjo është si një e një që bëjnë dy... Po pse t'i vijë e keqja nga ne?! Pse të bëhemi ne sepse që të vuajë gjithë jetën?! Fundja ç'na kushton?!...

Kështu gjykojnë këta mikroborgjezë. Të shënosh në librezën e punës së një punonjësi shkakun real të largimit të tij nga puna (siç thuhet në një urdhëresë të Këshillit të Ministrave) për ta do të thotë «ta nxish» librezën. Fjalët «Pse t'i vijë e keqja nga unë», a nuk duan të thonë se janë liberalë, se u hapin shtigje me duart e tyre vjedhësve e shpërdoruesve, se i inkurajojnë, se i ndihmojnë? Po sikur të vepronin të gjithë kështu me ta? Ç'do të ndodhte? Këta nëpunës vihen në rolin e «të mirëve», të atyre që «mbrojnë» punonjësit. Mirëpo që të të bëjë mirë dikush, që të të mbrojë dikush, duhet që të ketë bërë keq dikush tjetër, të ketë sulmuar dikush tjetër. Kjo do të thotë se «zemërimi», «shpirti i njeriut» u kundërvihet ligjeve të Partisë e të shtetit. Logjika më

elementare këtu të çon. Ata thonë «të mos u vijë e keqja nga unë», vjedhësve, shpërdoruesve. Ç'është kjo e «keqe»? Pasojat e ligjit, e rregullave të vendosura? Ata vihen në rolin e «të mirëve». Mos vallë i dashkan ata njerëzit më tepër nga sa i duan ligjet e popullit? Po Partia, pse i ka nxjerrë këto ligje? Pikërisht për të mbrojtur punëtorët, gjithë punonjësit. Kjo është e mira e vërtetë, që u pret udhën abuzimeve të mëtejshme, jo ajo që inkurajojnë ata. Kjo është e mira e përgjithshme që sigurojnë ligjet tona.

Partia u ka siguruar njerëzve punë. Ajo po edukon djemtë e çupat, po i bën me shkollë, po u siguron të ardhmen. Partia, njerëzve të saj, edhe kur gabojnë, u jep dorën, i ndihmon për të mos rënë në gabim tjetër. Dhe i çon në mes të punëtorëve, që të edukohen, të bëhen të mirë si punëtorë e të mos shkasin prapë në dërrasë të kalbur. Po «zemërmirët» e kanë vështirë t'i shohin qartë këto gjëra. Atëherë duhet bërë që këta shokë të kuadrit t'i shohin qartë ato dhe të mos livadhisin dot me të tilla motivacione në librezat e punës.

«VAZHDO KËSHTU, SE KAZMA TË PRET...»

Para disa ditësh në një familje na qëlloi të dëgjonim një bisedë të tillë: Dy prindër të një fëmije ishin të shqetësuar. Atë ditë djali i tyre kishte çuar në shtëpi dëftesën e klasës së nëntë. Në dy lëndë kishte notën pesë, kurse në të tjerat teta, nënta e dhjeta. Të birin, që rrinte i strukur në cep të dhomës, nëna e shihte tërë nervozizëm:

— E, more ditëzi! — i tha. — E kupton që po vazhdove me këtë mesatare notash, punëtor ke për të përfunduar? I ziu ti, që ke për të pastruar rrugët e qytetit!..

— Vazhdo, vazhdo kështu ti, — i tha edhe i ati me po atë ton të nervozuar. — Hë, se kazma të pret...

— E di ç'ke ti, burrë? Lëre të bëjë ç'ti thotë koka. Vetë e ka fajin. Le të vuajë fatin tim, — tha gruaja. — Ah, të kisha shkollë, nuk rrija të laja fëmijët e botës në çerdhe, por zija edhe unë një punë të mirë, si shoqet...

E përshkruam këtë bisedë, natyrisht, jo për të thënë se prindët nuk duhet të interesohen për mbarëvajtjen në mësimet e fëmijëve të tyre. As për të ulur kërkesat e drejta që ka shkolla për rezultate të mira në mësimet, të cilat duhet të forcohen. Arsimi

kaq masiv, që te ne bëhet falas, synon të edukojë njerëzit me dije e kulturë të lartë, sepse vetëm kështu ata do të bëhen të vlefshëm për socializmin, i cili mund të ndërtohet vetëm me njerëz punëtorë e të ditur, të kulturuar. Dhe fakti që ne po e ndërtojmë me sukses socializmin tregon se në përgjithësi njerëzit tanë, në të katër anët e vendit, nuk po i shmangen asnjë lloj pune. Ky është rezultat i punës dhe i luftës që ka bërë Partia për të edukuar te njerëzit tanë dashurinë dhe respektin për çdo lloj pune. Është rezultat dhe i koncepteve të drejta që kanë në përgjithësi prindërit tanë për punën drejtpërdrejt në prodhim. Shembujt janë të panumërt: nga Hoxhara, nga Fierza e nga Ballshi, nga Metalurgjiku e fshatrat e vendit tonë ku punojnë mijëra të rinj e të reja. Pra dialogjet më të shumta në familjet tona midis prindërve e fëmijëve janë të tilla, entuziaste, që tregojnë për koncepte të shëndosha, revolucionare të tyre ndaj punës së nderuar të bujkut e punëtorit. Por fjalën e kemi gjetiu, dhe pikërisht te konceptet mikroborgjeze të disa prindërve, që përpiqen me këmbëngulje të fusin, si në rastin konkret, në shpirtin e fëmijës nënvleftësimit dhe përçmimit për punën drejtpërdrejt në prodhim, duke menduar se jeta sigurohet vetëm me punë «me kalem» e jo sidomos me krahët e me djersën e ballit, pranë punëtorit e fshatarit. Te ne është e nderuar çdo lloj pune. Megjithëse ai burri për të cilin treguam më lart është kuadër me shkollë të lartë dhe e mban veten për njeri politik, harron se në Kushtetutën tonë thuhet se puna, çdo lloj pune, është detyrë dhe çështje nderi. Ne nuk themi «kush nuk ka shkollë, nuk ha», por themi «kush nuk punon, nuk ha».

Por le të bëjmë një llogari fare të thjeshtë. Ç'do të ndodhte sikur të gjithë të mbylleshin nëpër zyrra në punë me kalem? Vallë mendojnë kështu këta prindër? Atëherë kush do ta mbillte grurin, kush do t'i ndërtonte hidrocentralet, kush do t'i endte stofërat, për të cilat ka nevojë socializmi, kanë nevojë çdo ditë dhe ata që kërkojnë punë në zyrë? Vetëkuptohet se të gjitha këto nuk duan të thonë aspak «s'na duhet shkolla». Përkundrazi, siç thamë, të mohosh shkollën është një koncept thellësisht reaksionar. Por këto shkolla janë hapur që nxënësit e studentët të edukohen pikërisht me ndjenjën e punës, që në bankat e shkollës të edukohen për t'u bërë punëtorë e njerëz të dashuruar pas punës. Pra, të edukohen për t'u bërë njerëz të punës e jo të tavolinës, të edukohen, të marrin kulturë revolucionare, e jo të bëhen mikroborgjezë e parazitë.

Po të shkoni në zyrat e punës të disa qyteteve do të shihni disa vjaza, djem e gra, që presin e presin me ditë të tëra se mos vallë shokëve të komitetit u mbushet mendja ndonjë ditë e u gjejnë ndonjë punë në zyrë, ose ndonjë vend për laborante. Me siguri që ka ndonjë që u thotë këtyre vajzave: «Ja, e shikon? Nuk ke shkollë dhe prandaj je pa punë, s'ha dot bukë». Kurse s'është aspak e vërtetë. Ato i lënë pa punë (sepse me bukë i mbajnë prindët), konceptet e tyre, të gabuara. «Si të shkojë vajza ime të punojë në fermë a në uzinë! — thonë disa prindër. — Ajo ka mbaruar gjimnazin», «Si të punoj unë në fermë! — thonë disa vajza të tjera. — Ne s'kemi qenë kurrë në fshat...» Shumë mirë, duhet t'u themi këtyre shoqeve: në qoftë se s'keni qenë deri tani, shkoni tani e tutje. Shumë mirë që vajza juaj ka mbaruar gjimnazin, duhet t'u themi, atyre prindër-

ve. Gjinnazi që ato kanë mbaruar do t'i ndihmojë që punën në uzinë, në fermë a në fabrikë ta bëjnë më të kualifikuar. Këtë e kërkojnë interesat e ndërtimit të socializmit. Edhe Partia prandaj ka hapur kaq shkolla e kurse kualifikimi, pikërisht për të krijuar njeriun e ri, me ndërgjegje proletare, por edhe të zotin në të gjitha degët e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës. Aq më mirë do të jetë kur tërë punëtorët tanë të jenë me shkollë të mesme, bile edhe me të lartë.

Dhe tani le të kthehemi përsëri e të shohim g'thamë në fillim të këtij shkrimi e t'i drejtohem atij prindit që mbahet si «njeri politik» se të jesh vërtet njeri politik do të thotë ta kuptosh tamam me këtë funksion shkollën që kërkon t'i japësh fëmijës. Edhe këmbëngulja për mesataren e lartë të notave duhet të jetë doemos e madhe, por jo për qëllimin mikroborgjez për të zënë një karrike nëpër zyra. Këmbëngulja për mesataren e lartë të notës të jetë që fëmija edhe nesër, si punëtor, të ketë një mesatare të lartë në sasinë e cilësinë e punës, edhe në atë të mbrojtjes. Pikërisht kjo është e duhet të jetë «buka» që duhet të japë shkolla. Dhe përderisa mendon se je njeri politik, atëherë lufta e klasave duhet kuptuar jo vetëm si një përleshje me armiqtë në front, por edhe me konceptet reaksionare që të mendojnë edhe ty vetë. Pra, nëse je njeri politik, revolucionar, edukoje djalin a vajzën tënde të shkojë në çdo front të punës, ku janë radhitur qindra e mijëra vajza e djem të tjerë të popullit. Atje ku të ketë nevojë atdheu — në veprat e pesëvjeçarit a në fshat, — puna e ndershme do t'i japë edhe respektin e njerëzve, edhe shkollën, edhe bukën. . .

ATA QË NUK PRONONCOHEN...

Nuk janë indiferentë vetëm ata që bëjnë një sy të verbër e që kthejnë kokën mënjanë kur një fëmijë thyen një degë peme në rrugë, as vetëm ata që bëjnë veshin e shurdhër kur dëgjojnë që në shkallën ku banojnë dikush grindet e i bërtet fqinjit të vet. Shfaqjet e indiferentizmit janë të shumëllojta. Ka disa nga njerëzit tanë, p.sh., që megjithëse e shohin dhe e dëgjojnë fare mirë një debat revolucionar (i cili bëhet për zbatimin e direktivave të Partisë, ligjeve të shtetit, zgjidhjen e problemeve të ndryshme) në një mbledhje të organizatës-bazë të Partisë, të kolektivit e të lagjes nuk hyjnë edhe ata në «vallen» ose siç thuhet, nuk prononcohen, por, si spektatorë, zakonisht, zënë cepat dhe fundin e sallës dhe presin sa të mbarojë «shfaqja» e të shohin punën e tyre.

Natyrisht, opinioni ynë i shëndoshë shoqëror nuk mund të lejojë që prononcimi në këto debate, në të cilat diskutohet për zbatimin e parimeve e të normave të Partisë ose të normave të moralit proletar, të jetë aq fakultativ. Është vetë jeta jonë revolucionare që e vërteton këtë çdo ditë, është realiteti ynë, që e shohim çdo ditë me sytë e ballit. Mjafton të hysh midis njerëzve tanë që të ndiesh e të emo-

cionohesh nga fryma luftarake, entuziazte e revolucionare e komunistëve dhe e masave tona punonjëse, nga fryma e shëndoshë e militantizmit të tyre të gjallë politik. Është e pamundur të shprehësh me disa radhë të vetme tërë atë frymë revolucionare të njerëzve tanë, është e pamundur të regjistrosësh në disa radhë tërë atë angazhim, preokupacion total të njerëzve tanë në aksionet masive politike e ideologjike që ka organizuar e udhëhequr Partia. Cilin të përmendësh më parë? Diskutimet masive për luftën kundër zakoneve prapanike e mbeturinave fetare dhe për të mbrojtur të drejtat e lirinë e grave, apo ato të luftës kundër shtrembërimeve burokratike? Ose le të kujtojmë atë patos të fuqishëm revolucionar, me të cilin u zhvilluan diskutimet masive për luftën kundër liberalizmit dhe ndikimeve të ideologjisë borgjeze e revizioniste apo diskutimi popullor për kursimet etj. etj.

Por Partia, njerëzit tanë, luftojnë që të ruajnë të pastra ndërgjegjen dhe figurën morale të çdo punonjësi, prandaj edhe me të drejtë të gjithë atyre që në të tilla raste hiqen mënjanë, u drejtohet pyetja: «Përse ju, shokë, nuk prononcoheni?» Përgjigjet janë të ndryshme. Ka disa që edhe në vetë këto përgjigje nuk prononcohen, heshtin. Disa thonë: «S'kishin gjë për të thënë, kurse disa të tjerë duan ta hedhin lumin me «humor» e «shakara»; «Aman edhe ti, gjete me cilin të merresh!... Ti e di që unë kësh-tu e kam tipin, karakterin, s'flas kurrë nëpër mble-dhje...». «Nuk ka vesh më të shurdhër se ai që nuk do të dëgjojë», thotë populli. Provo, po deshe, t'i shkelësh sado pak në kallo këta shokë dhe do të vësh re që menjëherë do ta ndryshojnë «tipin», dhe do të hidhën përtpjetë me nervozizëm e me lumë fjalësh.

Indiferentizmi nuk është thjesht çështje «tipi» e «karakterit». Shfaqjet e psikologjisë mikroborgjeze, ashtu si edhe elementet e tjera të edukimit komunist, janë çështje botëkuptimore. Nuk lind njeriu as revolucionar, as jorevolucionar. Ai bëhet, edukohet i tillë. Karakteri, na mëson Partia, është botëkuptim me përmbajtje të thellë klasore dhe ndryshon në luftë e sipër. Pra, që të zhdukim edhe këtë shfaqje të indiferentizmit, nëpër mbledhjet tona a në biseda të veçanta, duhet të goditim përditë e me forcë çdo nuancë, formë të shfaqjes së saj dhe sidomos të «mbyllim» burimet e shfaqjes së indiferentizmit në përgjithësi. Dhe cilat janë më konkretisht: disa nuk flasin, nuk prononcohen, sepse nuk janë revolucionarë, nuk çajnë kokën për interesin e përgjithshëm, për punën (kur diskutohet për të), as për shokun e shoqen (kur diskutohet për ta). «Ama s'diskutohem unë? — mendojnë ata. — Le të bëjnë ç'të duan, vetëm të mbarojnë një sahat e më parë e të ikim». Disa të tjerëve ua mbyllin gojën dembelizmi dhe paaftësia në punë, ose edhe qëndrimi jokorrekt moral a të komprometuarit. Nuk është rastësi që flasin e bëjnë autokritikë e kritikojnë më me kurajo pikërisht ata që janë më në rregull me punën e në nivel të lartë moral e politik. Sepse është vështirë të kritikosh tjetrin pa qenë vetë në rregull, se ai të ngrihet e t'i numëron një e nga një... Prandaj edhe ata që heshtin për arsye të tilla mendojnë: «Ç'më duhet t'i hap havaze vetes kur jam rehat? Pse të mprehem me tri qel...»

Por nuk janë vetëm të çrregulltit ata që heshtin. Ka edhe që punojnë mirë, janë të papërtuar por... të patrazuar në mbledhje. Duke mos njohur sa duhet vijën, normat e Partisë, ligjet e shtetit, duke mos

qenë plotësisht të formuar, disa kanë frikë mos gabojnë dhe: «pse, xhanëm, jam mirë e bukur... po sikur të gaboj?» Njerëz të tillë të frikshëm harrojnë se vetëm të vdekurit nuk gabojnë. Thuaje mendimin tënd! Po gabove, shokët e shoqet aty janë dhe le të të korrigojnë. Kështu është akoma më mirë, sepse këtë gabim nuk do ta përsëritësh.

Po tjetër, kush nuk pranohet nëpër diskutime? Ata që duan ta kenë mirë me të gjithë, lajkaxhinjtë. Po jashtë, në rrugë e në kafe? Jashtë ata janë nga më aktivët, më llafazanët. Të fusin nën gjuhë dhe përmbi gjuhë. Kur janë me ty, mua më bëjnë për një lek, kur janë me mua, unë kam të drejtë, kurse ti je më i ligu; kurse në mbledhje u ikën goja, bëhen të tjerë njerëz, tulaten në ndonjë qoshe. «Bobo, ku shkuan gjithë ato fjalë» mendon ti. Por edhe ata, megjithëse heshtin kokulur, atje, në fund të sallës, bisedojnë me veten: «Ç'më duhet të ngatërrohem? Pse të prish qejf? Pse të bëj armiq? Le të grinden! Nesër, pasnesër, mundet të diskutohem unë për ndonjë problem dhe... i thonë një zë kundër». Për disa të tillë, njerëzit nuk janë njerëz, por vota, duar të ngritura, pro a kundër. Prandaj qepin buzët. Por edhe në rastet kur i detyrojnë të flasin e të prononcohen, në të dy anët e kandarit, ata hedhin sasi e cilësi të njëjta fjalësh: «Edhe shoku... ka të drejtë, por edhe shoku... ka edhe ai të drejtë. Fundja nga qëllimi i mirë është nisur...». Por ka edhe disa të tjerë që nuk flasin nga frika e hakmarrjes, sepse kanë parë që dikush vërtet e ka pësuar. Mungesa e autokritikës së sinqertë të disa kuadrove drejtuese, na mëson Partia; nuk nxit shkëmbimin e lirë të mendimeve. Këtu nuk është fjala për të thënë formalisht e sa për të qenë brënda:

«Flisni, shokë! Na kritikoni pa ndrojtje!» Duhet krijuar kurdoherë një atmosferë e ngrohtë e shoqërore, e çiltër, e hapur, pa gjuhë «diplomati», pa paramendime, pa zyrtarizëm e etiketë false, sepse diskutohet, jo për interesin e ngushtë vetjak, të njërit a të tjetrit, por për punën e Partisë e të pushtetit, për problemet ekonomike, politike, shoqërore, për zhvillimin e kulturës e për forcimin e mbrojtjes.

Kongresi i 7-të i Partisë shtroi detyra të rëndësishme për zhvillimin gjithnjë e më me forcë të luftës kundër mbeturinave e ndikimeve të ideologjive të huaja. Po kështu edhe kundër shfaqjeve të indiferentizmit në veçanti: «Lufta kundër shfaqjeve të indiferentizmit mbetet një detyrë aktuale e Partisë dhe e levave të saj»¹). Dhe që të vazhdohet më me forcë kjo luftë, ne duhet ta goditim indiferentizmin në rrënjët e tij, në burimet. Psikologjia mikroborgjeze ka rrënjë të thella në ndërgjegjen e njerëzve. Në të kaluarën në vendin tonë ka mbizotëruar prona e vogël private. Mbi këtë bazë ngriheshin të gjitha llojet e marrëdhënieve midis njerëzve, formoheshin pikëpamjet e tyre. Tani vërtet prona private është zhdukur, por mbeturinat e saj rëndojnë ende mbi ndërgjegjen e mjaft prej njerëzve tanë. Burim tjetër për mbajtjen gjallë të psikologjisë mikroborgjeze, e të indiferentizmit në veçanti është edhe veprimtaria e armikut të klasës brenda vendit dhe armiqtë të jashtëm. «...elementin mikroborgjez brenda shtetit e përkrah gjithë borgjezia ndërkombëtare»²), thekson-te Lenini. Prandaj, detyrat e organizatave-bazë të Partisë, të organizatave të masave, e çdo punonjësi,

1) Enver Hoxha. «Raport në Kongresin VII PPSH», fq. 142.

2) V. I. Lenin. vëll. 33, fq. 4.

dhe sidomos e çdo komunisti është që, duke luftuar çdo ditë e çdo çast kundër shfaqjeve të indiferentizmit tek vetja, të ngremë zërin fort e me kurajo revolucionare edhe kundër shfaqjeve të tilla që vërehen tek të tjerët. Kjo luftë të bëhet jo në mënyrë globale, por konkrete dhe tek çdo njeri. Me dashuri, me frymë të ngrohtë Partie, por edhe në forma të menduara e të shkathëta pune t'i bindim disa nga shoqet e shokët tanë të prononcohen në diskutimet e në debatet e gjalla e luftarake për hir të punës së Partisë. Dhe kur ata ngurrojnë përsëri e vazhdojnë të heshtin nëpër skajet e sallës, mund të parashikojmë që në ndonjë nga mbledhjet tona të diskutojmë posaçërisht për qëndrimin e atyre që në mbledhje heshtin e nuk prononcohen.

KUR LË NJË PUNË DHE ZË NJË TJETËR...

Po arrijmë suksese kudo dhe njëkohësisht. Kjo do të thotë se po zgjidhim shumë probleme dhe njëkohësisht. Këtë na e imponon koha, ritmet e vrullshme të shoqërisë sonë. Qëllimi ynë i lartë, aftësia e madhe drejtuese dhe organizuese e Partisë, forca e pushtetit popullor, gatishmëria e masave po i sigurojnë këto ngjitje të reja. E megjithatë ka njerëz që çorientohen në morinë e këtyre problemeve. Kjo ndodh dhe atje ku mungojnë qartësia ideopolitike dhe aftësitë e nevojshme. Ndodh që disa drejtues të përpëlitën ende nën presionin e psikologjisë mikroborgjeze. Mikroborgjezi ka një karakteristikë që e dallon nga të tjerët. Gjatë çdo pune atë e shoqëron një lejtmotiv: «Mirë, po punoj. Po del gjë për mua nga kjo?!» Dhe fillon t'i bjerë lapsit. E, po që se sigurohet që edhe pa atë punë që ka në dorë mund të vazhdojë të hajë, të pijë dhe të firmosë në bordero në krye të 15-ditëshit, ai e lë menjëherë. Atë nuk e vënë në lëvizje motive politike, qytetare, të përgjithshme, por motive të vogla, personale. Ndosh-ta kjo është edhe një nga arsytet që siç tha shoku Enver në Plenumin e 4-t të Partisë, ta bëjnë mikroborgjezin të priret të lërë një problem, të zërë një tjetër, të kapë njërën anë e të lërë pas dore tjetrën.

Pse ndodh që mjaft vendime e detyra zënë njëra-tjetrën pa u zgjidhur? Ka drejtues që merren me këto vendime e detyra për sa kohë shohin ndonjë leverdi personale a dikasteriale, për sa kohë janë nën tensionin e ndonjë kontrolli ose vëzhgimi. Sapo çlirohen nga ky kontroll, ata e lënë mënjanë. Edhe me problemin tjetër, po kaq kohë merren.

Në bujqësi të qëllon të merresh me shumë punë njëkohësisht, në çdo stinë. Dhe po nuk i zgjidhe plotësisht në kohë dhe të gjitha, ato, jo vetëm të mbeten pa bërë, po të vënë në dyshim edhe zgjidhjen e të tjerave, në stinën tjetër. Ka disa kooperativa bujqësore që tokat e reja i hapin vonë. Ata kanë shumë punë të tjera në prashitje, në rrallime. Të tëra kërkohen. Atëherë lënë një punë, zënë një tjetër. Kështu edhe tokat e reja hapen me cilësi jo të mirë, edhe prashitjet dhe rrallimet nuk bëhen siç duhet. Po nuk ndodh kështu në kooperativa të tjera, ku bëhen përpjekje për të drejtuar shkencërisht. Këtu nuk e zë njëri problem tjetrin. Tokat e reja realizohen në afat. Edhe drithërat e bukës dhe bimët industriale po ashtu. Dhe rezultati? Aty rritet vazhdimisht prodhimi.

Sado të vështira e të shumta qofshin problemet, ato zgjidhen. Por vetëm duhet të kesh një kuptim të qartë për to. Të të mbushet mendja se po nuk e zgjidhe vetë, ai ka për të mbetur pa zgjidhur. Të krijosh bindjen se zgjidhja e tij është e domosdoshme për shoqërinë. Duhet ngritur ndërgjegjja në një shkallë të tillë që të mos kesh nevojë për hosten të herëpashershëm. U tha një herë, për shembull, se duhet të ngrihet vazhdimisht shkalla e mekanizimeve dhe ka mjaft ndër marrje që nuk e kanë harruar këtë. Në një të tillë kanë dalë edhe probleme të tje-

ra: normimi teknik, realizimi i asortimenteve, disiplina në punë. Por as drejtuesit, as byroja teknologjike, as punëtorët e kësaj ndërmarrjeje nuk thanë: «More e lëmë një herë për një herë këtë mekanizimin. Tani sikur po rreh më tepër çekani për asortimentin. Më tutje shohim e bëjmë». Jo. Ata njëkohësisht çuan gjer në fund problemin e mekanizimeve, por edhe me normimin teknik u morën. Bile nuk e lanë punën gjer te materialet kryesore, por vazhduan ta bëjnë edhe te ato ndihmëse. Ndryshe ndodh në ndonjë ndërmarrje tjetër. Ka nga ato që thonë, p.sh. do të ndërtojmë baterinë e presave. E zënë, e lënë. E së fundi e justifikojnë se po merren me detyra të tjera.

Shfaqje të tilla të psikologjisë mikroborgjeze vëren jo vetëm në fushën e prodhimit, por edhe në probleme të tjera të disa kolektivave.

Kushedi sa herë e kanë analizuar në disa kolektiva problemin e arsimimit. Regjistrohën në fillim të vitit disa në shkollë. Thua ti, u zgjidh dhe ky problem. Por vazhdojnë një muaj, dy... dhe bankat boshatisen. Ky avaz përsëritet çdo vit. Pse nuk çohet gjer në fund ky problem? Por të shfaqet justifikimi i rëndomtë. «Kemi pasur shumë punë të tjera». Ç'do të thotë kjo? Do të thotë të ligjërosh idenë se, po doli një punë tjetër, duhet ta lëshë përgjysmë të parën. Dhe e dini pse arsyetojnë kështu? Ata quajnë problem të rëndësishëm atë, për të cilin sapo u ka ardhur një shkresë ose udhëzim, për të cilin sapo u është ushtruar kontrolli, për të cilin u kërkohet llogari në atë kohë. Ato që janë analizuar, qoftë edhe një muaj më parë, ata i quajnë pa rëndësi, i harrojnë... Kontrollin për zbatimin e një vendimi atyre nuk ua bën ndërgjegjja e vet, por ndërhyrja e jashtme, e të tjerëve. Dhe kjo

natyrisht ndodh se detyrën ata e shohin jo si dobiprurëse për shoqërinë, por për veten.

Po qe se në këto kolektiva arsimimin do ta shihnin thellë, si nevojë, si të domosdoshme, si problem që do të ndihmonte ngritjen e tyre e rrjedhimisht në mbarëvajtjen e të gjitha punëve, ata do ta përfundonin shkollën. Para disa vjetësh mbi 90 përqind e komunistëve të një kooperative kishin mbebur me arsim fillor. Ata e shtruan këtë problem një herë në organizatë, vendosën dhe filluan menjëherë nga shkolla, të gjithë. Çdo stinë për ta sillte pengesa, vështirësi, probleme të reja. Edhe preokupime familjare, si të gjithë, kishin. Po nuk hoqën dorë nga shkolla pse zunë të merreshin edhe me problemet e tjera. Shkolla ka vendin e saj, — thanë, — punët e bujqësisë të tyre. Po të dish ta organizosh kohën, ajo bëhet më e madhe nga ç'të duket. Dhe në fund komunistët e asaj organizate mbaruan pothuaj 100 përqind arsimin e mesëm.

Kjo organizatë Partie këtë detyrë nuk e kreu në kurriz të të tjerave. Në prodhimin bujqësor ajo pati ritmikë, veprimtarinë e organizatave të masave e ndoqi mirë, objektet social-kulturore i ndërtoi. Ata e ndërjuan të re edhe shkollën, edhe shtëpinë e kulturës, edhe ujin e pijshëm e sollën në fshat, edhe...

Le të marrim tani një fakt të thjeshtë. Në disa qytete çelen pothuaj çdo vit kurse për mësimin e gjuhëve të huaja. Dhe qëllimi i tyre është që punëtorët, intelektualët, të gjithë, gjuhën e huaj ta vënë në funksion të ngritjes së tyre ideore e profesionale. Dhe në fillim regjistrohen plot. Duken të gjithë të zellshëm. Mirëpo, në disa raste pas çdo mësimi, «avullohen» nga 4 e nga 5, gjersa katandiset kokoshi një thelë... Kursi mbyllet. Vitin tjetër disa pendo-

hen dhe e fillojnë përsëri. Disa të tjerë e «shohin të arsyeshme» të lënë frëngjishten e të zënë anglishten, të lënë anglishten e të zënë italishten. Por përsëri e njëjta histori. Përsëri asgjë në torbë. Pse ndodh kështu? Ndodh se njerëzit nuk nisen nga motive të shëndosha kur fillojnë gjuhën, nuk nisen nga qëllimi për ta vënë në radhë të parë në shërbim të punës, të shoqërisë. Por nga motive thjesht personale. Ja një shembull: Një herë në një institucion tri vjet me radhë u paguan instruktorët për mësimin e gjuhëve të huaja. Në krye të vitit shfaqeshin dhjetëra, në fund të vitit mbeteshin 4-5. Por së fundi ndodhi një «çudi». Kurset vijuan më mirë. Pse? Instruktorët nuk u paguan më nga shteti po nga të interesuarit. U dhembti xhepi njerëzve dhe iu shtruan punës. Pse, të tepërta i kishin ata paratë, që t'i llinin t'u iknin kot? Pse, vallë, ata nuk e bënë këtë arsyetim edhe kur lekët ua paguante shteti? Pse nuk thanë «Të tepërta i ka lekët shteti që t'i lëmë të derdhen kot?»(!)

«C'JANË KËTO FJALË QË DALIN NGA FSHATI?..»

Para ca kohësh në dyert e një komiteti të Partisë trokiti një grua e shqetësuar e me lot në sy: «Amani, shokë të Partisë, — tha — më bëni derman, se jam nënë me dy fëmijë. Kanë dalë fjalë në fshat sikur unë jam grua e keqe. Shpifi njëri dhe mua më ndau burri. Ju lutem, o shokë...».

«C'janë këto fjalë që dalin nga fshati?! — thanë të habitur e të revoltuar banorët e fshatit. — Kush i thotë këto fjalë, që iu thaftë gjuha! Ne e njohim këtë grua. Ajo s'është e tillë...».

Dhe vërtet, kështu është. Po shpifësi prandaj e ka këtë emër — nepërkë, prandaj është i tillë, që të prishë gëzimin e njerëzve. Kënaqësinë shpifësit e ndiejnë pikërisht kur marrin të tjerët nëpër gojë, mbarë e mbrapsht, u vënë bishta, u vënë brirë. Po kush merret me këtë «zanat» kaq të fëlliqur? Në radhë të parë ata që nuk janë të ngritur politikisht e ideologjikisht, ata që bëjnë një jetë të zbrazët, pa interesa e ideale të mëdha, që nuk rrojnë e nuk luftojnë si duhet, bashkë, me idetë e reja që zhvillojnë Partia dhe masat.

Fshatari që shpifi në këtë rast është dënuar tri herë për vjedhje dhe shpifja për një vjedhës nuk

është diçka e jashtëzakonshme. Një njeri që e ka të lehtë të vërë dorë mbi pronën, ekonominë e shoqërisë, patjetër që do ta ketë të lehtë të vërë dorë edhe në botën shpirtërore të shoqërisë sonë, për t'i shqetësuar moralisht edhe në gjërat më intime njerëzit tanë. Prandaj me drejtësi, rreptësi e pa asnjë hezitim duhet të ngrihemi të gjithë në këmbë kundër të gjithë këtyre njerëzve, që jetojnë duke u zvarrisur. Të mos i lëmë për asnjë çast të na prekin me gjuhët e tyre të helmatisura. Sepse ata, duke u prishur të tjerëve harmoninë, gëzimin, prishin unitetin e njerëzve tanë, që rrojnë me nder e me djersë të ballit, që punojnë e lodhen për të ndërtuar e gëzuar socializmin bashkë me shokët, vëllezërit e fëmijët e tyre.

Shpifja është nga metodat më të ndyra të mikroborgjezit, është nga armët më të preferuara që mban në sup armiku i klasës për të vënë në shenjë e për të rrëzuar njerëzit tanë, për të vënë në shenjë unitetin tonë monolit. Prandaj lufta kundër shpifjeve dhe shpifësve është luftë klasash, të cilën kushdo duhet ta zhvillojë posa e vë re, me guxim dhe pa asnjë kompromis. Këtë ves të keq duhet ta zhdukim që në embrion, që atëherë kur del shpifja që disa e quajnë «supozim», «fjalë të dëgjuar», e që e shoqërojnë me fjalët «po të më kenë gënjyer, edhe unë të gënjej». Kështu veprojnë disa mendjelehtë, pa e vrarë pak trurin se ky «supozim» «kjo fjalë e dëgjuar» ose gënjeshtër e dikujt, mund të bëhet burim fatkeqësie për dikë tjetër, që e vuan mbi kurriz. Prandaj duhet ta kuptojmë mirë të gjithë rrezikshmërinë politike, ideologjike e shoqërore të shpifjeve e të thashethemeve, duke i luftuar ato me ashpërsi. Të mprehim vigjilencën klasore revolucionare dhe

t'i luftojmë këto vese tek cilido, posa shfaqen. Sepse infektojnë, sëmurin edhe të tjerët. Shoku që i dëgjoji i pari ato fjalë shpifëse në vend që t'ia vinte dorën te goja shpifësit e t'i thoshte «shët», dhe pastaj t'i tregonte vendin, bën të kundërtën. Të gjitha ato që dëgjoji shkoi dhe ia zbrazi burrit të asaj gruas për të cilën shpifej! Njerëz të tillë pandehin se në këto raste kryejnë «detyrë shoqërore», se i «bëjnë mirë tjetrit», se «i hapim sytë të shohë të vërtetën» pa ç'ka se vetë ata këtë «të vërtetë» nuk e kanë parë kurrë. Dhe s'kanë si ta kenë parë kur ajo është vetëm pjellë e trurit dhe e ndërgjegjes së sëmurë të disa llafazanëve. Prandaj është detyrë e të gjithëve që, siç thotë shoku Enver: «Nga pozita të shëndosha partie duhet t'u hapim breshëri zjarri të gjitha këtyre të këqijave, që dëmtojnë shoqërinë tonë, që hidhërojnë jetën e lumtur e të gëzuar të të rejave dhe të të rinjve tanë. Të mos i lëmë barërat e këqija të hedhin shtat, po t'i shkulum nga rrënjët»¹). Me shumë të drejtë kolektivi i brigadës ku punonte shpifësi e dënoi veprimin e këtij njeriu të molepsur, i cili iu dha gjyqit të popullit.

1) Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1969-1970, f. 148.

**«S'KE TI PUNË ME NE, POR KEMI NE, SHOQËRIA,
PUNË ME TY, SEPSE JE I PASJELLSHËM. . .»**

Para disa kohësh udhëtonim me autobuzin Bankë-Kombinat në Tiranë. Autobuzi qëndroi në një stacion dhe gra, burra, pleq e të rinj zunë të zbresin kur, papritur, përballë tyre u vërsul fluturimthi një djalë 16-17 vjeç.

— Uh! Po na dërrmove, mor bir, — tha një plakë. — Prit, të zbresim ne njëherë.

Por duke shtytur me bërryla e me kokë, ai hipi në autobuz dhe, pasi çau me këtë «metodë» grumbullin që ishte brenda, u ul shpejt në njërin prej sediljeve.

Autobuzi u mbush plot dhe u nis. Ne vumë re se pranë sediljes së atij djali që hipi si i «çmendur», rrinin në këmbë disa plaka e gra. Njëra prej grave mbante për dore një fëmijë të vogël.

— Djalë, — i tha një grua atij që rrinte në sedilje, — ngreu, të keqen nëna, liroja vendin kësaj plakës. Hajde, ngreu!

Djali i hodhi gruas një vështrim ironik:

— T'i s'më urdhëron dot mua, se as të njoh nga bie. Po të dua, ngrihem, po të mos dua, jo.

Skena na indinjoi të gjithëve sa ishim aty rrotull.

— Hajd, lëri fjalët dhe çohu shpejt, — tha njëri prej atyre që ishin aty dhe, duke mos e përmbajtur dot nervozizmin, e zuri nga supi.

Djali u nxeh dhe ia hoqi dorën nga supi.

— Po t'i, ç'do? — i tha, — S'ka njeri punë me ty!...

— S'ke ti punë me ne, por kemi ne, shoqëria punë me ty, sepse je i pasjellshëm, — i tha qytetari dhe e ngriti gati me forcë.

Djali donte të kundërshtonte, por ndërroi 180 gradë, u bë «qengj» dhe e liroi menjëherë vendin, kur pa katër-pesë veta që iu afruan të indinjuar...

Natyrisht, skena të tilla ndodhin rrallë, por veç jo gjithmonë ne u bëhemi barrikadë këtyre akteve prej rrugaçësh. Është detyrë e të gjithëve e prindërve, e shkollës, e qendrës së punës, e banorëve të lagjes. E kemi detyrë të gjithë që kur e shohim një njeri të tillë duke shtytur njerëzit në autobuz, në radhën e biletave të kinemasë, të sportit e gjetkë, ta heqim mënjanë e ta këshillojmë. Veç po s'u bindën, forca e opinionit shoqëror duhet t'i detyrojë. «Po hyri në autobuz, — thonë, për një të ri, — hapi rrugën, se të dërrmon brinjët duke shtypur e duke u grindur me njerëzit». Nuk guxon grua a vajzë të hyjë në makinën e asaj linje, sepse ky i ri zë e flet ç't'i nxërë goja, e bën ç't'i teket. Ngacmo një, grindu me një tjetër. Me portierin e kinemasë u zu keq. Po me këtë gjuhë të flasin edhe për disa të rinj të tjerë. Njëri prej tyre ka ndërruar disa ndërmarrje për punë e nuk zë gjëkund vend. Ta shohësh, të thonë, s'të jep përshtypje të keqe, sepse vi-shet e ngjishet mirë, por... «i vjen doresh» t'i qëllojë njerëzit me vezë të prishura, të rrijë në orët e vona strehëve të godinave e t'u prishë qetësinë

qytetarëve me fishkëllima e britma, ose të shtypet nëpër autobuzë, qoftë për «gallatë», qoftë për të krijuar kushte të fusë dorën e tij në xhepin e ndonjë qytetari....

Të gjithë duhet të ngrihemi në këmbë t'i izolojmë njerëz të tillë, që bëjnë akte të padenja në shoqëri e jo të rrimë sehirxhinj ose, më keq, siç ndodh me ndonjë që kur dikush ndërhyr, si «më i pjekur», hidhet e thotë: «E mo, lëre, ç'ke me të? Me kalamanj do të merresh tani ti, alamet burri!». Indiferentizmi i ushqen akte të tilla të padenja për shoqërinë tonë. Lufta kundër tyre nuk është detyrë vetëm e punonjësit të policisë, por e të gjithëve. Gjithë opinioni ynë i shëndoshë shoqëror, sidomos organizatat-bazë të BRPSH-së, e veçanërisht kur është fjala për të rinj, duhet të ngrihen në këmbë e t'u krijojnë ambient mbytës shfaqjeve të tilla, që cenojnë normat e moralit tonë proletar.

NJË MASË E GABUAR NË EMËR TË VIJËS SË MASAVE

Tre kooperativistë të një brigade, kërkuan, «në emër të brigadës», një mbledhje të jashtëzakonshme. Dhe u bë mbledhja. (Megjithëse gjysma e anëtarëve mungonte). Po pse, vallë? Pse, e pakët qe?(!)

— Brigadieri ynë na e ka sjellë në majë të hundës.

— Brigadieri kërkon llogari shumë.

— Ne nuk jemi nga ata që i hamë hakun tjetrit. Vërtet brigadieri s'ia përton kurrë punës, natën-natën, ditën-ditën, por ai nuk ka besim te ne. Bile vjen e na kontrollon në punë edhe natën...

— S'e mohojmë dot, brigadieri nuk mban hatëre (atë që e ka, e ka) por ai... qesh rrallë fare.

Prandaj:

— Ta shkarkojmë. Kush është dakord?

— Dakord!

— Tridhjetë duar u ngritën menjëherë përpjetë dhe brigadieri u shkarkua. Po shokët drejtues të sektorit ç'bënë pasi soditën me vëmendje skenat e kësaj shfaqjeje? Siç na thanë nuk ishin dakord me mendimin e kooperativistëve, dhe e quajtën të gabuar. Sepse brigadieri ishte vërtet njeri pozitiv, i palodhur, me rezultate të mira në punë, i paanshëm. Por ata s'kishin si të bënin ndryshe, sepse kjo kishte

qenë dëshira e masës «vija e masës». Dhe ata s'kishin si të delnin kundër «vijës» së masës. Ata patën frikë se, duke dalë kundër mendimit të lirë të masës mos i quanin njerëz të tutelës, regresivë, konservatorë.

Por cilët ishin konservatorët dhe liberalët e vërtetë? Ca hollësi rreth iniciatorëve të duarve të ngritura në mbledhje kundër brigadierit ndoshta mund të ndihmojnë për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje.

Kooperativisti X, që ndër provokuesit e parë të mbledhjes dhe ai që u vërsul i pari kundër brigadierit me kritikën «më të forta». Pse?

— Unë jam përgjegjës skuadre, — tha ai në mbledhje. — Po ti nuk ke besim tek unë. Vjen e më kontrollon natën.

Po si të kishte besim tek përgjegjësi i skuadrës brigadierit, kur një natë e gjeti duke fjetur bashkë me shokun e tij ndërsa uji që duhej të vadiste mirin derdhej kot? Por ai, atë natë, në vend që të bënte autokritikë, ishte zemëruar që brigadierit s'pati besim dhe erdhi e kontrolloi. Përgjegjësi i skuadrës iu vërsul në mbledhje brigadierit edhe sepse ai nuk ia kish miratuar mendimin prapanik për ta ulur normën e punimit me bel nga 250 metra në 150, sa ç'dëshironte.

— Ti s'na jep ditë-punë shumë, — e akuzoi Y brigadierin në mbledhje, — prandaj nuk të duam brigadier.

Po si t'ia jepte ditën brigadierit? I tha Y-it të shkonte në mal e të priste dru me shokët. Bashkë me shokët që flinin atje, me net të tëra, në të ftohtë, në shi. Por ai ndenji dy ditë dhe krisi e iku. S'duroi dot. Dhe pastaj i erdhi hidhur që e kritikoi brigadierit. Prandaj edhe u hakmor në mbledhje.

Brigadierin e akuzoi si «të ashpër» në mbledhje edhe një kooperativiste.

— Nuk të duam brigadier ty — i tha, — sepse nuk na trajton mirë.

Por çfarë quante trajtim të mirë ajo? Ishte zënë një herë me brigadierin, sepse ai e hoqi nga një front pune më i lehtë dhe e çoi të mblidhte duhan bashkë me shoqet. E çoi atje sepse nuk e kreu punën mirë. Mirëpo ajo iu vërsul brigadierit në mbledhje, sepse ai e kishte kritikuar dy herë kur në punën për manipulimin e duhanit me mënyrën «jarmapastall» ajo ua shënonte ditën kot disa grave. Brigadierit iu vërsulën në mbledhje edhe disa të rinj. Pse? Sepse ai nuk ua mori në dorëzim një ditë normën në prashitjen e duhanit. E si t'ua shënonte ditën brigadieri kur ata kishin punuar shkel e shko? Ata u revoltuan që ua ktheu dhe... ia gjetën ditën në mbledhje:

«Ta heqim».

Kush u ngrit tjetër kundër brigadierit? Kooperativisti Z.

— Sa për llogari e mbajtje drejtimi s'ka shok ky brigadieri ynë, — tha ai, — por sa për atë që thotë se duhet të lërojmë me qe një dynym e gjysmë, sa ç'është norma, e ka gabim. Sepse qetë nuk venë dot aq. Norma të jetë sa të venë qetë. Dhe qeve ua di unë më mirë, jo ai.

Por si t'i bënte një dynym e gjysmë Z. kur e fillonte punën në orën tetë? Disa herë ishte grindur me brigadierin, sepse e kishte kritikuar për vonesë dhe Z. priti ditën e mbledhjes dhe si shokët përsëriti refrenin hakmarrës: «Ta heqim!»

Nga të tilla «padrejtësi» u frymëzuan ata që ngritën duart kundër këtij brigadieri. Ata harruan

se qe meritë e madhe edhe e brigadierit kërkues që brigada e dytë e tyre, pati rezultate më të mira se të tjerat. Ndërsa ata, duke menduar si egoistë, kërkonin të rrëmbenin sa më shumë ditë-punë, brigadieri mendonte më thellë. Mendonte të merrnin prodhime dhe jo t'u regjistroheshin ditë-punë formale. Sepse e dinte që njerëzit ushqehen me grurë e misër e jo me ditë-punë.

Ata kërkonin që kur brigadieri t'i gjente duke u sorollatur të mos i kritikonte, por të qeshte. Dhe buzëqeshja që ata kërkonin t'u lëshonte brigadieri të kishte afërsisht kuptimin e fjalëve: «Bëni pallë, vëllezër. Mos punoni. Pa ditën jua shënojnë!» Por brigadieri dhe jo vetëm brigadieri, por asnjëri s'mund të buzëqeshë kur të sheh tek ngrohesh në diell e punët presin. Se ç'mund të bëhet pa punuar? Kemi kaq vjet që po provojmë se nga qielli s'ka rënë ndonjëherë ndonjë thes me grurë, ose ndonjë «Skodë» me pambuk. Nga qielli kemi parë të na bjerë vetëm shi e borë. Bile shumë herë edhe kur këto nuk na duhen...

Ka një ligj themelor socializmi: «Kush punon, ha». Kjo do të thotë që kur punojmë duhet ta kërkojmë bukën aq sa na peshon djersa. Dhe ne kërkojmë gjithmonë bukën e djersës sonë. Sepse na takon. Por ky ligj i socializmit do të thotë njëkohësisht edhe «kush nuk punon, nuk ha». Por ç'kërkonin ditë-punë nga brigadieri ata shokët e brigadës kur normën nuk e realizonin, kur në punë vinin me vonesë, kur prashitjen ose mbjelljen e bënin me cilësi të keqe? A nuk do të thotë kjo t'i marrësh shoqërisë e të mos i japësh? A nuk do të thotë kjo të hash djersën e dikujt tjetër? Po sikur të mendojnë të gjithë kështu? Atëherë del që të gjithë të mos punojnë

e të gjithë të kërkojnë. Por ç'të hanë kur nuk punojnë? Socializmi është llogari e kontroll.

Duket ca absurde, por logjika e njerëzve parazitë e dembelë vetëm këtu të çon. A e kuptojnë shokët e asaj brigade se ç'do të thotë të këmbëngulësh që brigadierit të jetë oportunist, liberal? Kjo do të thotë të reduktohet në minimum roli i tij. Domethënë që ai të mos ekzistojë fare. «Por le të mos ketë — mund të thotë dikush. — Është gjë shumë e mirë. Bile ku ta gjejmë që të ketë sa më pak brigadierë! Duhet t'u shtrëngojmë dorën atyre që, megjithëse janë brigadierë, punojnë aq sa edhe kooperativistët. Ku ta gjejmë të ketë sa më pak njerëz që drejtojnë!».

Por këta shokë të padisiplinuar, edhe me brigadier mbi kokë shullëhen në diell e jo më pa brigadier.

Dhe tani le të gjykojmë: cilët janë me të vërtetë me të renë, me të përparuarën, me të ardhmen, dhe cilët me të vjetrën, me të prapambeturën? Brigadierit që natën-natën, ditën-ditën, lodhej e kërkonte llogari që prodhimi të rritej, apo shokët që donin edhe të prashisnin keq, dhe të flinin gjatë punës, edhe ditën ta merrnin? Kush ishte konservator? Brigadierit, i cili përpiquej që të ardhurat e ekonomisë të rriteshin, apo ata që kërkonin t'i merrnin ekonominë edhe atë që s'u takonte? Konservatorë ishin ata. Ndaj edhe drejtuesit e kooperativës duhej të ishin përkrahës të brigadierit, jo të atyre. Vijë masash nuk është ajo që drejtuesit mendonin se përfaqësohej nga disa me shfaqje liberale, pavarësisht nga numri, por ajo që përfaqësohte brigadierit i përparuar. Vijë masash është ajo që përfaqësohet nga mendimi më i përparuar i masës.

FRONT UNIK KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA

Organizata e rinisë e një ofiçine njoftoi për një mbledhje urgjente. Një i ri i organizatës vazhdonte të paraqitej në mënyrë të pahijshme në veshje e në sjellje, në një kohë kur jashtë, në stendat e fletërrufeve, rrinte e varur edhe një përgjigje «autokritike» e tij për kritikën që i ishte bërë.

Të rinjtë tanë fyhen kur dikush kërkon të shkele normat e moralit komunist, kur dikush përpiqet t'u imponojë jetën e zbrazët, të vogël e pa ideale, prandaj edhe në mbledhje janë të ashpër. Të bukuren të rinjtë tanë nuk e shohin, e nuk duhet ta shohin, as në flokët e gjatë, as në sjelljet prej rrugaçi, por në punën në dobi të socializmit, në angazhimin për problemet e mëdha që shqetësojnë popullin e Partinë, në shpirtin fisnik proletar, në botën e gjerë shpirtërore e me ideale të mëdha. Shko ku të duash në vendin tonë ku punojnë të rinjtë e të rejtat, — në aksione, në fabrika, në fshatra, dhe do të vëshre se të bukurën të rinjtë tanë e shohin në angazhimin e tyre për zgjidhjen e problemeve të mëdha të prodhimit, në mendimin shkencor, në ruajtjen dhe në administrimin sa më mirë të pronës, në njohjen dhe në zbatimin me rigorozitet të ligjeve të shtetit e të diktaturës së proletariatit. Letra që shoku

Enver u dërgoi kooperativisteve të dalluara të Këmishtajt ka ngjallur kudo një frymë të shëndoshë ballafaqimi për t'i bërë flamur të përparuarit e për të ecur gjithmonë përpara edhe në fushën e edukimit të të rinjve me normat e moralit proletar. Rinia është angazhuar tërësisht në këtë luftë frontale kundër shfaqjeve të huaja. Çdo problem zgjidhet me sukses në qoftë se shokët e shoqet «fyhen» kur shohin ndonjë të bëjë «ç'i teket», në qoftë se organizata e rinisë bëhet bllok e u krijon atyre ambient mbytës.

Për një të ri në fillim thoshin «s'ke ç'i bën, kush merret me të» ...Edhe kohët e fundit ai braktisi punën për gjashtë ditë me radhë dhe kërkonte të ndërronte profesion, sepse ai i tornitorit i dukej i rëndë. «S'kemi ç'i bëjmë», thanë prapë disa. Mirëpo faktet e fundit treguan se atij jo vetëm kishe ç't'i bëje, por edhe iu bë. Kur iu mbloodhën shokët e shoqet dhe e vunë para përgjegjësisë për të tëra, ai bëri autokritikë dhe tani ecën mbarë. Çdo i ri, në radhë të parë vetë, pa e shtytur kush, duhet ta kapë nga krahu e t'i heqë veshin shokut ose shoqes së vet që turpëron, së pari veten, por edhe repartin a brigadën. Kjo ndeshje pozitive, ky debat revolucionar e zhvillon më tej luftën e klasave në gjirin e të rinjve. Po qe se shokët e shoqet e repartit, të klasës ose të lagjes, të thonë «vepro kështu, ndryshe nuk shoqërohemi me ty, s'të flasim», e ke të vështirë t'u rezistosh. «Bllokada» e shokëve është e pamundur të thyhet. Pa ata s'jeton dot. Prandaj edhe fjala e tyre zë vend shumë. Këtë fakt duhet ta shfrytëzojnë mjaft të rinjtë tanë, për t'u krijuar një ambient mbytës të gjithë atyre që e shohin të bukurën ndryshe nga masa e madhe revolucionare e rinisë sonë. Të rinjtë tanë revolucionarë nuk duhet të durojnë që për

shkak të pesë-gjashtë vetëve me sjellje të këqija të përmendet për keq emri i nderuar i ndërmarrjes së tyre. Prandaj edhe ata duhet të angazhohen në një luftë frontale kundër këtyre shfaqjeve të huaja, duke ndezur frymën e ballafaqimit dhe debatin parimor. Por, veç, duhet theksuar se jo kudo kjo frymë ballafaqimi po zhvillohet me atë forcë që kërkohet. Organizata e rinisë e turnit C të një fabrike punon shumë mirë me të rinjtë e vet në luftë kundër shfaqjeve të huaja. Në mbledhjen e organizatës së rinisë ata kanë thirrur edhe prindët e të rinjve shembullorë e të prapambetur dhe ballafaqimet i kanë bërë me shumë sukses. Po kështu mirë kanë punuar edhe organizatat e rinisë të turnit B e të turnit A, por shembullin e tyre duhet ta ndjekin edhe organizatat e rinisë të turneve të tjera. Të gjithë, pa përjashtim, duhet të fyhemi, goftë dhe nga shfaqjet më të vogla të «modernistëve» dhe të mos i lejojmë të na prishin atmosferën tonë të pastër e revolucionare. Ndonjëherë vihet re në ndonjë uzinë një qëndrim indiferent i disa të rinjve ndaj këtyre shfaqjeve dhe tek disa ekziston mendimi i gabuar se nuk kanë ç'u bëjnë atyre që nuk sillen mirë ose që kanë paraqitje të jashtme të pahijshme. Në uzina, fabrika e kudo ka një rini të mrekullueshme e të palodhur, që e bëjnë natën ditë për të nxjerrë nga duart prodhime sa më të mira. A ka se si që këta qindra revolucionarë të mos bëjnë dot si vetja disa që numërohen me gisht? Por kjo kërkon që vetë të rinjtë të mos nënvleftësojnë këto shfaqje, sado të vogla qofshin. Kjo kërkon që edhe jeta e organizatës, edhe format e edukimit, të zhvillohen rregullisht. Në uzina ka organizata rinie shumë të mira, që mund të bëhen flamur për gjithë uzinën. Aty ka

dhjetëra e dhjetëra të rinj që janë shembull. Organizatat që kanë ende të meta mund të mësojnë nga organizatat më të mira të uzinës, po edhe nga të tjera jashtë saj.

Kjo luftë frontale kundër shfaqjeve të huaja nuk është vetëm detyrë e rinisë, por e të gjithëve, në ndërmarrje, shkollë, familje e shoqëri, e të gjitha organizatave të masave, të udhëhequra nga Partia. Ajo është detyrë e çdo komunisti, punonjësi e qytetari. Në qoftë se prindi ka fëmijë të pasjellshëm, detyrë për ta korrigjuar ka njëkohësisht edhe kolektivi ku punon prindi, shkolla, por edhe çdo qytetar, dhe sidomos çdo komunist që banon pranë tij në shkallë, në apartament ose në lagje.

Ka disa prindër që thonë pa të drejtë se «s'kam ç'i bëj unë, merruni ju të shkollës me të». Po kështu ka edhe disa mësues që nuk ua dinë derën e shtëpisë nxënësve të tyre. Drejtori i një shkolle në Tiranë nuk dinte as emrin e kryetarit të komitetit të prindërve të shkollës së tij! Bile ngandonjëherë vetë mësuesit, duke mos i aktivizuar nxënësit në mësim, duke i lënë pa i pyetur e pa i kontrolluar për një kohë të gjatë, i ftohën nga mësimet. Nxënësi duhet kontrolluar sa mëson, se ndryshe humbet interesin për mësim, shtuhet, bie në indiferentizëm, sepse sheh që nuk i kërkohet llogari. Aq më keq pas-taj kur ndeshesh me veprime të tilla, si ai i nxënësve e i byrosë së organizatës së rinisë së një klase të dytë dhe i mësueses së tyre kujdestare të shkollës së mesme të përgjithshme, që kur i pyetëm «a është marrë gjer tani ndonjë notë negative?», thanë njëzëri «jo», në një kohë që e vërteta ishte ndryshe. Kur vetë mësuesi i edukon nxënësit të fshehin të metat, ç'pret më tej?... Po në këtë shkollë bisedonim

me disa nxënës që u ishin vënë fletërrufetë për paraqitje të jashtme të pahijshme. Kur u thamë se ishte më mirë që përgjigjet e fletërrufëve t'i vinin bashkë me prindërit e tyre, ata u shqetësuan. «Vetëm këtë të mos e bëjmë, — thanë, — sepse na vjen turp». Kjo donte të thoshte se një praktikë e tillë do të kishte më efekt. Ja pse lipset t'i bashkërendojmë të gjitha forcat — të shkollës, të familjes, të ndërmarrjes. Disa të rinj shqetësonin vajzat e reja kur shkonin rrugës, në kohën kur në rrugë kish edhe qytetarë, ndër ta edhe komunistë, por këta i shihnin e heshtnin. Pra, ti, shok, kur ngjitesh ose zbret nga shkallët e apartamentit, sheh një të ri që nuk sillet mirë ose që ka paraqitje ekstravagante, mos e kthe kokën nga ana tjetër, ose mos thuaj «ç'bën rinia» e «ç'bën shkolla», por thuaj «ç'bëj unë». Ndërhy, sepse vetëm kështu ua zëmë të gjitha shtigjet shfaqjeve të huaja. Ne duhet t'i krijojmë secilit bindje të thella e të qëndrueshme se ideali dhe bota shpirtërore e popullit tonë nuk janë as flokët e gjatë, as sjelljet prej rrugaçi. Ne nisemi në jetë nga motive të mëdha e revolucionare. Prandaj duhet t'i drejtohem secilit me fjalën e ngrohtë e bindëse të Partisë, duke u përpjekur (por kur duhet edhe duke i detyruar) deri në fund e të tërë së bashku për ta vënë në udhë të mbarë. Fryma e ballafaqimit dhe e debatit parimor, si për çdo çështje ideologjike, ekonomike e organizative, edhe për problemin e edukimit duhet të jetë efektive, të forcojë sedrën dhe bindjen revolucionare.

MËSIMET NGA NJË AKSION

Aksionet e punonjësve të qytetit në ndihmë të fshatit janë një përvojë e re në vendin tonë. Duke frymëzuar me anën e tyre punën komuniste, Partia ka synuar dhe ka ngritur në një shkallë të re më të lartë ndërgjegjen politike të njerëzve tanë. Vlerat e këtyre aksioneve, kur organizohen siç duhet, janë të mëdha e të pallogaritshme; ato janë politike, ideologjike, organizative, ekonomike.

Këto radhë ne do t'i shkruajmë për një aksion që u organizua shumë mirë në rrethin e Krujës, që pati vlera të mëdha dhe nga organizimi i të cilit na duket se mund të mësohet.

Organizata e Partisë e rrethit, nën parullën «Bujqësia, çështje e të gjithë popullit», u bëri thirrje punonjësve të rrethit të hidheshin në ndihmë të bujqësisë për korrjen, zhveshjen dhe dorëzimin e misrit në depo. Kjo thirrje nuk ishte një tekë, as një vendim spontan, as alarm, për të provuar gatishmërinë e masave, se ajo njihet, është provuar. Nuk synonte ndërkohë, as për të zëvendësuar kooperativistët e punonjësit e bujqësisë, sepse edhe klasa punëtore e punonjësit e tjerë kanë detyrat e veta shumë të ngjeshura e të vështira. Organizimi i këtij aksioni ishte një veprim i menduar mirë parapra-

kisht, ishte nevojë që delte nga ngutësia që kërkonte korrja e futja e misrit në hambar. Kështu kooperativistët do t'u dilnin përpara punëve të tjera të bujqësisë. Por aksioni, para së gjithash, do t'u shtonte respektin për punonjësit e qytetit, dhe këta të fundit do të bënin një hap tjetër në edukimin me punën komuniste.

Për të dalë në disa konsiderata të përgjithshme, po përmendim jo vetëm faktin që të 15000 aksionistët gjatë aksionit korrën, zhveshën dhe futën në depo 74000 kv misër, por në radhë të parë duam të theksojmë atë miratim e entuziazëm që shkaktoi aksioni në punonjësit e qytetit e të fshatit. «Ky ka qenë aksion — thoshin njerëzit — Ja kështu duhen organizuar aksionet» Po si u organizua dhe cilat ishin vlerat e këtij aksioni?

Në radhë të parë aksioni pati vlera të mëdha politike. Ai tregoi edhe një herë drejtësinë e vijës së Partisë dhe të mësimëve të shokut Enver, se kur njerëzit krijojnë bindje të shëndosha politike, kur puna e Partisë bëhet e kualifikuar, pjesëmarrja dhe rezultati janë të garantuar. Dhe është fakt, gjatë aksionit, punonjësit jo vetëm realizuan normën prej 5 kv misër, por edhe e tejkaluan atë. Gjatë ditëve të aksionit organizatat-bazë të Partisë, ato të masave, me në krye anëtarët e plenumit, komunistët, aktivistët e organizatave të masave, organizuan një agjitacion jo të bujshëm, por me efekt, biseda të thjeshta, të ngrohta me njerëzit për rëndësinë politike të parullës së Partisë «Bujqësia çështje e të gjithë popullit», për ndikimin konkret të punës së tyre kundër rrethimit e bllokadës imperialiste e revizioniste. Pikërisht këtu, së pari, konsistonte e kanalizohet rëndësia politike e aksionit që ushqente e ka-

liste më tej unitetin midis klasës punëtore, ushtarakëve e gjithë punonjësve me fshatarësinë kooperativiste. Punonjësit e NB-ve dhe kooperativistët e Bilajt u entuziazmuan nga puna e punonjësve të ndërmarrjes pyjore, por edhe e ushtarakëve që nuk largoheshin nga fronti pa tejkaluar normën 140-150%, dhe me cilësi shumë të mirë. 62 pensionistë të Laçit harruan pleqërinë e lodhjen e viteve, punuan me ngulm në sektorin e Gjormit dhe u larguan vetëm pasi e tejkaluan mbi 100% normën.

A nuk janë këto shfaqje të bukura të ndërgjegjes së lartë politike që ka edukuar Partia tek njerëzit tanë? ««Të shtunat komuniste» — theksonte Lenini — kanë një rëndësi të madhe historike, pikërisht sepse ato na tregojnë iniciativën e ndërgjegjshme dhe vullnetare të punëtorëve për të shtuar rendimentin e punës, për të kaluar në një disiplinë të re në punë, për të krijuar kushte socialiste në ekonomi dhe në jetë»¹).

Gjatë ditëve të aksionit edhe vetë punonjësit e bujqësisë e rritën mjaft rendimentin në punë. Dëmos, u vunë në sedër. Sa për disa traktoristë të SMT-së së Fushë-Krujës, që punojnë për vitet 1981, 1982 e 1986, puna e këtyre ditëve u shtoi muaj.

Puna vullnetare, të jetuarit me situatat, forcoi më tej unitetin. Por si u arrit ky forcim i mëtejshëm i unitetit? Duke kërkuar këtë spjegim, kalojmë kë-shtu, së dyti, në vlerat e mëdha ideologjike të aksionit. Duke biseduar me disa kooperativistë në kooperativën bujqësore të Niklës, njëri prej tyre na tha: «Në fillim disa prej nesh kishin menduar keq

1) V. I. Lenin. Vepra të zgjedhura, bot. shqip, 1974, vëll. III, f. 379.

për disa nëpunës që vinin për aksion në fshat. «Këta të karrikes nuk punojnë dot, se nuk i kanë vrarë duart», thoshim. Por sidomos aksioni i fundit na bindi se jo vetëm punojnë, por disa edhe më shumë se ne». Mund edhe të ngacmohet në sedër ndonjë intelektual nga këto fjalë, por kjo është një e vërtetë. Bile fshatari edhe të ironizon kur ti, i veshur si për dasmë, kalon si «turist» siç thonë, nëpër parcelë me majën e këpucës e tërë tangërllek. Kjo është fyerje që i bëhet punës dhe njeriut të punës. Prandaj dhe fshatari reagon në ndonjë farë mënyre. Ndoshta i keni lexuar ato vargje: «Manushaqe, na kënaqe, duam punë, s'duam shfaqje», thonë fshatarët. Por ama, kur punon mirë, të mbajnë në gojë, rritet respekti për ty e s't'i kursejnë fjalët e mira, siç ndodhi dhe me aksionin për të cilin flasim.

Dhe që kanë ndodhur skena të tilla nuk është faji vetëm i atyre individëve që e marrin si një piknik aksionin. Në radhë të parë është faji i organizatorëve të aksionit, të cilët disa herë, duke mos programuar e normuar punën e secilit e pastaj duke mos ushtruar kontroll rigoroz, u lënë shkas njerëzve të thonë: «E mo, bëme një aksion sa për të thënë. Më shumë u prish puna se sa u ndreq». Me këtë «punë që u prish», zakonisht ata kanë parasysh dëmin ekonomik që mund t'u sjellë një aksion i organizuar keq, dëme të tilla si shpërdorimi i kohës, a dëmtimi i pronës së kooperativistëve nga disa qytetarë të pandërgjegjshëm. Po ajo që pëson më shumë në kësi rastesh është ana politike dhe ideologjike e problemit.

Nuk ndodhi kështu me aksionin në fjalë që u organizua në rrethin e Krujës. Të gjithë aksionistët, sidomos punëtorët, ulën kokën, punuan me ngulm.

«Deri në gju futeshin në ujë, sa të realizonin normën», na tha një kooperativist. Prandaj dhe thanë fjalët më të mira për punëtorët e ndërmarreve pyjore, të ujërave, uzinës së superfosfatit, kombinatit të drurit, komunales etj. «Pikërisht një punë e tillë proletare që shprehet në «të shtunat komuniste» dhe që kryhet gjatë këtyre të shtunave — shkruante Lenini — sjell me vete forcimin përfundimtar të respektit dhe të dashurisë së fshatarësisë për shtetin proletar»¹).

Rol të rëndësishëm luajti gjatë aksionit jo vetëm propaganda konkrete, por edhe caktimi i normave për çdo njeri dhe kontrolli rigoroz. Realizimet e aksionit u shënuan në evidencën e përditshme.

Aksioni në fjalë pati një ndikim tjetër të veçantë tek vetë kooperativistët. Po të shohësh evidencën e bujqësisë gjatë ditëve të aksionit, do të vësh re se numri i mungesave të paarsyeshme nga kooperativistët u kufizua shumë. Sedra revolucionare ato ditë u shfaq më e bukur se kurrë. Si mund të rrih duarkryq kur tjetri të vjen e të ndihmon? Aq më keq si mund të lësh punën e të bredhësh nëpër pazarin e Tiranës e të Milotit me një pulë në dorë kur të tjerët nga qyteti vijnë të të ndihmojnë?! Bisedonim ato ditë me kryetarin e një kooperative bujqësore. «Mungesat e paarsyeshme këto ditë na janë kufizuar mjaft — tha ai. — Aksioni ka ndihmuar duke vënë në sedër kooperativistët, por na kanë ndihmuar dhe ne drejtuesit për të kërkuar llogari. Sepse unë i them fshatarit tonë tani: «Ku je duke shkuar ti, or babë? Në Tiranë?! Pa shiko këta që të kanë

1) V. I. Lenin, Vepra të zgjedhura, bot. shqip, 1974, vëll. III, f. 390.

ardhur? Për cilin kanë ardhur?» Numri i kooperativistëve të tillë u kufizua, por megjithatë pati dhe nga ata që s'i vrau ndërgegjja. Punonjësit e qytetit me aksionin në fshat u thanë këtyre: «Hairin, ti shoku kooperativist, e ke këtu, në fshat, në kooperativë e jo atje, në treg, tek shkon për të shitur një pulë. Po të mos ishte kështu edhe ne nuk do të vinim të ndihmonim për të korrur, zhveshur e magazinuar misrin». Besohet se ato kooperativa ku ka të tillë, që i kalojnë ditët në pazar, me siguri që duhet të kenë nxjerrë mësim nga ditët e aksionit.

Së treti, aksioni pati vlera të mëdha ekonomike. Doemos që misri nuk do të lihej në arë dhe nga vetë kooperativistët, po kur do të përfundonte? Kjo pyetje ka rëndësi të madhe në bujqësi, sepse grurit i kalonte koha e mbjelljes e pasojat do të ndiqnin njëra-tjetrën. Sikur të mos ishte organizuar ky aksion, misri do të hiqej nga ara gati dy javë më vonë. Por edhe gruri nuk do të mbillej në atë kohë që u mboll dhe me atë cilësi që u mboll gjatë ditëve të thata. Sepse dihet mirë që ai nuk mbillet në shi. Dhe kështu do të vështirësoheshin të gjitha fushatat njëra pas tjetrës.

Së fundi aksioni pati vlera të mëdha organizative. Gjatë bisedave të ndryshme me punonjës e kooperativistë, u sollën argumente nga më të ndryshmet për suksesin e aksionit. «Unë kam dhjetë vjet këtu, — na tha një drejtues i NB të Thumanës. — S'ka bërë vaki kurrë që misri të hiqej kaq shpejt. Ndodhte ta zinte dhjetori, bile edhe janari. Arsyeja është, për mendimin tim, se në këtë aksion secili e kishte caktuar normën e vet 5 kv. misër, kurse në aksionet e tjera norma ishte e lirë, të bëje sa të doje». Dikush tjetër suksesin e aksionit e shpjegoi

me kontrollin e rreptë të punës së kryer, një kontroll zinxhir nga qendra e nga baza, nga organet e Partisë dhe të pushtetit. Kryerja e punës u shoqërua vazhdimisht me dokumentimin përkatës.

Suksesi u arrit edhe për faktin se aksioni u vlerësua nga organizata e Partisë dhe organizatat e masave të rrethit në radhë të parë, si një aksion politik e ideologjik. Është me rëndësi të madhe fakti se ata që realizuan dhe tejkaluan të parët detyrat e aksionit ishin punonjësit e aparatit të Komitetit të Partisë, të komitetit ekzekutiv, të bashkimeve profesionale të BRPSH dhe BG të rrethit. Shembulli i komunistit dhe i drejtuesit është forcë e pamatur reale.

Pa dyshim janë të gjitha arsyet bashkarisht e në krye të të gjithave është forca e madhe e ideve të Partisë, e mësimëve të shokut Enver, ajo që, si kudo e kurdoherë, i kanë hedhur masat tona punonjëse nga aksioni në aksion.

ME DASHURINË PËR NJERËZIT NË ZEMËR

Djemve e vajzave më të mira të Shqipërisë u dhimbe shpirti, atëherë kur dëgjonin popullin fukara të këndonte: «O ju malet me dëborë, pse s'qani hallet e mia..» Po malet me dëborë, heshtnin. Atëherë ata u mblodhën të tërë tok e bënë një mal të madh që nuk heshte: Partinë Komuniste. Dhe që atëherë, populli zuri t'i qajë hallet me komunistët. Hallet e luftës, të punës e të jetës. Prandaj dhe tani u dhimbset shumë njëri-tjetri. Komunist është ai të cilit i ther në zemër për një hall të popullit.

Me këtë masë i ka vlerësuar gjithmonë komunistët Partia jonë. Me këtë masë i vlerëson dhe tani. Partia ua mbush zemrën komunistëve me dashuri për njerëzit. I ka bërë militantë për drejtësi komuniste në çdo fushë të jetës. Të tillë gjen kudo. Para ca kohësh në një fshat takuam njërin prej tyre, Mitatin, komunist e drejtues. Fshatarët për të nxjerrin mjaltë nga goja. «S'e merr gjumi kur ka një hall populli», tha një kooperativist «O Mitat, — i tha një ditë sekretari i Partisë — isha dje në një fshat të kooperativës, more, dhe takova atë plakun e vetëm, ti e njeh. M'u ankua: i ishte rrëzuar shtëpia. Edhe i sëmurë ishte. Si thua?» Por Mitati s'foli. Vetëm u zverdh. Në ballë iu bënë shumë rrudha, ndërsa sytë

iu bënë më të shndritshëm se zakonisht. Pas dy orësh Mitatin e panë në shtëpinë e plakut, bashkë me disa mûratorë dhe gjeometrin e kooperativës. «Ja këtu do të punoni. Filloni!», u tha atyre, ndërsa vetë shkoi të takojë plakun. Dhe e takoi. Por mezi fliste. Ndiante turp brenda vetes. «Si je? — i tha. — Kemi ardhur të bëjmë autokritikë, që të kemi munduar kaq ditë. Nuk e dinim. Na fal që s'e dinim». Kështu tha Mitati dhe e mori plakun e sëmurë në makinë dhe e çoi në spital. Ndenji plaku atje disa ditë dhe kur u kthye i shëruar në shtëpinë e rregulluar për bukuri, iu mbush zemra me gëzim. Ta pyesësh tani, të betohet për kokën e Mitatit. «Komunist me nam është, — thotë — lum Partia që e ka, lum ne që e kemi!» Nuk është vetëm ky plak që i thotë këto fjalë për Mitatin. Por nuk është as Mitati i vetmi në kooperativë që e prek shqetësimi për njerëzit. Në këmbë për njeriun atje janë të gjithë komunistët, janë bashkëfshatarët. Pa ata edhe Mitati s'do të ishte i tillë. Ose dhe po të ishte i tillë, pa ata fjala e tij do të mbetej vetëm dëshirë. Dashuria e tij për njerëzit është një pjesë e dashurisë së tyre. Por Mitatin e afron më shumë me njeriun jo vetëm dashuria e tij prej komunisti, por edhe përgjegjësia e deputetit. Atë e afron me njerëzit edhe fakti se ai gjithë jetën ka jetuar bashkë me ta, i ka parë si janë rropatur për bukën, si kanë luftuar për lirinë dhe socializmin. Prandaj mendon se duhet të shqetësohet dhe të bëjë më shumë se të tjerët. Atë e gjen kudo kur njerëzit kanë shqetësime. Duhet dy ditë ta bredhësh në këmbë tërë kooperativën, po Mitati s'përton kurrë. E gjen kudo ku e thërret zëri i njeriut. Ky zë lë gjurmë në zemrën e tij prej komunisti. Ky zë e mban ditë e natë në këmbë.

Ra telefoni një ditë. Ra shumë. Mitati ngriti receptorin dhe dëgjoji zërin e shqetësuar. «E kam nënën në gradën e fundit — tha zëri. — Dy infermiere kemi këtu në fshat. Njëra nuk është, kurse tjetra nuk dëgjon të vijë t'i bëjë gjilpërën. «Sille këtu» thotë. Eh, si u bë Mitati! Sikur të qe nëna e tij. U nxe shumë. Shkoi. Mezi fliste.

«Po pse, moj — thoshte — harruat ju si kemi qenë?! Harruat ju se s'kishim të hanim e jo infermierë e doktorë siç kemi tani? Partia na i dha të tëra. Po pse atëherë nuk bëheni copë për njeriun e për Partinë?!».

Ndien një ngazëllim të çuditshëm në vete kur dëgjon të flasin për zemrën e dhimbsur të këtij komunisti, për shpirtin e këtij luftëtari për drejtësi komuniste. Do që t'i dëgjosh të gjitha. Do që të dëgjosh sa më shumë. Sepse, e di sa të gëzojnë të tilla tregime për djemtë e Partisë? Të fisnikërojnë në shpirt. Dhe dëgjuam sa mundëm. Kurse tani që kam vënë bllokun përpara, s'di cilin të lë pa treguar. Në një faqe, për shembull, kam shënuar: «Një vajze i doli bursa për në shkollë. Ajo shkoi por u kthye prapë. «S'të takon», i thanë, «Pse?» Ajo shkoi e mërzhitur tek Mitati. «Si kështu?!» Ai u mërzhit shumë gjithashtu. Kush i bën këto dallavera?! Ai bisedoi me shokët, menjëherë kërkuan dhe zbuluan padrejtësinë e bërë në fshat dhe e nisën vajzën prapë në shkollë.

«I do shumë fëmijët, — tha një plak. — I ndalon në rrugë kur kthehen nga shkolla. «E, — u thotë — si jeni, si veni me shkollën? Kush mori 10 nga ju?» Po me ne pleqtë?! Unë djalë më të mirë nuk dua për vete, — vazhdon plaku. — S'di të bërtasë kurrë me ne. S'të thotë kurrë «Puno», kur je plak.

«A ke takat të punosh?», të thotë. Dhe ti punon më shumë».

«Ashtu, ashtu është», thotë duke tundur kokën një plak tjetër që rri pranë tij.

Partia i ka mësuar komunistët të jenë më njerëzorët me njerëzit tanë dhe më të egrit me armiqtë. Dhe kështu kanë qenë e janë komunistët. Kështu është dhe ky komunist. Nuk e dija që ai kishte luftuar dhëmb për dhëmb me bandat e armiqve. Nuk iu drodh dora kundër armiqve.

Për Partinë, për njerëzit e popullit e ruante thellë në shpirt dashurinë. Bile në emër të kësaj dashurie luftonte. Dhe vazhdon të luftojë kundër armiqve edhe në kooperativën e tij. Po, aty armiqtë kanë luftuar në forma të ndryshme. Aty ata janë përpjekur të përzihen me popullin dhe të marrin padrejtësisht nga dashuria e komunistëve të kooperativës. Por kjo dashuri është vetëm për popullin. E dini ç'bëri një prej tyre? U ankua tek Mitati si më «zemërimi».

I kërkonte t'i zmadhonte kopshtin. I kërkonte t'i jepte leje që të mos e dërgonte gruan në punë, sepse «qe e paftë». Po Mitati? Ai nuk u mallëngjye prej tij, por e urreu. U mblodhën populli, komunistët, dhe të gjithë bashkë i demaskuan armiqtë. Sepse siç i do njerëzit bashkë me komunistët dhe popullin, ashtu i demaskon edhe armiqtë, bashkë me komunistët dhe popullin. Sepse armiku kërkonte t'i zmadhohej kopshti, por ia matën dhe doli se kishte më shumë se të tjerët.

Kërkonte t'ia quanin gruan të sëmurë, por ia vizituan tek mjeku dhe i doli shëndoshë e mirë. Kërkonte t'i plotësonte të ardhurat shoqëria, por asaj ai i rrëmbente më tepër se ç'i jepte, sepse bënte matrapazllëqe.

Një tjetër, i porsadalë nga burgu, i dërgoi një lutje që ta lejonte për të punuar në një ndërmarrje shtetërore, sepse ishte i «sëmurë». Në lutje ai i ankohej për brigadierin, për përgjegjësën e sektorit, për kryetarin e këshillit... Por ai nuk e mallëngjeu zemrën e komunistit, sepse ai kish dashur të minonte pronën e përbashkët. Prandaj edhe lutja nuk iu mor parasysh, por iu hodh përpara syve në mes të popullit dhe u demaskua. Kështu kanë vepruar edhe disa herë të tjera me të tillë njerëz komunistët dhe populli i kooperativës. Turinjve ua kanë përplasur. Gabohen shumë armiqtë kur përpigën të përzihen me popullin. Kur shohin se komunistët dhe të tjerët bëjnë autokritikë e kritikojnë njëri-tjetrin për hir të punës së përbashkët, ata pandehin se po grinden, se po hahen me njëri-tjetrin. Por jo. Kurrë! Ata kritikojnë njëri-tjetrin, që nesër ta duan më shumë njëri-tjetrin, që nesër të shqetësohen më shumë për njëri-tjetrin. Ata kritikojnë njëri-tjetrin, që nesër të bëhen më të fortë, të grumbullojnë më shumë urrejtje për armiqtë, që të dërrmojnë më lehtë armiqtë.

Kur komunistët dhe kuadrot, siç e kanë bërë zakon, japin rregullisht llogari para popullit, armiqtë u duket se duhet të japin llogari edhe para tyre. Prandaj ngrenë zërin. Por jo, ata i japin llogari vetëm popullit, njerëzve të tyre. Dhe këtë e bëjnë që të lidhen sa më fort me ta, që ta dëgjojnë sa më afër zërin e tyre, që ta ndiejnë sa më afër dashurinë e tyre. E bëjnë që të kenë më shumë bukë. Dhe pikërisht sepse po bëjnë kështu, po e shtojnë edhe bukën dita-ditës, vit për vit. Gjithmonë e më shumë në të ardhmen. Sepse e ardhmja është e tyrja, e jona.

THELBI I PËRVOJËS SË PËRPARUAR — PUNA E GJALLË ME NJERËZIT

Në Breg të Matës jeton, mendon, punon, lufton e çan rrethimin si revolucionare një brigadë kooperativistësh: brigada e parë e sektorit të dytë të «Yllit të Kuq». Ajo udhëhiqet nga një organizatë-bazë partie prej dhjetë komunistësh me sekretar Dedën, kurse brigadier Pjetrin.

Kjo është adresa.

E dhamë që në fillim këtë adresë pasi na duket se për të kanë nevojë të gjitha ekonomitë e rrethit të Lezhës e, ndoshta, jo vetëm ato. Shumëkush mund të ngutet e të mendojë: «Rezultatet, duam të dimë; gjykojmë vetë pastaj». Ashtu është. Ne s'jemi idealistë dhe punën tonë duhet ta matim me rezultatet konkrete. Edhe rezultatet e brigadës për të cilën flasim janë shumë të mira. Por le të mos ngutemi, pasi përvojë e përparuar nuk janë vetëm rezultatet.

Përvojë e përparuar është një kompleks i tërë e i shumanshëm faktorësh, procesesh, argumentesh që çojnë në atë përfundim të suksesshëm, në rezultanten. Përvoja e përparuar qëndron; së pari, në kuptimin e, veçanërisht, në zbatimin rigoroz e hap pas hapi të normave të Partisë e të ligjeve të shtetit, që ka në themel punën e gjallë me njerëzit. Na du-

ket se për këto duhet të pyesim në fillim kur shkojmë të marrim përvojë. A nuk është fakt që dhjetëra e dhjetëra punonjës të bujqësisë e specialistë kanë shkuar në Pogon, Donofrosë e gjetkë e, megjithatë, për disa prej tyre këto ecejake kanë marrë vetëm kuptimin e një ekskursioni dhe vetëm sa kanë harxhuar kohën, dietat e karburantin e autobuzëve? Sepse as tufëzimin e kanë bërë, as rezultatet e Donofrosës në luledielli nuk i kanë arritur. Dhe kjo, veç të tjerash, sepse kanë qëndruar vetëm tek rezultatet dhe jo tek çdo proces i luftës për arritjen e tyre, sepse përvoja e përparuar është trajtuar vetëm si çështje specialistësh e specialiteti e jo të jetë qëndruar, së pari, tek ajo që quhet punë partie, tek puna me njerëzit. Kjo është alfa e përvojes së përparuar. Nuk u mbetet qejfi as pogonasve, as atyre të Donofrosës po të themi se specialistë bujqësie e blegtorie po aq të mirë sa ata e, bile, edhe më të mirë ka kudo. Mjelësja heroinë, Gjyzja, me disa klasë shkollë është dhe nuk i njeh teorikisht ligjet e zooteknisë si shumë specialistë. Ajo s'ka institut të lartë, por rezultate të larta në qumësht dhe me to ajo u kujton diplomën disa specialistëve të lartë me rezultate të ulëta... Ajo ka «diplomë» në «specialitetin» e punëtorit të ndërgjegjshëm të Partisë, specialitet që e ushtron me seriozitet e pasion, hap pas hapi, nga mëngjesi në mbrëmje. Ajo jep përvojë edhe kur punon, edhe kur diskuton nëpër mbledhje, edhe në familje, kudo. Prandaj edhe këtyre flamujve të shoqërisë sonë përvoja u duhet «thithur» kudo e hap pas hapi.

Të qëndrojmë tek brigada në fjalë. Vetëm në disa momente të kësaj pune të gjallë, të thjeshtë, por të madhe e të përditshme. Është e pamundur të

futet e tëra në kolonat e një shkrimi. E pyetëm brigadier Pjetrin për rezultatet e brigadës së tij, por ai nuk zuri të hapte fletoret e blloqet (megjithëse i kishte shumë të rregullta), bile u fye disi, sepse «i mbaj mend, — tha, — për çdo vit, për çdo kulturë, numrin e hektarëve të mbjellë dhe ditët e kryera vitin e kaluar nga çdo anëtar i brigadës».

Brigada ka 110 anëtarë. Gjatë vitit 1977 sipërfaqja e mbjellë me grurë ishte 97 ha, plani — 46 kv për ha, realizimi — 49,6 kv për ha; sipërfaqja me misër ishte 72 ha, plani — 58 kv për ha, realizimi — 66 kv për ha; sipërfaqja me luledielli ishte 36 ha, plani — 20 kv për ha, realizimi — 22 kv për ha, sipërfaqja me patate ishte 8 ha, plani — 77 kv për ha, realizimi — 80 kv për ha. Në ngastra të veçanta: grurë në 83 ha u morën 54,3 kv për ha; në një ngastër — 66 kv për ha. Misër në 9 ha u morën 93 kv për ha.

Për vitin 1978 zotimi është 1000 kv drithëra mbi planin. Sipërfaqja me grurë është 96 ha, plani — 50, zotimi — mbi 50 kv për ha, sipërfaqja me misër — 83 ha, plani — 67 kv për ha, zotimi — 70 kv për ha; sipërfaqja me luledielli është 36 ha, plani — 20 kv për ha, zotimi — 22 kv për ha; sipërfaqja me patate është 10 ha, plani — 82 kv për ha, zotimi — 90 kv për ha. Brigadieri na tregoi vetëm për rezultatet e vitit 1977, vitit me kushte moti shumë të disfavorshme për bujqësinë. E pyetëm për vitet 1976, 1975..., por: «Jo, — tha. — Partia na mëson të mos i bëjmë krahasimet me një e dy vjet më parë, por me planin».

Na duket se fakti i mbante ose s'i mbante mend shifrat brigadieri, nuk është aq i parëndësishëm, siç mund t'i duket ndokujt. Pikërisht edhe kjo gjë «e

vogël» përbën përvojë, pasi tregon sa i lidhur është ai me punën e me njerëzit. Shembulli personal i komunistëve e i drejtuesve përbën në këtë brigadë një nga kushtet themelore të sukseseve dhe rezervën më të madhe të brendshme. Po bëjmë një saktësim në adresën e brigadës. Po t'ju qëllojë të shkoni atje sekretarin e organizatës, Dedën, ose Pjetrin, mos i kërkoni zyra, ose duke u shullëhur në ndonjë rrëzë peme, po në mes të brigadës, duke punuar bashkë me kooperativistët. Deda vetë punon drejtpërdrejt në prodhim bashkë me 7 komunistë. (Pra, 8 nga 10 që janë gjithsej në organizatë). Edhe njerëzit e familjeve të tyre patën për vitin 1977 një mesatare më të lartë se ajo e kooperativistëve, kurse vetë sekretari doli shumë mbi ta: gjatë vitit 1977 bëri 390 ditë-punë. «Duhet, — thotë Deda, — duhet medemos, ndryshe s'jemi në rolin pararojë e s'u kërkohet dot llogari të tjerëve». «Ja, një kanal e ndan këtë brigadë nga ajo e Gajushit, — thotë Pjetri. — Rezultatet e saj s'janë të mira edhe për shkak se komunistët nuk janë në rolin pararojë të gjithë, kurse në Pllanë, nga 9 komunistë që janë, 4 punojnë si roje».

Disiplina e rreptë, dhe sidomos e ndërgjegjshme, është një nga faktorët që siguron sukseset në këtë brigadë. Bisedonim atë ditë me një nga të rinjtë e brigadës. «Porsa kreuva shërbimin ushtarak, por, të them të drejtën, më duket sikur vetëm uniformën kam hequr», — thotë ai me buzë në gaz.

Më 6.30 e fillon punën brigada tani në dimër, më 6 Pjetrin e ke te vendi i punës. «E kemi bërë rregull si në uzinë, bëjmë edhe apelin, — thotë Pjetri. — Edhe drekën e hamë të gjithë në një kohë këtu në punë. Njëllon si punëtorët është, apo jo? . . .». A

ka njeri që vjen vonë në punë? Kooperativistët që pyesim ngrenë supet. «Ndoshta, s'na kujtohet ndonjë. Por një gjë mbaj mend mirë, — thotë një shoqe. — Gjatë vitit 1977 nuk patëm asnjë mungesë pa arsye në punë». Vërtet, asnjë s'ka ndodhur të vijë me vonesë në punë? «Ka ndodhur vitin e kaluar nja dy tri herë me nga 5-10 minuta vonesë, — thotë Prenda. — Por në fillim i nxorëm para skuadrës dhe kur njëri e përsëriti, e nxorëm para brigadës dhe s'ka ndodhur herë tjetër».

— Një herë na erdhi një grua me vonesë, — thotë Pashka. — Filloi të justifikohet. «U vonova, se rregullova fëmijën për në çerdhe», tha ajo. Atëherë ne i thamë të gjitha njëherësh: «Po pse, ne nuk kemi fëmijë për në çerdhe? Çohu më herët e rregulloje».

— Është edhe një arsye tjetër që ndihmon të kufizohen mjaft mungesat, na tha brigadieri: — forcat përqëndrohen në një ose dy procese pune dhe nuk ndahen kokrra-kokrra në shumë procese. Kjo metodë ka bërë që edhe kontrolli të bëhet më i fortë.

— Ndoshta kështu, kur jemi të gjithë bashkë, është më mirë, se edhe ndonjë i pandërgjegjshëm e ka më të vështirë të vërë dorë mbi pronën kooperative.

Dedës, sekretarit, sikur s'i pëlqen kjo ndërhyrje.

— Mundet, — thotë, — mundet, por tek ne nuk ka pasur asnjë rast vjedhjeje që para katër-pesë vjetësh, veç ndonjë dëmtimi nga lopët. Për këtë vit jemi zotuar të mos kemi asnjë procesverbal për dëmtim.

Dashuria për pronën e përbashkët dhe kujdesi për mbrojtjen e saj përbën një faqe të mrekullueshme të jetës së kësaj brigade të dalluar. Kjo tanimë

për ta është bërë edukatë dhe «histori» të bukura rreth kësaj ideje dëgjon në të gjithë Lezhën. «Në qoftë se do ta takosh brigadën natën, shko në ngastrat e saj kur ka erë të fortë e shi të rrëmbyer, — na tregonte një instruktor i Komitetit të Partisë. — Anëtarët e kësaj brigade në raste të tilla, pa i lajmëruar kush, pa rënë asnjë çangë, ngrihen e mblihdhen të gjithë nëpër ngastrat. Na ka qëlluar t'i shohim disa herë kështu, gra e burra. Asnjë mungesë po të bësh apelin».

— Po në raste të këtilla nuk mëndojmë vetëm për vete, — thotë kooperativistja Martë. — Kur një natë zuri shiu, shkuam të tërë në fushë, futëm në kapanon lulen tonë, por futëm edhe atë të brigadës së katërt të Tales.

Po ky moment a nuk përbën përvojë të përparuar?

Janë një grumbull arsyesh e masash që mungesat në këtë brigadë janë shumë të kufizuara. Pothuaj të gjitha gratë e brigadës i çojnë fëmijët e tyre në kopshte e çerdhe. Dhe për kopshtin e çerdhen si domos Deda me Pjetrin, tregojnë kujdes të veçantë. «Para një jave, — tregon Pjetri, — disa gra na u ankuan për kopshtin. Ka disa ditë që hapet me vonesë», na thanë. Që atë çast Deda dhe unë morëm edhe kryetarin e këshillit popullor me vete e shkuam në kopsht. Bëmë ballafaqim. I thamë asaj shoqes së kopshtit: «Mendoje thellë këtë që bëre ti, shoqe, sepse kështu dëmton edhe fëmijët, edhe punën tonë, edhe tënden». Ajo shoqja e kopshtit bëri autokritikë, por bëmë edhe ne që kishim shumë ditë pa shkuar atje. Se me këtë rast pamë që edhe lojëra, edhe gota, edhe dru s'kishte sa duhej».

Me disiplinë në këtë brigadë shembullore nuk

nënkuptohet vetëm ajo që quhet disiplinë formale, ose orari. Në radhë të parë disiplina këtu qëndron në këmbënguljen për cilësinë e shërbimeve dhe rigozitetin në zbatimin e të gjitha hallkave të kodit agroteknik. Kur kanë proces të ri pune, ata mblidhen në mëngjes të gjithë në një vend dhe bëjnë atë që e quajnë «kampioni i punës», modelin. Këtë, zakonisht, e bën Pjetri, brigadieri. Kurse kontrolli i cilësisë së punës bëhet nga çdo përgjegjës skuadre, nga brigadieri dhe, ajo që është më e bukur dhe më e dobishme në këtë brigadë, anëtarët e kanë bërë edukatë të kontrollojnë cilësinë e njëri-tjetrit. Por ka një specifikë, një gjë të veçantë kontrolli i cilësisë në këtë brigadë. «Për ne, — thotë Pjetri, — kontrolli kur lëmë punën nuk ka asnjë kuptim. Atë e bëjmë gjatë ditës. Në mëngjes, shumë-shumë gjer në drekë mund të përsëritet puna, se pastaj s'mbetet kohë». Brigadieri Pjetër këtu «harroi» të shtonte diçka jo të vogël. Por e plotësoi Deda, sekretari. «Pjetri, — tha ai, — e merr vetë shatën në dorë dhe e mëson me punë tjetrin si bëhet puna, jo me llafe».

Kushdo që dëgjon e sheh punën dhe rezultatet e kësaj brigade, s'ka si të mos mendojë edhe për fatin e mjaft brigadave të tjera, që megjithëse me toka të përrafërta me të, kanë rezultate më të ulëta e, ndonjëherë, shumë më të ulëta. Pyetëm për këtë anëtarët e brigadës që drejton Pjetri. Ata thanë se tanimë ka mjaft brigada që po u afrohen rezultateve të tyre, por ka edhe mjaft me rezultate të ulëta, dhe arsyeja është se ata nuk veprojnë si kjo brigadë për të gjitha problemet që përmendëm më sipër, por shtuan se edhe shërbimet bimëve nuk ua bëjnë mirë. Për shembull, numrin e bimëve për hektar nuk e plotësojnë. «Po pate numrin e bimëve,

— tha Pjetri, — e ke vetë në dorë prodhimin, s'ka as toka, as qielli». Tjetër? «Mjekimi», thanë ata. Me «mjekim» ata quajnë plehërimin me urinë të disa vatrave të «sëmura» me bimë më të vogla. Bëjnë plehërim të diferencuar. Po kullimi? «Kullimi është një gjë e madhe, — tha një kooperativist. — E kishte thënë shumë bukur një fjalë për kullimin shoqja ministre. «Ushqeje sa të duash bimën, — kishte thënë, — po nuk i bëre kullimin, s'ke gjë. Është si puna e atij njeriut që i jep bukë e mish qengji, por këmbët ia mban në ujë...». Ne kemi skuadrat e marrjes nën kujdestari për kullimin dhe sa fillon të bjerë shi, ato shkojnë tek ngastrat...» Pastaj është prashitja e grurit. «E di sa mirë i bën grurit prashitja? — thotë Deda. — Ne kemi vetëm dy vjet që i bëjmë dhe kemi fituar nga kjo 2-3 kv më shumë. Ja, prandaj marrin më pak ata të tjerët, se nuk i bëjnë të gjitha këto. Ose ujitja. Ujitjen ata e bëjnë me përmbytje, jo me brazda, kurse plehërimin e bëjnë keq fare. E para, njëherë, e hedhin plehun kohë e pa kohë e nuk kanë skuadra të posaçme. Pastaj nuk e hedhin në mënyrë uniforme. Po do njeriun plehu pastaj, nuk është lehtë të hedhësh pleh. Dikush di të hedhë, dikush jo. Vër atë që di të hedhë...».

— Tjetër, për cilat arsye disa brigada nuk kanë rezultatet tuaja?

— Çfarë arsye të kenë? — ndërhyjnë Pashka. — Mos janë më të dobët fizikisht se ne, për shembull, ata të Gajushit? Jo, ore, ata na marrin në shpinë deri në Mal të Velës ne. Çfarë? Po nuk duan të punojnë.

— Kur vajtëm në tetor tek ata ne për t'i ndihmuar të presin kallamoqin, i gjetëm në gjumë, — thotë Marta.

«Nuk kanë harmoninë që kemi ne ata», — thotë një kooperativist. «Ne nuk kemi hatërllëqe në ndarjen e punëve», thotë një i dytë. «Për mendimin tim, thotë një tjetër, — ka rëndësi autoriteti i brigadierit. — Të thotë brigadieri «Shko puno atje» dhe ti të mos shkosh!».

«Disiplina, disiplina, ajo ka rëndësi — thotë një djalë i ri. — Ne kemi disiplinë të fortë në skuadrën e futbollit, jo më në brigadë».

«Paskeni dhe skuadër futbollit si brigadë?!».

«Posi! «Rendimenti» e ka emrin», thotë ai.

Skuadra e futbollit hapi një faqe të re të bisedës sonë e të jetës së brigadës. Kooperativistët na treguan pastaj se jetës kulturore e artistike në bazë brigade ata i kushtojnë një rëndësi të posaçme. Kanë prej kohësh jo vetëm skuadër futbollit, por edhe skuadra basketbolli e volejbolli për meshkuj e femra. Kanë pastaj nga një grup për atletikë, «ngjitje-malore» një tjetër, tërheqje litari, mundje, shah, bile edhe çiklizëm. («Mos u habit, — tha Pjetri. — Secili me biçikletën e vet, dhe e di sa mirë del?!».) «Kurse grupin artistik e kemi prej vitesh, — thanë. — Në fillim e patëm ca vështirë, sidomos për repertor. Por tani e kemi të stabilizuar plotësisht. Kemi dhënë shfaqje në fshatrat e kooperativës, të rrethit, bile edhe të disa rrethëve të tjera».

Deda, sekretari, na tregon se në fillim, veç vështirësive të repertorit, pengonin edhe disa... «koncepte të gabuara» i quajtën, tha ai, po mua s'm'u duk koncept i gabuar meraku i një prindi që s'donte ta lejonte vajzën se ne do ta mbaronim shfaqjen natën vonë dhe ai ishte i shqetësuar se ajo do të vinte vetëm në shtëpi. Unë e Pjetri i shkuam në shtëpi. «Ama vetëm këtë hall ke ti?», i thamë ne. Dhe që

natën e parë, sa mbaroi shfaqja, katër-pesë shokë e shoqe ia shoqëruan vajzën gjer tek dera e shtëpisë. «Në rregull fare jemi, — tha ai prindi. — Po të jetë kështu, unë s'kam asnjë ankesë tjetër». Dhe që atëherë s'e pengoi më. «Si ju shkoi ndër mend të fillonit kaq shumë aktivitete?» «Të them të drejtën, — thotë Pjetri, — të gjithëve na pati bërë përshtypje që disa të rinj silleshin kot lart e poshtë pas punës. Ndonjë bile nuk sillej si duhet të sillet rinia. Edhe diçka të drejtë kishin, se në grupet artistike të fshatit nuk u binte radha të merrnin pjesë. Se ne jemi fshat i madh. E biseduam me Dedën dhe shkuam në mbledhjen e byrosë së Rinisë. Ç'është e vërteta, unë e Deda nuk lëmë asnjë mbledhje rinie pa marrë pjesë, por atëherë vajtëm t'i propozonim rinisë për aktivitetet. Ata e miratuan mendimin tonë dhe e zbatuan menjëherë». «Ju mbetet kohë për të gjitha?» «Edhe na tepëron. Mbetet kohë edhe për lexim. Gjatë vitit 1977 të rinjtë tanë kanë lexuar rreth 240 libra bujqësorë e artistikë. Organizata e Rinisë e brigadës sonë ka marrë iniciativën «Ta vëmë bujqësinë mbi baza më të shëndosha shkencore»».

«Edhe me «detyrën mbi detyrat» jemi mirë, — thotë Deda. — Pjesëmarrjen e kemi 100 për qind, por në qitjen që bëmë 97 për qind dolëm shkëlqyeshëm. Atë ditë ka rënë shumë shi. Një oficer tha ta anulonim qitjen, se ne kishim edhe gra në brigadë. Por ato këmbëngulën. «Pse, lufta vetëm në verë mund të ndodhë?», thanë ato dhe filluam qitjen».

Duke biseduar me këta kooperativistë të lë një përshtypje të veçantë edhe fakti, se kulturën ata e shohin jo thjesht si këngë e valle, por më thellë, ashtu siç duhet. Jo «punë lodrash», por kërkesë për një jetë të kulturuar, (e cila përbën gjithashtu përvojë).

Ata e shprehin kulturën e punës, për shembull, me disiplinën e zbatimit rigoroz të kodit agroteknik, me librin etj. etj., por edhe për veglat e tyre të punës. Për to kujdesen mjaft. Çdo vegël, lopatë, shatë, kizë, çapë ka të shënuar emrin e secilit që e përdor dhe janë të gdhendura e të mprehura mirë. Ato që përdorin në pranverë e në verë, i kanë vajosur e vendosur në shtëpi në vende të veçanta.

— Në kohën që na dëmtoi breshëri (në 1976-tën), — thotë Pjetri, brigadieri, — erdhën mjaft kooperativistë korçarë për të na ndihmuar. Mua më bënë përshtypje ata edhe për punën e palodhur, edhe për cilësinë e punës që bënë, por sidomos një gjë: sa erdhën, i shkurtuan bishtat e shatave. Mirë e bënë. Kur është i shkurtër shati, nuk të lë të bësh hile në punë. Tokën e prashit më mirë, se bimën e ke më afër syve dhe prashitja bëhet më e thellë. Kurse kur shati është i gjatë, e merr nga larg dheun me shatë dhe gjoja se e ke prashitur tokën përpara, por në fakt vetëm sa e ke mbuluar me dhé. Punëtorë të mirë ata korçarët. Edhe ne mësuam nga ata, edhe ata mësuam nga ne...

A nuk përbëjnë të gjitha këto fakte të thjeshta përvojë të përparuar? Po që se bëjnë, le të fillojmë me to, me njerëzit, pastaj me ato që prodhojnë ata...

PËRMBAJTJA

Faqe

Lartësi të ndërgjegjes shqiptare	3
Pasuri e madhe shpirtërore	11
Në gjirin e ngrohtë të shoqërisë	18
Kurdoherë në revolucion	23
«Si e ka biografinë dhëndri?...»	27
Njerëz shembullorë.	34
«Natyrisht parimin do të të tregojmë...»	39
Shfaqje që struken po nuk zhduken lehtë.	46
Jo vetëm kur të shkelin në kallo... ..	52
Indiferent nuk është vetëm ai që hesht	58
Më parë duhen shkukur konceptet	64
Forca e gruas	68
Kundër konceptit: «Të jetë për mua mos e bëni kurrë»	73
Njerëz pa emra... ..	79
Kur je vetë në rregull	85
Një debat me vlerë	92
Gjurmuesit e punëve të «zgjedhura»	97
Autokritikë dhe «autokritikë»	102
Punës njeriun, jo njeriut punën.	108
«Fëmijë, mos luani para zyrës!»	114
«Pse t'i vijë e keqja nga unë?!»	120
«Vazhdo kështu, se kazma të pret...»	124
Ata që nuk prononcohen... ..	128
Kur lë një punë dhe zë një tjetër... ..	134
«Ç'janë këto fjalë që dalin nga fshati?!...»	139
«S'ke ti punë me ne, por kemi ne, shoqëria, punë me	

ty, sepse je i pasjellshëm...»	142
Një masë e gabuar në emër të vijës së masave	145
Front unik kundër shfaqjeve të huaja	150
Mësime nga një aksion	155
Me dashurinë për njerëzit në zemër	162
Thelbi i përvojës së përparuar është puna e gjallë me njerëzit	167

Titulli 5000 kopje
 Shpërndarje - Miliçia
 Shpërndarje - Miliçia